

# DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE

NUMËR 377 • VITI 35 • PRILL 2022 • RAMAZAN 1443 • ÇMIMI 1 €

**ARGUMENTET THEMELORE TË BESIMIT ISLAM  
(Umm el- Berahin i es-Sanusijit)**

**O njeri, pse nuk pendolesh?!**

**Kurani fisnik – Mrekullitë shkencore**



**Paqe e dashuri për të gjithë,  
e jo konflikte, urrejtje e mosdurim**

## Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e festës së Fitër-Bajramit

*Me emrin e Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!*

*Falënderimi i takon Zotit të botëve, Atë e madhëron çfarë ka në Tokë e çfarë ka në qiej, Ai është i Gjithëpushtetshti, Absoluti.*

*Salatet e selamet tona ia dërgojmë më të mirit të njerëzisë, Muhamed Mustafasë, familjes së tij të pastër dhe shokëve të tij besnikë. Të dashur besimtarë,*

*Të nderuar qytetarë të Kosovës,  
Vëllezër e motra!*

**K**am nderin që sot, në këtë natë të madhe, në natën e Fitër-Bajramit, t'u drejtohem të gjithë besimtarëve e qytetarëve me rastin e përfundimit të muajit të bekuar Ramazan, gjatë të cilit, besimtarët përmes agjërimit kryen një kusht të besimit me përkushtim, lutje e ibadete, solidaritet e bamirësi, mbështetje për të tjerët dhe ndjeshmëri të veçantë që krijon vetëm muaji Ramazan.

Sonte, në vaktin e iftarit, besimtarët përmbyllin muajin e agjërimit, shijojnë mirësitë e natës së madhe të Bajramit dhe bëhen gati ta përjetojnë madhështinë e festës së Fitër-Bajramit, festë kjo që troket tek të gjitha shtresat e popullatës me porosi e masazhe të ngrohta, gjithnjë në funksion të afrimit me rahmetin e Krijuesit të gjithësisë, i Cili për agjërimitin ka premtuar shpërblim të veçantë.

Agjërimiti është ibadet që në të gjitha dimensionet e tij shpreh përkushtimin, devotshmërinë, bindjen e sakrificën për Krijuesin, por në të njëjtën kohë, muaji Ramazan, me ibadetin e agjërimit krijon kushtet e premisat më të mira, që besimtarët e shoqëria të jenë më të socializuar, të jenë pranë njëri-tjetrit, t'i mbështesin e të jenë pranë prindërve, vëllezërve, farefisit e komunitetit, gjë që besimtarin, por edhe komunitetin e ndërgjegjëson dhe e fisnikëron për misionin e tij në këtë botë.

*Vëllezër e motra!*

*Pas dy viteve të shkuara që i kaluam në përballje me pandeminë Covid-19, kësaj radhe, falë Zotit të Madhëruar, Ramazanin që po e përmbyllim dhe festën e Fitër-Bajramit nga e cila na ndajnë vetëm edhe pak orë, e shijuar pa masa kufizuese, rikthyem atmosferën e Ramazanit në shtëpitë tona, bëmë namaze e ibadete nëpër xhamitë tona anekënd vendit, vizituam njëri-tjetrin, me një fjalë shijuar mirësitë e Ramazanit ashtu siç e meriton ky muaj i bekuar.*

*Dashtë Zoti që të mos përballemi më me masa kufizuese, të cilat qenë të domosdoshme, por krijuan një lloj distance ndërmjet nesh.*

*Në këtë natë të madhe, në prag të festës së Bajramit, lutemi e angazhohemi që në botë të mbretërojë paqja, mirëkuptimi, harmonia e solidariteti. Në këtë natë të bekuar, kërkohen nga ne ta vlerësojmë misionin e njeriut që e ka në këtë botë, duke ruajtur një ekuilibër ndërmjet shpirtërores e materiales. Në kohën që po jetojmë, njerëzimi i dhënë pas materiales, sikur ka shmangur e harruar vlerat shpirtërore, duke e bërë kështu shoqërinë më materialiste, realitet ky që ka sjell konflikte, gjakderdhje, dëbime e shkatërrime në tokë.*

*Edhe në këtë natë, në prag të Fitër-Bajramit, kur ne po përgatitemi për të festuar, në shumë vende të botës popullata po kalon ditë të vështira me trazira e konflikte, nga të cilat po pësojnë qytetarët e pafajshëm. Krijuesi ynë e do paqen, e do qetësinë, e do mirëqenien e sigurinë.*

*Në prag të festës së Fitër-Bajramit, lusim Zotin që kudo në botë të ketë sa më pak trazira, të mbretërojë paqja, siguria e mirëqenia për të gjithë.*

*Vëllezër e motra!*

*Ashtu si në tërë botën myslimane, festa e Fitër-Bajramit, është ndër festat më të dashura, më familjare e më popullore, e shtresuar thellë në identitetin e kulturën e popullit tonë.*

*Ta presim Fitër-Bajramin të lumtur që kemi kryer ibadetin e agjërimit, të gëzuar me familjet e farefisin tonë, duke qenë gjithnjë të dobishëm për komunitetin e vendin tonë. T'i kujtojmë ata që kanë shkuar para nesh nga kjo dynja, ta respektojmë njëri-tjetrin, të jemi pranë atyre që kanë nevojë për ne, sepse kjo festë mbartë në vete edhe solidaritetin, bamirësinë e mbi të gjitha unitetin e harmoninë.*

*Vëllezër e motra!*

*Duke lutur Zotin që ta ketë pranuar agjërimitin, lutjet, ibadetet e punët tona të mira, kudo që jeni, ju përgëzoj e ju uroj të gjithëve festën e Fitër-Bajramit.*

*Me hair e me të mira na qoftë Fitër-Bajrami!*


*Myftiu i Kosovës,*

*Naim ef. Tërnavë*

*Prishtinë, më 1 maj 2022*

## Në këtë numër:

- Le t'i vazhdojmë adhurimet edhe pas Ramazanit 4  
 Paqe e dashuri për të gjithë, e jo konflikte, urrejtje e mosdurim 5  
 Reflektime të Ramazanit në besim dhe sjellje 7  
**Sabri Bajgora**  
 Komentimi i sures "Muhamed" – (2) 10  
**Muhammed B. Jusuf Es-Sanusij**  
 Argumentet themelore të besimit islam 13  
**Resul ef. Rexhepi**  
 O njeri, pse nuk pendohesh?! 18  
**Isa Tërshani**  
 Në përcjellje të Ramazanit 21  
**Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi**  
 Jetën e kalojmë duke fituar pasuri 23  
**Prof. dr. Fikret Karçiq**  
 Analiza tekstuale në studimin e Kuranit  
**Prof. ass. dr. Rexhep Suma**  
 Polemika, dialogu dhe debati 27  
**Dr. Ilmije Kuqi**  
 Marrja e fëmijëve në xhami, parim themelor, por sipas rregullave 31  
**Bajram Zeqiri**  
 "Kjo është ditë feste" 34  
**Blerim Musliu**  
 Ti mos e bëj, ti je i veçantë! 36  
**Msc. Abdullah Klinaku**  
 Thellësia historike e raporteve shqiptaro - turke 37  
**Prof. ass. dr. Ferid Selimi**  
 Rrjetet sociale, komunikimi i pambikëqyrur, stereotipat dhe islamofobia 40  
**Msc. Njomza Sadriu**  
 Kurani fisnik – mrekullitë shkencore 44  
**Mirsad Aslani**  
 Edukimi i shpirtit, zemrës dhe mendjes 48  
**Mimoza Sinani**  
 Poligamia sipas Islamit 50  
**PhD (C) Melihate Zeqiri**  
 Shumëgjuhësia institucionale (1) 54  
**MSc. Drin Aliu**  
 Kushtet infrastrukturore, sfidat dhe financat e Medresesë së Mesme "Alauddin" në Prishtinë mes viteve 1962-1999 56

**DITURIA ISLAME**

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE  
 E KULTURORE

Boton:

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,  
 Prishtinë.

**Kryeredaktor:**

Dr. Ajni Sinani

**Redaksia:**

Prof. Sabri Bajgora, mr. Ramadan Shkodra,  
 dr. Fahrush Rexhepi, dr. Orhan Bislimaj,  
 dr. Faruk Sinani, mr. Muzaqete Kosumi,  
 mr. Besir Neziri dhe mr. Driton Arifi.

**Sekretar në redaksi:**

Dr. Rexhep Suma

**Lektor & korrektor:**

Bajram Zeqiri

**Redaktor artistik & teknik:**

Bashkim Mehani

**Adresa:**

Dituria Islame, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 84,  
 10000 Prishtinë.

Tel & Fax: +383 38 224 024

email: dituriaislame@hotmail.com

dituriaislame@yahoo.com

www.dituriaislame.com

**Parapagimi:**

Evropë 25 €

Amerikë 40 USA \$

**Shtypi:**

Shtypshkronja "Printing press", Prishtinë

## Le t'i vazhdojmë adhurimet edhe pas Ramazanit



*“Dhe adhuroje Zotin  
tënd deri sa të vijë ty e  
vërteta (vdekja).”*

(El Hixhr, 99)

**M**uaji i shenjtë Ramazan ishte një mundësi për të bërë më shumë ibadete dhe për të pakësuar mëkatet dhe veprat e këqija. Jeta e njeriut i ngjan muajit. Sa shpejt mbarojnë netët dhe ditët. Shpejtësia e kohës na kujton mbarimin e shpejtë të qëndrimit tonë në këtë botë dhe kalimin në amshim, ndaj duhet të përgatitemi për këtë mbarim duke bërë vepra të mira. Vërtet, në këtë ka mësim për ata që duan të përmirësohen. Sukses në këtë jetë të shkurtër është bindja dhe shfrytëzimi i jetës në fitimin e kënaqësisë së Zotit.

Ka ibadete që kryhen çdo ditë në kohën e tyre, siç është namazi, që është shtylla e Islamit. Disa kryhen çdo vit, si zekati dhe agjërimi, dhe disa bëhen një herë gjatë jetës, e ai është haxhi. Krahas këtyre adhurimeve të detyrueshme, ka edhe namaze vullnetare, agjërim, sadaka dhe umre, gjë që tregon se e gjithë jeta e myslimanit është e mbushur me ibadet, qoftë obligativ apo vullnetar. Veprat pushojnë me ndërprerjen e jetës në këtë botë, jo me përfundimin e Ramazanit. Ramazani është vetëm nxitje për punë të mëtutjeshme dhe vepra të mira dhe pikënisje për pendim.

Përsëritësia sezonale haset tek shumë besimtarë. Xhamitë janë të mbushura me besimtarë gjatë muajit të Ramazanit, më pas fillon të zvogëlohet numri i tyre. Kjo nuk kufizohet vetëm në shoqërinë tonë, por përfshin shumicën e shoqërive myslimane dhe arsyja është mungesa e njohjes së mjaftueshme të Islamit. Disa besimtarë e besimtare janë të devotshëm gjatë muajit Ramazan, falin namazin, lexojnë Kurandin e Shenjtë dhe çdo ditë e bëjnë vepra të mira. Ata i braktisin ato pas përfundimit të muajit. Me përfundimin e Ramazanit njeriu i kthehet përditshmërisë dhe nënshtrimit të njerëzve nën presionet e punës. Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se respekti për fenë ulet, por më tepër zvogëlohet përkushtimi ndaj dispozitave fetare.

Prandaj, ai që mendon se adhurimi prej tij kërkohet vetëm gjatë Ramazanit dhe se lirohet prej tij pas Ramazanit, e ka gabim. Një person i tillë nuk e njeh Allahun dhe as nuk e adhuron siç duhet dhe ashtu siç i takon Atij, sepse ai i bindet Atij dhe e pret shpërblimin e Tij përveçse në Ramazan. Një person i tillë sikur i ka shkëputur lidhjet me Allahun për 11 muaj, edhe pse pa Të nuk mund të jetë as sa mbyllë syrin.

Padija e disave ka arritur deri në atë masë sa që ata mendojnë se mjafton gjatë gjithë javës vetëm falja e namazit të xhumasë, duke mos falur pesë vaktet. Disa përsëri mendojnë se agjërimi i muajit të Ramazanit dhe adhurimi në të është i mjaftueshëm për të gjithë vitin. Ca të tjerë mjaftohen me kryerjen e haxhit për adhurimet e gjithë jetës. Ndërkaq, sado që të jenë ato vepra dhe çfarë qofshin, nëse janë të kufizuara në një muaj nuk janë të mjaftueshme.

Le të shfrytëzojmë kohën në maksimum, kështu që kush bën shumë të mira, le ta falënderojë Allahun dhe le të kërkojë që Ai ta pranojë dhe të vazhdojë bindjen deri në fund të jetës së tij, dhe kushdo që bën mëkate, le të pendohet tek Allahu dhe të rifillojë një jetë të re larg neglizhencës, bredhjes dhe mëkateve.

Allahu i Madhëruar na bëftë prej atyre që u është pranuar agjërimi, ibadetet dhe pendimi dhe që janë në bindje ndaj Tij gjatë gjithë jetës!

Një nga shenjat e pranimit të agjërimin dhe të adhurimit në Ramazan është që njeriu të jetë më i mirë pas Ramazanit se para tij, ndërsa shenja e refuzimit dhe e degradimit është të jetë më keq pas Ramazanit sesa ishte para tij.

Një nga treguesit e pranimit të adhurimeve tona është që të mos i lëmë veprat e mira dhe të mos ndalemi me ibadete, sepse Zoti i Madhëruar ka urdhëruar vazhdimësi dhe këmbëngulje në bindje dhe adhurim. Është detyrim ta adhurojmë Allahun me zell dhe sinqeritet gjatë gjithë jetës, deri në vdekje, siç thotë i Madhëruar: “Dhe adhuroje Zotin tënd deri sa të vijë ty e vërteta (vdekja).” (El Hixhr, 99).

Besimtari duhet ta dijë se dobia e adhurimeve i kthehet pronarit të saj. “...e kush falënderon, e mira e atij falënderimi i takon atij, e kush refuzon (edhe ai e ka për vete), në të vërtetë, Allahu nuk ka nevojë (për falënderimin e tij) pse Ai vetë është i Lavdishëm.” (Lukman, 12).

Një nga shenjat e pranimit të adhurimit tonë gjatë Ramazanit është se Zoti na e bën të dashur bindjen ndaj Tij, na e lehtëson adhurimin dhe largimin nga mosbindja, si dhe na bën të duam të drejtët.

Vazhdimisht duhet të pendohemi dhe të kërkojmë falje. Të jemi modestë dhe të drubemi nga mospranimi i ibadeteve tona. Pavarësisht veprave tona të mira, s'duhet të harrojmë se ato janë shumë të pakta në krahasim me mirësitë që na ka dhuruar Zoti. Jeta duhet të përshkohet nga shpresa, përunjësia, përdëllimi dhe duaja.

Dr. Ajni Sinani

*Hytbeja e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e festës së Fitër-Bajramit, mbajtur në Xhaminë e Madhe në Prishtinë*

# Paqe e dashuri për të gjithë, e jo konflikte, urrejtje e mosdurim

*Falënderojmë Allahun e Madhëruar, me ndihmën e të Cilit arritëm ta përfundojmë agjërimin e këtij muaji të bekuar Ramazan.*

*Salavatet e selamet tona qofshin mbi më të dashurin e Allahut xh.sh., Pejgamberin tonë, Muhamedin a.s., mbi familjen e tij të ndershme dhe mbi shokët e tij besnikë.*

*Të nderuar besimtarë,*

*Vëllezër e motra!*

**S**ot kemi festë, festë e cila na vjen pas kryerjes së njërit nga kushtet e besimit islam – agjërimin të muajit të bekuar Ramazan, ibadet ky që bëhet vetëm për hir të Krijuesit të gjithësisë.

Festa e Fitër-Bajramit, si asnjë festë tjetër na bashkon me familjen e me më të dashurit tanë, me fqinjët, miqtë e farefisnin, ngase këtë e kemi obligim. Zoti në Kuranin fisnik (Er-Rra'd, 21) ka thënë se besimtarë të vërtetë janë ata të cilët mbajnë lidhjet familjare, ngase për to ka urdhëruar Allahu, ata të cilët ia kanë dronë Zotit dhe kanë frikë nga Dita e Llogarisë.

Festa e Fitër-Bajramit për besimtarët është një ndër momentet më të gëzueshme për të gjitha kategoritë e shoqërisë, ngase në vete përmban mesazhet hyjnore që ofrojnë familjen, të afërmit, miqtë dhe farefisnin.

Po ashtu, kjo festë ka në vete mesazhin e gëzimit, haresë e lumturisë, që nga fëmijët, të rinjtë e për të gjitha grupmoshat, të cilët, kjo festë në formën më të mirë i ofron rreth vlerave e porosive hyjnore, humane e sociale.



Festa e Fitër-Bajramit na bashkon në xhami në ibadet, falje e lutje drejtuar Krijuesit të gjithësisë, na bashkon me familjen, me farefisnin e miqësinë në vizita të ndërsjella duke uruar e përgëzuar, si dhe duke kujtuar ata që kanë shkuar para nesh nga kjo dynja.

Fitër-Bajrami bart mesazhin më të mirë për kultivimin e dashurisë për paraardhësit dhe pasardhësit tanë, e kultivon dashurinë e respektin e nipërve e mbesave për gjyshërit e anasjelltas, kultivon respektin dhe kujdesin e prindërve për fëmijët,

kultivon mbështetjen e solidaritetin për ata që kanë nevojë.

Po ashtu, festa e Fitër-Bajramit e bashkon komunitetin dhe e bënë atë që të reflektojë duke trokitur në ndërgjegjen e tyre, e duke nxitur e kultivuar në formën më të mirë ndjesinë e mirëkuptimit, tolerancës, harmonisë, respektit e bujarisë, vlera këto që e fisnikërojnë individin e shoqërinë.

*Vëllezër e motra!*

Mbrëmë kemi përfunduar muajin Ramazan, nga i cili kemi përfituar nimete, begati e falje nga rahmeti i Zotit, dhe gjatë tërë muajit Ramazan

shtuam ibadetet, lutjet, punët e veprat e mira.

Allahu xh. sh. në Kuran na thotë: “Thuaj se me mirësinë e Zotit dhe me mëshirën e Tij le të gëzohen besimtarët. Ajo është më e mirë seç grumbullojnë.” (Junus, 58).

Agjërimi është një ibadet që kryhet me përkushtim të veçantë vetëm për Krijuesin, kështu që përveç agjërimin ishim së bashku në namaze, në iftar e në syfyr, në kujdesin për tjetrin, si në zekat e sadaka.

Të gjitha këto nimete e virtyte i ka ofruar muaji Ramazan, të bindur që Krijuesi ynë do t'i pranojë bindjen e përkushtimin tonë ndaj Tij.

Në Ramazan ishim më të afërt, më të dëlirë, më të urtë, më fisnikë e më humanë.

Kishim më shumë urtësi, mirë-kuptim e solidaritet, pa harruar këtu devotshmërinë e sinqeritetin, vlera këto që duhen kultivuar gjatë gjithë jetës sonë.

Sot, njerëzimi i dhënë pas kësaj bote materiale, sikur po harron shpirtëroren e mësimet hyjnore. Si besimtarë, e kemi për obligim që ta ruajmë me kujdes ekuilibrin ndërmjet dynjasë e ahiretit, ndërmjet materiales e shpirtërore, ndërmjet humanes e egoizmit.

Krijuesi Fuqiplotë e ka dërguar njeriun mëkëmbës në këtë botë, e ka graduar me gradën më të lartë se melaqet, dhe ia ka dhënë Kuranin si udhërrëfyes për jetë me dinjitet në dynja dhe fitimin e ahiretit.

Sot bota po përballet me kriza e konflikte nga më të ndryshmet, kur ne sot po festojmë të lirë Fitër-Bajramin, kur ne po shijojmë mirësitë e kësaj feste, në shumë vende të botës kemi konflikte, luftëra e gjakderdhje, ku popullata e pafajshme po përballet me padrejtësi, dëbime, vrasje e shkatërrime.

Nuk është ky misioni i njeriut në këtë botë, nuk është ky misioni ynë në këtë jetë, kështu nuk na mësojnë as librat e Zotit, e nuk na kanë ligjëruar kështu as pejgamberët e Tij.

Në këtë ditë të madhe, nga ky vend, lutemi që në vatrat e krizës të



ndalen luftërat e konfliktet, lutemi që në ato vende të vendoset paqja e qetësia, lutemi që të mos preken pleqtë, gratë, fëmijët e të pafajshmit.

Paqe e dashuri për të gjithë, e jo konflikte, urrejtje e mosdurim.

Për t'i arritur këto vlera, njerëzimi ka nevojë më shumë se kurrë t'i njoh e t'i përvetësojë drejt mësimet hyjnore, porositë e pejgamberëve dhe traditat tona pozitive që nuk janë të pakta.

Më shumë se kurrë na duhet uniteti e solidariteti. Së fundmi, përveç konflikteve e luftërave, bota po përballet edhe me rritjen e krizës sociale që rrezikon shtresën e mesme ekonomike të popullatës.

*Vëllezër e motra!*

Misioni ynë në këtë botë është që t'i mbështesim punët e mira e të hairit, dhe në këto punë duhet garuar, ngase kështu na mëson Allahu në Kuranin e tij fisnik (El-Mutaffifin, 26), ku thotë, që në punë të hairit le të garojnë besimtarët.

Në këtë mision duhet të kemi unitetin, të cilin duhet ta kultivojmë në familjet tona, me fafësin tanë, e në komunitetin tonë. Vetëm duke qenë unikë mund të bëjmë më shumë punë e vepra të hairit.

Vetëm unikë mund të edukojmë si duhet brezin e ri, duke qenë unikë e të bashkuar ndikojmë në krijimin dhe forcimin e paqes, tolerancës, sigurisë e mirëkuptimit.

Zoti na ka bërë popuj e fise që të njihemi ndërmjet vete, e jo të

diskriminojmë njëri-tjetrin, jo ta shtypim njëri-tjetrin. Zoti na ka dhënë pushtet e pasuri për të na sprovuar, andaj duhet që të udhëheqim me urtësi e drejtësi, e pasurinë ta shfrytëzojmë në rrugën e drejtë.

Qëllimi ardhjes sonë në këtë botë është që t'i njohim vlerat e njëri-tjetrit dhe të jetojmë me dinjitet, si krijesa më e përzgjedhur e Krijuesit të gjithësisë.

*Vëllezër e motra!*

Këtë vit, festën e Fitër-Bajramit, fal Zotit të Madhëruar po e përfetojmë pa masa kufizuese, duke shijuar të gjitha mirësitë që na i jep kjo festë, jemi bashkë në xhamia, në lutje, ibadete e falënderime.

Do jemi bashkë me familjarët e me të dashurit tonë në sofrën e Bajramit. Do urojmë e përgëzojmë duke vizituar njëri-tjetrin, ashtu siç është në traditën tonë për këtë festë të madhe.

Në fund, duke lutur Zotin që ta ketë pranuar agjërimin, lutjet, ibadetet e punët tona të mira, të gjithëve ju uroj festën e Fitër-Bajramit, duke ju dëshiruar shëndet e mbarësi, kudo që jeni, ju përgëzoj e ju uroj të gjithëve festën e Fitër-Bajramit.

Me hair e me të mira na qoftë Fitër-Bajrami!

*Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë Prishtinë, më 2 maj 2022*

*Ligjërata e dr. Bahri ef. Hoxhës, me rastin e festës së Fitër-Bajramit, mbajtur në Xhaminë e Madhe në Prishtinë*

# Reflektime të Ramazanit në besim dhe sjellje

*Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, i Cili i bëri festat ditë për të shfaqur gëzim dhe kënaqësi. Salavatet dhe përshëndetjet më të përzemërta ia dedikojmë të dashurit tonë, Muhamed-it a.s., familjes së tij fisnike, shokëve të tij besnikë dhe të gjithë besimtarëve që pasojnë rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.*

*Të nderuar besimtarë!*

**E**shtë kënaqësi e veçantë që sot të jem me ju, në këtë ditë madhështore të Fitër-Bajramit, me qëllim që t'u drejtohem me disa fjalë rreth reflektimeve të muajit Ramazan dhe festimit të festës së Fitrit në aspektin e besimit dhe të sjelljes.

Ramazanit si një muaj i begatë i adhurimeve, i jepet kuptim interesant, për faktin se përmbillet me festë. Fjala "Fitir" përfaqëson kuptimin edhe të natyrshmërisë. E quajmë festë të natyrshmërisë, sepse me këtë festë kthehemi te zhvillimi i zakonshëm dhe i natyrshëm i jetës, pas një abstenimi njëmuajor përgjatë ditës nga ushqimi dhe pija. Me këtë festë jo vetëm që kthehemi në natyrshmëri, por edhe festimi manifestohet në një mënyrë shumë të përshtatshme për natyrën njerëzore, larg nga çdo tepërim, i çfarëdo natyre qoftë.

Zakonisht njerëzit në kultura të ndryshme festojnë kur ata arrijnë ndonjë avancim në jetën e tyre, si me rastin e ndonjë të arritje profesionale ose pas realizimit të ndonjë qëllimi që ka të bëjë me aspiratat e tyre në këtë botë. Është e natyrshme që njerëzit të festojnë arritjet e tyre në rast të diplomimit, ose avancimit në



karrierë, e të ngjashme. Kurse shikuar në prizmin islam, natyrën e festës dhe të festimit të saj, e gjejmë të shënoj një avancim në ngritjen në nivel të besimit - imanit dhe ndërtimit të raporteve me Zotin e Madhërishtëm.

Kjo ngritje realizohet shumë bukur përmes veprave të parapara në këtë muaj. Agjërimi si kryebadet, prin në këtë qëllim. Zoti e shprehu në Kuran qëllimin e agjëritimit. Ai qëllim synon të jetë "arritja e devotshmërisë", e që është një ngritje në besim, që standardizon sjelljen dhe e bën njeriun qenie të vëmendshme ndaj Zotit.

Allahu xh.sh. thotë: "O ju që besuat, u është bërë obligim agjërimi, ashtu siç u ishte obliguar edhe atyre para jush, me qëllim që të jeni të devotshëm". (El-Bekare, 183)

Përveç tjerash, agjëruesi feston tani arritjet e tija në Ramazan, bazuar në premtimet e Zotit, feston ngritjen në devotshmëri, feston faljen e mëkatëve, gjegjësisht, feston për shpresën dhe besimin e tij te Zoti – Falës. E si

të mos festojë, kur e di mirëfilli fjalën e të Dërguarit a.s: "Kush e agjëron Ramazanin me besim të plotë dhe shpresë në shpërblim, i falën mëkatet e bëra më parë."

Me festim besimtari shpreh gëzimin dhe harenë që e gjen në shpirt, pasi me vullnetiu përgjigj Zotit dhe me durim i doli në krye adhurimit të agjëritimit. Kjo ndër-gjeshmëri në kryerjen e detyrës i jep arsye besimtarit të shfaq gëzimin dhe harenë. Këtë e shprehu Muhamedi a.s. në hadithin e tij: "Agjëruesi i ka dy gëzime, njërin kur e përfundon agjërimin dhe tjetrin kur e takon Zotin e vet."

Të dashur besimtarë, sot bashkërisht festojmë gëzimin e parë, atë të kryerjes së agjëritimit, dhe na mbetet të shpresojmë me besim, në gëzimin e dytë, me të cilin do të shpërblehemi kur të dalim para Zotit të Madhërishtëm.

Këtë shpresë besimtari agjëruesi e shoqëron me bindje të fortë se Zoti i

Madh do t'u përgjigjet lutjeve të tij. Ajetet që flasin për agjërimin, Zoti i Madh i përmbyll, pikërisht duke dhënë premtim hyjnor për praninë të lutjes, Zoti i shpalli Muhamedit a.s.: "Kur pyetesh për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem thirrjes së lutësit kur ai më lutet. Kështu që le të më përgjigjen dhe të më besojnë, që të jenë të udhëzuar drejt." (El-Bekare, 186)

Po ashtu, në një ajet tjetër, Allahu thotë: "Zoti juaj tha: Lutmuni Mua se ju përgjigjem." (Gafir, 60)

Ky është premtim i Zotit, dhe Ai asnjëherë nuk e thyen fjalën e dhënë. Në lutjet që i bëjmë, nuk duhet të kemi kurrfarë dyshimi se Zoti do t'u përgjigjet.

I Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., porosiste: "Lutuni Zotit, të bindur plotësisht se ju përgjigjet."

*Të nderuar besimtarë!*

Të gjitha veprimet në Islam, bazament kanë të besuarit në Allahun xh.sh.. Ato nuk pranohen te Zoti po që se nuk i dedikohen Atij. Pra, veprat janë në shërbim të ngritjes së aspektit besimor dhe ngritjes së raportit me Zotin e Plotfuqishëm. Nga këtu themi se Ramazani me adhurimet që përmban, jo vetëm që është produkt direkt i imanit dhe shfaqje e tij në jetën e njerëzve, por po që se studiohet nga prizmi edhe i efekteve të tij, është një burim i vazhdueshëm i besimit, duke qenë se sa herë e më shumë përparon mendimi shkencor në fusha të ndryshme, veçmas në ato psiko-sociale e shëndetësore, Ramazani lë gojëhapur edhe kolosët më të mëdhenj të fushave përkatëse, të cilët me të drejtë konkludojnë se ky obligim fetar, nuk mund të ketë burim njerëzor të kohës së mesjetës.

Kjo bindje e thellë në vërtetësinë e fjalëve të Zotit Fuqplotë, për shekuj me radhë, gjeneratave të shumta, ua ndriçoi rrugën dhe i favorizoi ndër popuj. Besimtarët, historikisht përfituan nga të mirat që ofron agjërimi në aspekte të ndryshme, pa patur nevojë të presin kalimin e trembëdhjetë shekujve, derisa të zbulohen edhe shkencërisht të mirat e agjërimin e të përshkruhet agjërimi si kurë mjekësore për sëmundje të ndryshme.



Nga kjo pikëpamje, të gjitha obligimet islame, kur shoqërohen me besim dhe shpresë te Zoti, i mundësojnë besimtarit të arrijë qëllimet dhe përfitimet nga këto adhurime.

Të nderuar besimtarë, Ramazani nuk duhet të kuptohet vetëm si një sezon ibadeti, me përfundimin e së cilës përfundon çdo gjë, në raport me adhurimet dhe besimin, përkundrazi, roli i Ramazanit është të forcojë nivelin e besimit, të ripërtërijë vullnetin për ibadete dhe ta përsos besimtarin edhe në aspektin etik.

Lidhja jonë e fortë me Kur'anin, fjalën e Allahut xh.sh., na kthen te meditimi i shenjave të Zotit në natyrë, për të formësuar dhe skalitur bukur njohjen tonë ndaj të Madhit Zot. Meditimi në argumentet apo shenjat e Tij, shtyn njeriun, jo vetëm të njoh madhësinë dhe përpikërinë e Tij në krijim, por edhe të ndjejë lumturinë e përkatësisë ndaj një besimi që ka gjithëherë synim arritjen e kënaqësisë së Zotit.

Sipas mësimave islame, çdo njohuri që përvetësohet, nga e cila synohet mirëqenie dhe dobi për jetën e njerëzve në tokë vlerësohet si njohuri obligative për shoqërinë islame, mirëpo, edhe njohuritë po që se i kategorizojmë për nga lartësia dhe vlera e tematikës që përmbajnë, atëherë padyshim njohuritë që na bëjnë të njohur Zotin tonë, janë njohuritë më të larta. Dituria, që për tematikë ka njohuritë rreth Allahut, është më e vlefshme se çdo lloj tjetër i diturive.

Islami i fton pasuesit e tij për dituri, vëzhgim dhe hulumtim në

univers, sepse nga ky vëzhgim përfitohen argumente të qarta në fuqinë, precizitetin dhe madhësinë e Krijuesit. Sikur që Zoti kritikon ata që dituria e tyre, qëndron në kufijtë e jetës së kësaj bote dhe nuk i kalojnë kufijtë e saj, për të arritur deri te njohja e Krijuesit të botëve dhe për të kuptuar qëllimin e krijimit të jetës.

Allahu i Lartësuar, kur flet për ata që nuk besojnë thotë: "Ata dinë vetëm pamjen e jashtme të jetës së kësaj bote dhe janë krejt të pavëmendshëm, për jetën e përtejme." (Err-Rrum, 7)

Ajetet e Kur'anit, që me një intensitet të shtuar u përqendruam t'i lexojmë dhe t'i kuptojmë gjatë Ramazanit, na kujtuan se, Zoti ka krijesa të cilat i quan melaqe. Ata nuk kundërshtojnë Allahun në urdhrat e Tij, porse e respektojnë Atë dhe i binden Atij. I takon besimtarit që të mundohet t'u përngajë në respektim dhe bindje ndaj urdhrave të Zotit. Jo rastësisht, Zoti na bashkon me ta në Natën e madhe të Kadrit, për shkak edhe të faktit se në njëfarë mënyre, na përfron, përkushtimi dhe adhurimi ndaj të Madhit Allah.

Zoti i nderoi njerëzit kur vendosi t'i ndryshojë dhe t'i përmirësojë ata, përmes Librit. Ideja për të avancuar nëpërmjet leximit, mësimin dhe studimit të Fjalës së Shkruar, ishte dhe do mbetet rruga e njerëzve të ngritur. Në funksion të ngritjes së këtij lloji, në vazhdimësi, themelohen dhe funksionojnë institucione të ndryshme arsimore dhe edukative.



Kështu pastaj, kuptohet drejt interesimi i besimtarëve për të lexuar, medituar dhe kuptuar margaritarët e fshehur brenda dhe në mes rreshtash të Librit të Shpallur. Në këtë situatë mbetet i domosdoshëm urdhri për të lexuar, me çfarë, edhe e hasim realisht, në ajetin e parë, me të cilin nisët Xhibrili në Ramazanin e vitit 610 drejt Pejgamberit a.s..

Gjatë meditimeve tona nëpër ajetet e Librit të Zotit, hasim në sakrificën e shumë burrave të zgjedhur nga Allahu, pejgamberët, detyra e të cilëve ishte shpjegimi dhe aplikimi i mësimëve të Zotit në praktikë, me qëllim të ngritjes së vetëdijes njerëzore. Pasimi i tyre në këtë mision, shndërron njerëzit e thjeshtë, në trashëgimtarë të profetëve, pasi që ata nuk lënë në trashëgimi pasuri nga ari e argjendi, por dituri, nga e cila përfitojnë njerëzit deri në Ditën e Fundit.

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Vërtet Allahu, melaqet e Tij, gjithë banorët e qiellit dhe të tokës, derisa edhe milingona në larvën e saj dhe peshku në det, lutën për atë që u mëson të mirën njerëzve.”

#### *Të nderuar besimtarë!*

Ramazani ishte obligim në një kohë të caktuar (ditë të caktuara), dhe si i tillë kaloi me kalimin e këtyre ditëve të numëruara. Kështu është edhe jeta. Ajo kalon shpejt, derisa në fund vjen Dita e Llogarisë, në të cilën njerëzit përballen me përgjegjësinë e tyre para Zotit Fuqiplotë, për veten dhe familjet e tyre. Prandaj përcjellja e këtyre mësimëve hyjnore te gjeneratat e ardhshme, është kontributi më i dobishëm dhe më i vlefshëm për ta.

Atë Ditë, besimtarët që agjëruan, do të jenë të nderuar, kur ftohen në Xhenet, përmes një dere të veçantë, e cila quhet Rejjan. Kurse rëndësinë më të madhe, vëllezër të dashur, e ka fundi i përhershëm e i qëndrueshëm, dhe jo kënaqësitë kalimtare. E gjithë vuajtja dhe mundimi për të realizuar ndonjë adhurim kalon dhe harrohet shpejt, kurse mbetet shpërblimi i saj në përjetësi. Edhe Pejgamberi a.s. në lutjen e tij pas iftarit jepte shenjë në këtë kuptim kur thoshte: “Kalo! etja,

u gjallërua trupi dhe u sigurua shpërblimi me lejen e Zotit.”

Kështu është edhe puna e Ahiretit, siç e përmend Muhamedi a.s. në hadithin që e transmeton Imam Muslimi në koleksionin e tij, rastin e njeriut më të përvuajtur të kësaj jete, pasi që Zoti e fut në Xhenet, e pyet në mos kishte pasur ndonjëherë vuajtje ose jo, ai përgjigjet: “Jo pasha Allahun, nuk kam vuajtur asnjëherë dhe as nuk kam përjetuar vështirësi, o Zot!”

Besimtarë të nderuar, të gjitha adhurimet, përveç që lidhen me besimin në Zotin, në një relacion të pakontestueshëm, ato janë shumë ngushtë të lidhura edhe me një segment tjetër, shumë të nevojshëm për mbarëvajtjen e jetës në tokë. Obligimet fetare maten në njëfarë forme edhe me efektin pozitiv që lënë në raport me sjelljen. Kur them në raport me sjelljen, kam për qëllim, sjelljen e mirë me çdo gjë të gjallë. Duke filluar nga njeriu, për të vazhduar deri te çdo gjë që ka shpirt. Rëndësia e këtij segmenti sipas mësimëve islame, shkon deri në atë masë sa që, hedh poshtë gjithë shpërblimin e ibadeteve, po që se nga ato ibadete nuk dilet edhe më këtë rezultat, atë të sjelljes së mirë.

Këtë relacion e thonë shumë tekste islame, në raport me shumë adhurime, mirëpo po zgjedh të përmend disa tekste që flasin për namazin dhe agjërimin, si dy nga adhurimet më kryesore të Ramazanit.

Kur është fjala për namazin, Zoti thotë: “Falen i namazin sepse namazi largon nga e keqja.” (El-Ankebut, 45).

Kurse, kur është fjala për agjërimin, Muhamedi a.s. potencoi: “Ai që gjatë agjërimit nuk lë fjalën dhe veprën e keqe, Zoti nuk ka nevojë për urinë dhe etjen e tij.”

Ndërsa, po deshëm t'i bashkojmë këto dy obligime, në një tekst të vetëm dhe lidhjen e tyre me sjelljen e mirë, mund të përmendim fjalën e Muhamedit a.s.: “Shumë prej agjëruësve mund të mos përfitojnë nga agjërimi asgjë, përveç urisë dhe etjes, si dhe shumë prej atyre që falen natën mund të mos përfitojnë asgjë

prej namazit të tyre, përveç mbetjes pa gjumë.”

Prandaj rëndësinë e sjelljes së mirë dhe ruajtjes së raporteve në nivel social dhe atë human, e gjejmë në shumë stacione të Ramazanit, si në nxitjen e vazhdueshme që bëjnë tekstet fetare për ftesa në iftare, në kujdesin ndaj të varfërve, ndaj jetimëve, dhënien e zekatit dhe të sadekatul fitrit, para se të dalim për të festuar festën. E gjithë kjo si një garanci se të gjithë pjesëtarët e shoqërisë kanë me çfarë të festojnë festën dhe të ndiejnë e shprehin gëzim bashkërisht.

Nga këtu themi se, besimtarët janë meritore për festimin e arritjes së shpërblimeve dhe ngritjes në aspektin shpirtëror. Mirëpo kjo arritje asnjëherë nuk ka kuptim, nëse synohet të bëhet duke u veçuar nga të tjerët dhe duke anashkaluar të dobëtit e nevojtarët.

Përkundrazi themi se, sikurse adhurimi, ashtu edhe festimi i festave kur kryhen bashkangjitur me humanizmin dhe solidaritetin, janë më të plota dhe më të vlefshme.

Sikur që jemi të vetëdijshëm se, nuk përbën vlerë asnjëherë festimi në ndonjë formë të ndaluar, në cenim ndaj tjetrit, apo rrezikim të mirëqenies së njerëzve, siç ndodh të manifestohen festime të ndryshme, përmes krismave, lëndimit të tjetrit, e të ngjashme.

Te ne, mund të thuhet me krenari, se ashtu siç karakterizohet Ramazani me një qëllim sublim, po ashtu, dhe në mënyrë tradicionale, festohet Bajrami me një kremtim shumë intelektual e civilizues, duke e filluar festimin me bashkim për lutje dhe falënderim ndaj Zotit të Madhëruar, i Cili lëshon gëzim në zemrat dhe shpirtat tanë.

Festojmë me shtrëngim duarsh e përqafile, ftesa e vizita të ndërsjella, duke u lutur për njëri-tjetrin me lutjen “Zoti ua pranofte adhurimet!”

Sabri Bajgora

# Komentimi i sures “Muhamed” – (2)

Kufri dhe Imani në peshojën e Ahiretit

الَّذِينَ كَفَرُوا وَصَدُّوا عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ أَضَلَّ أَعْمَالَهُمْ ﴿١﴾ وَالَّذِينَ  
آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَآمَنُوا بِمَا نُزِّلَ عَلَى مُحَمَّدٍ وَهُوَ الْحَقُّ  
مِنَ رَبِّهِمْ كَفَّرَ عَنْهُمْ سَيِّئَاتِهِمْ وَأَصْلَحَ بَالَهُمْ ﴿٢﴾ ذَلِكَ بِأَنَّ الَّذِينَ  
كَفَرُوا اتَّبَعُوا الْبَاطِلَ وَأَنَّ الَّذِينَ آمَنُوا اتَّبَعُوا الْحَقَّ مِنْ رَبِّهِمْ كَذَلِكَ  
يَضْرِبُ اللَّهُ لِلنَّاسِ أَمْثَالَهُمْ ﴿٣﴾

“Atyre që nuk besojnë dhe që pengojnë (njerëzit) nga rruga e Tij, Allahu do t’ua asgjësojë veprat e tyre. Ndërsa atyre që besojnë, bëjnë vepra të mira dhe besojnë atë që iu shpall Muhamedit, e cila është e Vërteta prej Zotit të tyre, Ai atyre do t’ua mbulojë të këqijat e tyre dhe do t’ua përmirësojë gjendjen. Kjo, sepse ata që nuk besojnë ndoqën të pavërtetën, kurse besimtarët ndoqën të Vërtetën e ardhur nga Zoti i tyre. Kështu ua sjell Allahu shembujt njerëzve.” – (Muhamed, 1-3).

## Shkaku i zbritjes së ajeteve (1-2)

Transmeton Ibn Ebi Hatimi nga Ibn Abasi të ketë thënë: Jobesimtarët e përmendur këtu janë banorët e Mekës, ndërsa ajeti i dytë që flet për besimtarët, ka për synim ensarët e Medinës.<sup>1</sup>

- Ibn Abasi në një transmetim tjetër thotë: Ky ajet ka zbritur për parinë e kufrit në Bedër, (për ata që furnizuan me ushqim ushtrinë e idhujtarëve në Bedër) e ata ishin dymbëdhjetë burra: Ebu Xhehli, Harith ibn Hishami, Utbe ibn Rebiah, Shejbe ibn Rebiah, Ubejj bin Halefi, Umejje bin Halefi, Munebbih ibnul Haxhaxh, Nubejh ibnul Haxhaxh, Ebul Bahteri ibn Hisham, Zem’ah ibnul Esvedi, Hakim bin Xhizam dhe Harith ibn Amir bin Nevfel.<sup>2</sup>

## Koment

1. Atyre që nuk besojnë dhe që pengojnë (njerëzit) nga rruga e Tij, Allahu do t’ua asgjësojë veprat e tyre

Fillimi i kësaj sureje, i ngjason nisjes së një sulmi të furishëm e të

**Fillimi i kësaj  
sureje, i ngjason  
nisjes së një  
sulmi të furishëm  
e të ashpër ndaj  
jobesimtarëve,  
sepse vetë  
asgjësimi dhe  
zhvlerësimi i  
veprave të  
jobesimtarëve për  
shkak të kufrit të  
tyre, tregon më  
së miri për  
seriozitetin e  
këtij kërcënimi  
hyjnor.**

ashpër ndaj jobesimtarëve, sepse vetë asgjësimi dhe zhvlerësimi i veprave të jobesimtarëve për shkak të kufrit të tyre, tregon më së miri për seriozitetin e këtij kërcënimi hyjnor. Ata që nuk besojnë dhe tallen me fenë e Allahut, qofshin ata nga idhujtarët ose nga pasuesit e Librave të shenjtë, që

mohojnë Njeshmërinë e Tij dhe që pengojnë të tjerët në rrugën e Allahut, nuk kanë pse të shpresojnë në mëshirën e Tij. Zaten, vetë nisja e kësaj sureje, me përmendjen e jobesimtarëve qysh në shprehjen e parë të saj: “atyre që nuk besojnë”, si dhe kotësia e veprave të tyre, qartëson se ata që i kanë shpallur luftë Allahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve, fundin do ta kenë tragjik, sepse dënimi i Ahiretit, vërtet do të jetë i dhimbshëm për ta.

Jobesimtarët e përmendur në këtë ajet, nuk janë thjesht mohues dhe mosbesues vetëm për vete, përkundrazi, këta janë thirrës dhe nxitës në kufr-mosbesim. Ky ajet, kur i përshkruan jobesimtarët, nuk i synon ata vetëm fizikisht, por me këtë synon të gjitha ato ideologji të mbrapshta nëpër shekujt e kaluar po edhe sot, siç janë shoqatat, shtëpitë mediatike të globalizmit modern, ideologjitë ekstremiste, rrymat ateiste, si dhe përpjekjet e të gjitha forcave të errëta, qoftë në Lindje qoftë në Perëndim, që synojnë shpëlarjen e trurit, fshirjen e identitetit dhe robërimin e mendjeve. Kur këtyre u shtohet skllavërimi modern i njerëzve nëpërmjet

sistemeve bankare të bazuara në kamata të shumëfishta, përhapja dhe mbështetja perfide e disa lëvizjeve degjeneruese për gjoja të drejtat e njerëzve dhe të disa grupeve të caktuara që thërrasin në shthurjen e familjes së natyrshme, pa përjashtuar këtu edhe idetë që vijnë ndesh edhe përbrenda vetë shoqërisë myslimane, të cilat fenë duan ta paraqesin ashtu siç u konvenon atyre, qofshin ato rryma ekstremiste apo neoliberales, bëhet e qartë se qëllimi i vetëm i tyre është që njerëzit, t'i largojnë nga besimi i pastër duke futur huti dhe dyshime në fenë e tyre.<sup>3</sup>

Krejt këto dredhi të liga e të ulëta, shpërfaqin ambicidet e sëmura të këtyre njerëzve të cilët dëshirojnë t'i fusin edhe të tjerët në vallen e tyre të mohimit dhe mosbesimit, për t'i shpënë në pa kthim drejt greminave të Xhehenemit: “Ata dëshirojnë që edhe ju të mos besoni sikurse nuk besuan vetë dhe të bëheni të njëjtë.” – (En-Nisa’ë, 89).

**Vetë termi “atyre që besuan”, shfaq madhështinë dhe krenarinë e këtij grupi të shpëtuar, të cilët për asnjë çast nuk u luhatën në besimin e tyre të pastër në Zotin Fuqiplotë, duke bërë përveç kësaj edhe vepra të mira që i afrojnë tek Allahu xh.sh..**

Por edhe përkundër këtyre përpjekjeve të tyre për shkatërrim në tokë, duke mbjellë fesad e amoralitet, megjithatë, ne nuk guxojmë të

dorëzohemi, por duhet të jemi syçelë, duke edukuar gjeneratat e reja për rreziqet që bart me vete ky lloj globalizmi modern dhe imitimi i verbër i të tjerëve. Veprat e këtij grupi do të jenë të asgjësuar nesër në Ahiret, ashtu siç e thekson këtë edhe në shumë ajete të tjera kuranore si: “Shembulli i veprave të atyre që nuk besuan është si hiri, të cilin me puihi e shkapërderdh era në ndonjë ditë të stuhishme, e ata nuk mund të realizojnë asgjë nga veprat që kanë bërë, e ky është ai dështimi i madh.” – (Ibrahim, 18), pastaj: “Ata, veprat e tyre i asgjësuan në këtë botë dhe në botën tjetër, nuk kanë ndonjë mbrojtës.” – (Ali Imran, 22); dhe: “Ata që nuk besuan, shpenzojnë pasurinë e tyre për të penguar nga rruga e Allahut. Ata do të shpenzojnë atë dhe ajo do të bëhet dëshpërim i tyre, e madje ata do të mposhten. E ata që mohuan, do të përmblihen vetëm në Xhehenem.” etj.

*2. Ndërsa atyre që besojnë, bëjnë vepra të mira dhe e besojnë atë që iu shpall Muhamedit, e cila është e Vërteta prej Zotit të tyre, Ai atyre do t'ua mbulojë të këqijat e tyre dhe do t'ua përmirësojë gjendjen.*

Pasi që i Lartmadhërishti në ajetin paraprak tregoi se çfarë i pret jobsimtarët, dhe si atyre do t'u asgjësohen veprat e tyre, duke mbetur pa asgjë, kur të ballafaqohen me drejtësinë hyjnore, tash ky ajet, tregon se si do të jetë gjendja e besimtarëve në Ahiret. Vetë termi “atyre që besuan”, shfaq madhështinë dhe krenarinë e këtij grupi të shpëtuar, të cilët për asnjë çast nuk u luhatën në besimin e tyre të pastër në Zotin Fuqiplotë, duke bërë përveç kësaj edhe vepra të mira që i afrojnë tek Allahu xh.sh.. Pas besimit të pastër në Krijuesin, ata po ashtu besuan me bindje të plotë se Kurani që i ka zbritur Muhamedit a.s. është Fjalë e Zotit dhe dritë shpëtimi e udhëzimi për ta. Besimtarët në Kuran gjetën prehjen e tyre shpirtërore. Nëpërmjet udhëzimeve të tij, ata shpëtuan nga kthetrat e kufrit dhe, duke kërkuar falje prej të Madhërishtit, e pastruan



veten nga gabimet e kaluara. Dihet se ai që hyn në Islam, i fshihen të gjitha gjynahet e kaluara, dhe për ta fillon një jetë e re plot shpresë, ashtu siç ka premtuar i Madhërishti: “Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepra të mirë, të tillëve Allahu të këqijat ua shndërron në të mira. Allahu është mëshirues, dhe falë shumë.” – (El-Furkan, 70). Ky është udhërrëfyesi kuranor, ku në ajetet e tij shohim se sa herë që janë përmendur bashkërisht Imani dhe veprat e mira, menjëherë pas tyre kanë ardhur fjalët “magfret-falje” dhe “el exhru- shpërblimi”, si f.v. në ajetin 50 të sures El-Haxh: “E ata që besuan dhe bënë vepra të mira, do të kenë falje (të mëkateve), furnizim të begatshëm (në Xhenet)”, dhe ajeti 7 i sures El-Ankebut: “Po ata që besuan dhe bënë vepra të mira, Ne me siguri do t’ua shlyejmë të këqijat dhe do t’i shpërblejmë më së miri për atë që vepruan”.<sup>4</sup>

Këta besimtarë të sinqertë, duke e pasur në zemra Fjalën e Allahut - Kuranin famëlartë, e rregulluan jetën e tyre në këtë botë, por mbi të gjitha ia përgatitën vetes vendin meritot në Xhenet. Prandaj, ashtu siç e pamë nga shkaku i zbritjes së ajetit të dytë, fjala besimtarë këtu nënkupton besimtarët e çdo kohe në përgjithësi, por ensarët dhe muhaxhirët në veçanti...

*3. Kjo, sepse ata që nuk besojnë ndoqën të pavërtetën, kurse besimtarët ndoqën të Vërtetën e ardhur nga Zoti i tyre. Kështu ua sjell Allahu shembujt njerëzve.*

Ata që janë mohues të së vërtetës dhe pengojnë në rrugën e Allahut, do ta përjetojnë ndëshkimin e Ahiretit në skëterrata e Xhehenemit, sepse kishin ndjekur të kotën dhe të pavërtetën. Atyre u erdhën qindra argumente që të përudheshin, por të shtyrë nga mendjemadhësia, nuk deshën t’i ndriçonin zemrat e tyre me nurin e fesë së Allahut.

Ndërsa besimtarët, zemra e të cilëve u ndriçua me dritën e Imanit, duke e ndjekur të Vërtetën që u erdhi nga Zoti i tyre, do të jenë të shpërblyer



me Xhenet, duke shijuar kënaqësitë e tij të përfundshme.

Për ta arritur tërë këtë, besimtarët duhet ta kenë bindjen e paluhatshme në Allahun si Krijuesi i tërë kësaj ekzistence, të bëjnë vepra të mira, të mbështeten tek Ai në çdo situatë, të kërkojnë falje nga i Madhërishti për ndonjë veprim të pamatur a mëkat nga e kaluara, dhe natyrisht, ta japin krejt mundin e tyre që ta realizojnë qëllimin më fisnik në këtë jetë, të arrijnë kënaqësinë e Tij.

Ja, në këtë mënyrë ua sjell Allahu i Madhërishtëm shembujt njerëzve, që ata të vetëdijesohen e të ndjekin rrugën që i shpie në shpëtim, dhe i largon nga e kota dhe e pavërteta. Sigurisht, lufta në mes Imanit dhe kufrit do të vazhdojë deri në përfundimin e jetës në këtë botë, sepse gjithmonë do të ketë forca të errëta e mendje të liga, që do të përpiqen të devijojnë njerëzit nga e vërteta. Rruga drejt Allahut nuk është aspak e lehtë. Ajo kërkon guxim, sakrificë, por mbi të gjitha zemër e mendje të hapur, që të pasohet e vërteta në çdo kohë. Megjithatë, në besim nuk ka imponim, por bindje dhe vullnet të lirë, dhe secili e pason atë që dëshiron, por nesër në Ahiret, vetëm njëri grup do të jenë të shpëtuar, e ata do të jenë këta njerëz të cilët Kurani famëlartë i ka përshkruar në këtë ajet: “Është e

vërtet se ky Kuran udhëzon për atë rrugë që është më e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzon se do të kenë shpërblim të madh.” - (El-Isra’ë, 9).

Ndërsa ata që nuk besuan dhe ishin mendjemëdhenj e arrogantë ndaj të së vërtetës, të tillët Kurani i përshkruan në këtë mënyrë: “Ndërkaq, për ata që nuk e besojnë botën tjetër, Ne kemi përgatitur për ta një dënim të rëndë.” – (El-Isra’ë, 10).<sup>5</sup>

## Porosia e ajeteve (1-3)

- Veprat e atyre që mohuan Allahun, e fyen të Dërguarin e tij dhe penguan të tjerët në rrugën e Allahut, do të jenë të asgjësuar, dhe të tillët i pret dënimi i dhimbshëm në zjarrin e Xhehenemit, sepse ata e pasuan të kotën, të shtrembrën dhe errësirën që vjen me shirkun dhe kufirin.

- Ata që besuan Allahun, bënë vepra të mira dhe e pasuan Muhamedin a.s. duke qenë të paluhatshëm në bindjet dhe besimin e tyre, ata janë banorë të Xhenetit, dhe do të jenë nën hijen e mëshirës së Allahut përgjithmonë, sepse ndoqën dritën e së vërtetës, dhe Fjalën e Allahut dhe Kuranin si udhëzim hyjnor.

- Lufta në mes të vërtetës dhe të kotës, do të jetë vazhdimisht e ndezur, sepse armiqtësia e shejtanit ndaj njeriut daton qysh nga krijimi i Ademit, kur djalli i mallkuar shfaqti mendjemadhësi dhe theu urdhrin e Krijuesit. Andaj njeriu duhet të jetë gjithmonë i kujdesshëm nga intrigat e shejtanit, sepse ai me çdo kusht përpriqet të na largojë nga rruga e drejtë, duke na i zbukuar e hijeshuar të këqijat. - vijon -

1. Imam Sujuti, Lubabu-n-nukuli fi esbabi-n-nuzuli, Bejrut, 2020, f. 234. 2. Imam Kurtubiu, El-Xhamiu li ahkamil-l Kuran, Kajro, 1947, vëll. 16, f. 223; Dr. Vehbe ez-Zuhajli, Et-Tefsiru-l Munir, Damask, 2009, vëll. 26, f. 399. 3. Ebu Bekër el Kadi, Te’emmulat imaniye fi sureti Muhamed, Aleksandri, 2019, ff. 38-40. 4. Dr. Vehbe ez-Zuhajli, Et-Tefsiru-l Munir, Damask, 2009, vëll. 26, f. 401. 5. Dr. Hasen Muhamed Baxhude, Te’emmulat fi sureti Muhamed, Mekë, 1979, f. 56.

Muhammed B. Jusuf Es-Sanusij

# Argumentet themelore të besimit islam

(Umm el Berahin)<sup>1</sup>

## Hyrje

*Falënderimi i qoftë Allahut të madhëruar!*

*Bekimi dhe paqja e Tij qoftë mbi të Dërguarin a.s.!*

**D**ije se të gjykuarit mendor ndahet në tri pjesë: E domosdoshme, e pamundshme dhe e mundshme.

**E domosdoshme** (*el vaxhib*)<sup>2</sup> është ajo, mosekzistencën e së cilës mendja nuk mund ta marrë me mend (perceptojë, parafytyrojë);

**E pamundshme** (*el mustehil*)<sup>3</sup> është ajo, ekzistencën e së cilës mendja nuk mund ta perceptojë;

**E mundshme** (*el xhaiz*)<sup>4</sup> është ajo që mendja në vete mund ta perceptojë si ekzistuese dhe joekzistuese.

Çdo mysliman i rritur dhe përgjegjës është i obliguar fetarisht të dijë: çka është e domosdoshme, çka është e mundshme dhe çka është e pamundshme në raport me Allahun xh.sh.<sup>5</sup> Po ashtu, ai është i obliguar që ta dijë të njëjtën gjë edhe në raport me të gjithë të dërguarit e Allahut të madhëruar.

### Atributet e Allahut xh.sh.

Është e domosdoshme që Allahu i madhëruar të ketë njëzet (20) cilësi, kurse ato janë: **Cilësia vetore dhe (5) cilësitë mohuese** (*es sifatu -n-nefsijeh ve -s- selbijjeh*)

- **Të ekzistuarit** (*el vuxhud*)<sup>6</sup>;
- **Amshueshmëria** (*el kidem*)<sup>7</sup>;
- **Përhershmëria** (*el beka*)<sup>8</sup>;



- **Dallimi nga të krijuarat** (*muhalefetuhu Teala lil havadith*)<sup>9</sup>; -
- **Të vet-ekzistuarit** (*kijamuhu Teala binefsihi*)<sup>10</sup>, që do të thotë nuk ka nevojë për vend as për dikë të veçantë: dhe
- **Njëshmëria** (*el Vahdanijeh*)<sup>11</sup>, që do të thotë nuk ka të ngjashëm në qenien e Tij, as në attribute, e as në vepra.

Këto janë gjashtë cilësitë. E para është shpirtërore (*nefsijjetun*), e ajo është cilësia e të ekzistuarit. Pesë cilësitë e tjera janë negative (*selbijjetun*).

Më tej, është e domosdoshme që Allahu xh.sh. të ketë shtatë (7) cilësi të tjera, që quhen cilësi diktuese abstrakte (kualitative).<sup>12</sup>

**Cilësitë diktuese abstrakte** (*sifatu -l- me'ani*) janë:

- **Fuqia** (*el kudreh*)<sup>13</sup> dhe

- **Vullneti** (*el iradeh*)<sup>14</sup>, që kanë të bëjnë me çdo gjë që është e mundshme;
- **Dituria** (*el ilm*)<sup>15</sup> e cila ka të bëjë me çdo gjë që është e domosdoshme, e mundshme dhe e pamundshme;
- **Jeta** (*el hajah*)<sup>16</sup> që nuk është e varur nga asgjë;
- **Dëgjimi** (*es semu*)<sup>17</sup> dhe
- **Të pamurit** (*el basaru*)<sup>18</sup>, që kanë të bëjnë me çdo gjë ekzistuese;
- **Të Folurit** (*el kelam*)<sup>19</sup>, i cili nuk përbëhet prej shkronjave dhe zërit, por ka të bëjë me çdo gjë që ka të bëjë edhe Dituria (e Tij).<sup>20</sup>

### Cilësitë rezultuese kuptimore (*sifatun ma'nevijjeh*)

Gjithashtu, është e nevojshme, që Allahu xh.sh. të ketë edhe shtatë cilë-

si, të cilat quhen cilësi rezultuese kuptimore (*sifatun ma'neviiijeh*)<sup>21</sup>

Vetëm Allahu xh.sh. njëmend është:

- **i Gjithëpushtetshëm** (*Ka`dirun*);
- **vetëm Ai me vullnetin e vet bën çka dëshiron** (*Muri`dun*);
- **vetëm Ai di çdo gjë** (*Ali`mun*);
- **vetëm Ai jeton gjithmonë** (*Hajjun*);
- **vetëm Ai i dëgjon të gjitha** (*Semi`un*);
- **vetëm Ai ka të folur të pavarur** (*Mutekel`limun*).

Është e pamundur që Allahu xh.sh. të ketë **njëzetë (20) cilësi të kundërta**, siç janë:

- - **joekzistenca** (*El adem*);
- - **joamshueshmëria** (*El huduth*);
- - **krijimi nga joekzistenca** (*turu-u el adem*);
- - **ngjashmëria me të krijuarën** (*el mumatheletu lil havadith*), **të jetë trupor** (*xhirm*), do të thotë që Qenia e Tij e lartësuar **të zë hapësirë**, ose të jetë **aksidencë** (*arad*) i cili ekziston në mënyrë trupore, ose **të jetë në një anë kundrejt trupave**, ose Ai **të ketë anë**, apo **të jetë i kufizuar me hapësirë** ose **kohë**; apo **Qenia e Tij e lartësuar të jetë e krijuar; të jetë i ri apo i vjetër**;
- **të ketë dëshirë për vepra apo dispozita**;
- Është e pamundur që **të jetë i varur** (në ekzistencën e Tij) (*En la jekune kaimen binefsihi*);
- **të ketë cilësi që zë vend apo ka nevojë për diçka**;
- **të mos jetë Një**, respektivisht **të jetë i përbërë në Qenien e Tij**;
- **dikush t'i jetë i ngjashëm** me Të në cilësi apo Qenie;
- **të jetë dikush me Të** që ndikon në ndonjë vepër;
- **të jetë i pafuqishëm** në raport me diç të mundshme;
- që krijimi i diçkaje në botë të mund **të jetë pa vullnetin e Tij** për ekzistimin e atij sendi, respektivisht, që vullneti i Tij të mos ekzistojë për atë;
- **t'i përshkruhet befasia** apo **pakujdesia**, (habia apo harresa);

- të përshkruhet si **shkakësi** ose **naturësi**;
- **t'i përshkruhet injoranca** apo diç që mund të ketë përmbajtje dhe domethënie të ngjashme; dhe natyrisht
- të pamundshme i janë **vdekja, të shurdhuarit, të verbuarit dhe të qenët memec**.

#### **Cilësitë e kundërta me këto janë plotësisht të qarta.**

Është e mundshme që Allahu xh.sh. në lidhje me çdo gjë të mundshme të bëjë apo të mos bëjë diç (respektivisht është e mundshme bërja nga Allahu e çdo gjëje të mundshme apo lënia e saj A.S.).

#### **Argumenti themelor i të besuarit**

Argumenti mbi domosdoshmërinë e ekzistencës së Allahut xh.sh. është krijimi i botës, sepse bota po të mos kishte Krijuesin e saj, por të ishte krijuar vetvetiu, do të ishte e domosdoshme të jetë njëra nga dy gjërat e barabarta, e barabartë me çifitin e saj, duke mbizotëruar (dominuar) mbi të pa shkak, kurse kjo është e pamundur.

Argumenti i krijimit të botës është pandashmëria e saj nga aksidencat e krijuara, siç janë lëvizja apo qetësia ose ndonjë tjetër. Pandashmëria e asaj që ndodh është aksioni i të ndodhurës (të krijuarës). Argumenti i krijimit të aksidencave është të pamunit e ndërrimeve të tyre nga joekzistenca në ekzistencë dhe nga ekzistenca në joekzistencë.

#### **Argumenti për domosdoshmërinë e amshueshmërisë** (*El kidem*)

Argumenti për domosdoshmërinë e amshueshmërisë të Allahut xh.sh. është: sikur të mos ishte i amshueshëm Ai do të ishte i krijuar. Do të ishte i nevojshëm për atë i cili e krijon, gjë që do të ishte i nevojshëm rrethi ose vargu i ndodhive. Kurse kjo është e pamundur.

#### **Argumenti mbi domosdoshmërinë e përhershmerisë** (*El beka*)

Argumenti mbi domosdoshmërinë e përhershmerisë së Allahut xh.sh. është që po t'i ishte e mundur zhdukja, do të mohohet amshueshmëria e Tij, ngase ekzistenca e Tij atëherë do të ishte e mundshme, e jo e domosdoshme. Ndërkaq, ekzistenca e Allahut xh.sh. është e domosdoshme, ajo nuk është e mundshme. E mundshme është vetëm ajo, e cila ndodh. Tashmë është konfirmuar domosdoshmëria e amshueshmërisë dhe përhershmerisë së Tij.

#### **Argumenti mbi domosdoshmërinë e ndryshueshmërisë nga çdo krijesë** (*muhali fetuhu lilhavadith*)

Argumenti mbi domosdoshmërinë e ndryshueshmërisë së Allahut xh.sh. nga çdo krijesë është: po të ishte i ngjashëm me diçka, do të ishte ai i cili ndodh, sikur edhe e krijuara. Kjo është e pamundur, siç u mësua pak më parë mbi domosdoshmërinë e amshueshmërisë dhe përhershmerisë së Tij.

#### **Argumenti mbi domosdoshmërinë e të vet-ekzistuarit** (*Kijamuhu binefsihi*)

Argumenti mbi domosdoshmërinë e të vet-ekzistuarit të Allahut xh.sh. është: po të kishte nevojë për hapësirë, do të ishte cilësi, kurse cilësia nuk përshkruhet me cilësitë diktuese abstrakte (*sifatu -l- me'ani*, )dhe cilësitë rezultuese kuptimore (*sifatun ma'neviiijeh*).

Vetëm Allahu xh.sh. është e domosdoshme të përshkruhet me cilësi të tilla. Ai nuk është cilësi. Po të kishte nevojë për dikë të veçantë do të ishte ai i cili ndodh. Pak më parë është argumentuar amshueshmëria dhe përhershmeria e Tij.

#### **Argumenti mbi domosdoshmërinë e njëshmërisë** (*El Vahdanijeh*)

Argumenti mbi domosdoshmërinë e njëshmërisë së Allahut xh.sh. është: sikur Ai të mos ishte vetëm Një i Vet-

mi, do të ishte e domosdoshme të mos ekzistojë asgjë në botë për shkak të pamundësisë së Tij.

### **Argumenti mbi domosdoshmërinë e përshkrimit me cilësitë: Fuqia, Vullneti, Dituria dhe Jeta**

Argumenti mbi domosdoshmërinë e përshkrimit të Allahut xh.sh. me cilësitë: Fuqia, Vullneti, Dituria dhe Jeta është: sikur të mos ishte njëra nga këto cilësi tek Allahu xh.sh. s'do të mund të ekzistonte asnjë prej krijesave.

### **Argumenti mbi domosdoshmërinë e cilësive të Dëgjimit, të të Pamurit dhe të të Folurit**

Argumenti mbi domosdoshmërinë e cilësive të Dëgjimit, të të Pamurit dhe të të Folurit të Allahut xh.sh. është: Sipas Kuranit, Sunetit dhe Ixh-mait, sikur të mos ishte i përshkruar me këto cilësi, do të ishte e domosdoshme të përshkruhet me cilësitë e kundërta. Ndërsa ato janë mangësi, ndërkaq është e pamundur që Allahu xh.sh. të ketë të meta.

### **Argumenti mbi domosdoshmërinë e përshkrimit të Allahut xh. sh. me bërjen e së mundshmes apo lënien e saj**

Argumenti mbi domosdoshmërinë e përshkrimit të Allahut xh. sh. me bërjen e së mundshmes apo lënien e saj është: Sikur logjikisht diçka prej saj të ishte e domosdoshme për Allahun xh.sh apo logjikisht të bëhej e pamundur, e mundshmeja do të bëhej e domosdoshme ose e pamundshme, kurse kjo është e pakuptim.

### **Të Dërguarit e Allahut xh.sh.**

Bekimi dhe paqja e Allahut xh. sh. qoftë mbi të gjithë ata.

*Është e domosdoshme* që të dërguarit e Allahut xh. sh. të posedojnë cilësitë e besnikërisë (*es sidk*), besueshmërisë (*el emaneh*) dhe të transmetojnë atë që janë urdhëruar t'ua transmetojnë njerëzve (*et teblig*).

*Është e pamundur* që të dërguarit e Allahut xh. sh. të posedojnë cilësi të kundërta me këto, si p.sh. gënjesht-

trën (*el kidhb*), tradhtinë (*el hijaneh*) në kryerjen e asaj që është e ndaluar rreptësisht, apo të urrejnë dhe fshehin diç (*kitman*), që u është urdhëruar t'ua transmetojnë njerëzve.

*Është e mundshme* t'u nënshtrohen aksidencave trupore, sikurse edhe njerëzit e tjerë, siç janë p.sh. sëmundja dhe të tjera. Por, nuk i janë të nënshtruar asgjëje që do të mund të çonte në mangësinë e pozitës së lartë të pejgamberllëkut të tyre.

### **Argumenti mbi domosdoshmërinë e besnikërisë**

Argumenti mbi domosdoshmërinë e besnikërisë së tyre është: sikur të mos ishin besnikë, atëherë e pavërta do të ishte në lajmërimin e Allahut xh.sh. i Cili ka konfirmuar (vërtetuar) pejgamberinë e tyre me mu'xhize. Ajo (mu'xhizja) sikur flet në vend të fjalëve të Allahut xh.sh.: Të vërtetën e ka thënë robi Im, në çdo gjë që e thotë nga Unë.

### **Argumenti mbi domosdoshmërinë e besueshmërisë**

Argumenti mbi domosdoshmërinë e besueshmërisë së pejgamberëve a.s. është: sikur ata të kishin tradhtuar me bërjen e veprave të ndaluara ose të urryera, e ndaluara apo e urryera do të bëhej dëgjim ndaj tyre, sepse Allahu xh.sh. na ka urdhëruar, që ata t'i ndjekim në fjalët dhe veprat e tyre. Ndërkaq, Allahu nuk kërkon që të bëhet e ndaluara dhe e as e urryera. E pra kjo është vetvetiu argument mbi domosdoshmërinë e së tretës.

Argumenti i nënshtrimit të të dërguarve ndaj aksidencave njerëzore (sëmundjeve etj.) është përcjellja e atyre aksidencave tek ata. Kjo është për shkak të madhërisë së shpërblimit të tyre, ose ligjshmërisë, ose ngushëllimit në këtë botë, apo që t'u tërheqë vërejtjen atyre në pavlefshmërinë e saj tek Allahu xh.sh. dhe moskënaqësinë e Tij që ta bëjë



këtë botë si vend shpërblimi për të dërguarit dhe miqtë e Tij, duke marrë parasysh gjendjen e tyre në të (dynja).

### **La ilahe il-la-Allahu Muhamedun Resulullah**

“Nuk ka zot, përveç Allahut, Muhamedi është i Dërguari i Tij”

Kuptimin e besimit të ekspozuar e përmbajnë në tërësi fjalët: “La ilahe il-la-Allah, Muhamedun Resulullah”, të cilat janë dëshmi e hyjnishtë absolute, që do të thotë se vetëm Allahut xh.sh. nuk i duhet asgjë dhe askush, kurse Ai i është i nevojshëm çdo gjëje dhe çdokujt.

### **La ilahe il-la-Allahu**

Shprehja “la ilahe il-la-Allahu” për besimtarin duhet të thotë që njëmendësisht të mos mund të jetë vetëm pa Allahun xh.sh dhe që njëmendësisht të ketë nevojë vetëm për Atë.

Vetëm Allahu xh. sh. me fuqinë e Tij mundet pa askënd. Kjo është e domosdoshme në pajtim me cilësitë e Ekzistencës, të Amshueshmërisë dhe të Përhershmërisë, të Dallueshmërisë nga krijesat, të Mëvetësisë dhe të Pastërtisë nga mangësitë. Në këtë bën pjesë domosdoshmëria e cilësive të Allahut xh.sh.: të Dëgjimit, të Pamurit dhe të Folurit, sepse këto cilësi sikur të mos ishin të domosdoshme, atëherë do të kishin nevojë për krijuesin, vendin apo për dikë, i cili do t'i mënjanonte mangësitë nga Ai.

Prandaj, është e domosdoshme që Allahu xh.sh. të jetë i pastër prej dëshirave në vepra dhe dispozita, sepse do të ishte i nevojshëm për atë i cili do t'ia sendërtonte dëshirat. S'mund të jetë ndryshe, ngase Allahu xh. sh. është ai i cili mundet pa askënd.

Pra, Ai nuk është i detyruar asgjë të bëjë apo të mos bëjë nga të mundshmet, sepse sikur logjikisht të ishte i detyruar të bëjë diç, si p.sh. të shpërblejë, do të ishte i nevojshëm për dikë në mënyrë që t'i sendërtohet nevoja. Në raport me Allahun xh.sh. është e nevojshme përsosmëria e Tij. Ai

## **Vetëm Allahu xh. sh. me fuqinë e Tij mundet pa askënd. Kjo është e domosdoshme në pajtim me cilësitë e Ekzistencës, të Amshueshmërisë dhe të Përhershmërisë, të Dallueshmërisë nga krijesat, të Mëvetësisë dhe të Pastërtisë nga mangësitë.**

është absolut. Ai është vetëm Ai, i cili gjithmonë jeton, Ai i cili gjithmonë ka gjithë pushtetin, Ai i cili gjithmonë ka gjithë vullnetin dhe Ai, i cili gjithmonë ka gjithë diturinë.

Sikur mos të kishte ndonjërin nga këto cilësi, do të ishte e pamundur që çdo gjë e krijuar të ekzistojë. Vetëm Allahu sh.sh. nuk ka nevojë për asgjë. Çdo gjë ka nevojë për Atë. Le të na shërbejë për këtë shembulli i fillimit të tokës. Sikur, përveç Allahut xh. sh. vetëm edhe diçka të ishte e amshueshme, ajo në të vërtetë, do të ishte e mundur të ekzistonte pa Atë. Kurse kjo është e pamundshme. Është domosdoshme që çdo gjë të ketë nevojë për Atë. Asnjë nga qeniet e gjalla nuk ka ndikim në veprimin e Allahut xh sh. Sikur të ishte kjo, do të ishte e domosdoshme që ky ndikim të mund të jetë pa Atë. E si mundet kjo, kur çdo gjë ka nevojë për Atë në çdo pikëpamje?! Kjo, nëse supozohet që disa qenie ndikojnë sipas natyrës së tyre (në veprimin e Allahut). Nëse supozohet ndikimi i tyre përmes fuqisë të cilën ua ka

dhënë Allahu xh sh, siç konsiderojnë shumë të paditur, edhe kjo është e pamundur, sepse atëherë Ai do të ishte i nevojshëm për krijimin e disa veprave për ndërmjetësim, gjë që s'është e saktë, siç kemi mësuar që vetëm Ai nuk ka nevojë për askënd dhe për asgjë.

Ja pra, kështu u bë i qartë kuptimi i shprehjes ‘la ilahe il-la-Allahu’ për të tri pjesët (gjërat), të cilat është i obligueshëm t'i dije myslimani moshërritur dhe përgjegjës në lidhje me Allahun xh. sh. Kjo është, në të vërtetë, ajo që është e domosdoshme, e pamundshme dhe e mundshme.

### **Muhamedun Resulull-Allah**

Shprehja “Muhamedun Resul-Allah” përmban të besuarit në të gjithë të dërguarit e Allahut xh. sh., engjëjt, shpalljet dhe ditën e Gjykimit. Muhamedi a.s. erdhi që ta vërtetojë këtë. Edhe me këtë ka të bëjë domosdoshmëria e besnikërisë së të dërguarve a.s., pastaj pamundësia e gënimit nga ana e tyre, sepse po të mos ishte kjo ata nuk do të ishin lajmëtarë të besueshëm të Allahut xh. sh., Gjithënjohësit të çdo fshehtësie dhe çdo gjëje.

Pamundësia e tyre për kryerjen e çdo veprë të padobishme, sepse janë dërguar që t'i mësojnë njerëzit me fjalët, veprat dhe heshtjet (lejimin) e tyre. Është e domosdoshme që ata në asgjë mos të kundërshtojnë urdhrin e Allahut xh.sh., i Cili i ka dalluar mbi gjithë njerëzit e tjerë, duke ua besuar fshehtësitë e shpalljes së Vet. Është e mundshme që edhe ata të kenë aksidenca njerëzore, por kjo aspak nuk e zvogëlon rëndësinë e detyrës së tyre, as vendin e shkallës së lartë të pejgamberisë së tyre tek Allahu xh.sh. Në të vërtetë, kjo e shton kuptimin dhe rëndësinë e saj.

### **Shehadeti dhe dhikri**

Përfundimisht, u bë i qartë kuptimi i pjesëve të dy shehadeteve, të cilat me pak fjalë flasin mbi gjithë atë që është i obliguar të dijë myslimani moshërritur dhe përgjegjës mbi të besuarit në Allahun xh.sh dhe të dër-





guarit e Tij. Me siguri, për shkak të përmbajtjes së këtitill të thukët (të shehadetit) feja edhe e bëri atë përkthim të asaj që duhet të jetë në zemrën e myslimanit. Për këtë Islami edhe nuk e pranon të besuarit e asnjërit pa të pranuarit e sinqertë të Shehadetit. I mençuri duhet që ta shqiptojë sa më shumë, duke e gjallëruar në vete atë që përmban ai mbi të besuarit, vazhdimisht derisa me gjithë qenien, trupin dhe shpirtin e tij, të përzihet plotësisht me përmbajtjen e tij. Atëherë do të ndiejë se çfarë fshehtësish dhe të mirash i zbulohen dhe i jepen, që nuk do të mund as t'i numërojë, me ndihmën e Allahut xh.sh. kurse nuk ka zot tjetër përveç Atij, as ndonjë tjetër të adhuruar përnjëmend, përveç Atij.

E lusim Atë, e vetëm Ai është i lartësuar dhe i lavdëruari, që neve dhe të dashurit tanë t'i ndihmojë, që me rastin e vdekjes sonë të mund t'i theksojmë fjalët e shehadetit, duke i kuptuar dhe duke i marrë vesh ato.

Le të jetë salati dhe selami i Allahut xh.sh. mbi zotërinë tonë, Muhamedin a.s., vazhdimisht edhe kurdo që e përmendin ata të cilët Allahut xh.sh. e përmendin; dhe kurdo që e harrojnë ata të cilët e lënë pas dore të përmendurit e Allahut xh.sh. Allahu xh.sh. qoftë i kënaqur me të gjithë shokët e të Dërguarit a.s. dhe me ata që i pasojnë me mirësi gjër në ditën e Gjykimit.

Falënderimi i qoftë Allahut xh.sh., Zotit të botëve!

*Kjo vepër është njëra nga veprat më të njohura në shkencën e Akaidit-Besimit islam. Umm el Berahin, (Ajka e argumenteve) në gjuhën shqipe e kam përkthyer "Argumentet themelore të besimit islam". Kështu e ka përkthyer*

*edhe rahmetli dr. Ahmet Smajloviq nga gjuha arabe në Zbornik Radova 2, ITF, Sarajevë 1987. Punimi fillimisht është botuar në Dituria islame nr. 42, Tetor 1992. Asaj kohe, gjatë përkthimit të parë, në mungesë të originalit në gjuhën arabe u pata konsultuar me tekste të tjera arabe. Ndërkaq tani këtë shkrim po e ribotoj me përmirësime gjuhësore dhe duke u mbështetur në tekstin origjinal në gjuhën arabe. Punimin e kam shoqëruar edhe me disa sqarime që kam menduar se punimin e bëjnë më të qartë.*

Përktheu: dr. Ajni Sinani

1. متن أم الرايين المسمى بالعقيدة السنوية الصغرى. Shih: [http://ablelsuna.blogspot.com/2011/12/blog-post\\_2903.html](http://ablelsuna.blogspot.com/2011/12/blog-post_2903.html)  
 2. Domosdoshmëria (el vaxhib) e përjashton mosëksistencën. Kurse përjashtimi i mosëksistencës i rrjedhur nga vetë domosdoshmëria quhet vet-domosdoshmëri (vaxhib lidhatihi). Shih: Prof. Dr. Bekir Topaloglu, Hyrje në kalam, Prishtinë, 2002, f. 71-72. 3. E pamundshme (mumteni), muhal, muštehil). Tek e pamundura, mosqenia përbën domosdoshmërinë e individualitetit të saj, kështu që ekzistenca e saj është e papramueshme. Shih: Prof. Dr. Bekir Topaloglu, op. cit., f. 73 4. E mundura, e lejuara (shaiz, mumkin). Në rastin e së mundurës individualiteti nuk ndien domosdoshmëri për qenien ose mosqenien e vet. Proporcionalisht si qenia ashtu edhe mosqenia e tij janë të barasvlershëm. Shih: Prof. Dr. Bekir Topaloglu, op. cit., f. 72. 5. Allahu Fuqiplotë cilësohet me cilësi të përkryera dhe nuk mund të përshkruhet me cilësi të mangëta. Qenia (Dhat) e Tij është e Përsosur dhe e Lartësuar. Këto cilësi dijetarë i kanë nda në katër grupe: -Cilësia vetore (en-nefsijeh); -Cilësitë mohuese (es-selbijeh); -Cilësitë diktuese abstrakte (el-me'ani) dhe: -Cilësitë rezultuese kuptimore (el -ma'nevijeh). Shih: Prof. Dr. Muhammed Seid Ramadan El Buti, Të vërtetat e patundshme të besimit islam (Detyrimet e njeriut ndaj Krijuesit), Tetovë, Asr, 2004/1425., f. 87. 6. Ekziston vetvetiu. Ekzistenca e Tij nuk është e varur por është absolute që nuk pranon mosqenien dhe nuk është nga ndonjë efekt i shkaktuar. Shih: Prof. Dr. Muhammed Seid Ramadan El Buti, op. cit., f. 88. 7. I pafillim. Sikur Allahu t'i paraprinte mosëksistimi, atëherë do të ishte i domosdoshëm për dikë që do ta bënte të ekzistojë, s' do të ishte Zot. Shih: Ibid, f. 92. 8. I pabarim. Është e pamundur që Dhati i Allahut t'i nënshtrohet mosëksistimit. Nuk mund të paramendohet që të ketë ndonjë faktor që do ta zhdukë Atë. Shih: Ibid, f. 94. 9. Nuk i përngjan askujt prej krijesave. "...Asnjë send nuk është si Ai..." (Esh Shura, 11). Allahu xh.sh. është i lartësuar dhe i lirë nga të gjitha kuptimet që përngjasin me krijesat e Tij. Ai nuk kufizohet me vend që të ketë dimensione, gjymtyrë, përshkrim a formë. Shih: Ibid, f. 126. 10. Nuk ka nevojë për dikë që do ta krijonte. Allahu është nga pafillimësia dhe do të jetë pafundësisht. Ai nuk ka nevojë për

askënd kurse të gjithë janë të nevojshëm për Atë. Shih: Ibid, f. 95. 11. Të qenit unik. Njëësia e Zotit është ajo të cilën myslimanit e pohon në deklarimin e tij të Shehadetit. Islami e ka theksuar pandërprerë njëjtësinë dhe transcencën absolute të Qenies së Zotit. Ai e ndan transcencën prej natyrores dhe ekzistencës së krijuar. Shih: Ismail Raxhi el Faruki, Tevhidi, Implikimet e tij për mendimin dhe jetën, Logos, 2006, Shkup, Prishtinë, Tiranë, f. 30-31. 12. Cilësi diktuese është çdo cilësi që ekziston nga vetë Qenia e Allahut xh.sh. dhe që e bën të domosdoshëm një gjykim të caktuar të Tij. Cilësia e diturisë e bën të patjetërsueshëm gjykimin se Ai që cilësohet me të duhet të jetë i ditur. Cilësitë e përsosura të Allahut janë të shumta, por të gjitha ato bashkohen në shtatë cilësi kryesore për të cilat ka argumente të hollësishme nga Kurani fisnik. Shih: Prof. Dr. Muhammed Seid Ramadan El Buti, op. cit., f. 99. 13. Kjo është cilësi e përjetshme që gjendet nga vetë Qenia (Dhat) e Allahut. Kjo ka të bëjë me krijimin e çdo gjëje të mundshme, zhdukjen dhe formimin e tyre. Shih: Prof. Dr. Muhammed Seid Ramadan El Buti, f. 103. 14. Është cilësi e amshueshme që ekziston nga vetë i Lartëmadhëruari. Ai i përcakton të mundshmet dhe atë që ka të bëjë me to sikurse janë: krijimi, asgjësimi, formimi, pa marrë parasysh ndonjë faktor të jashtëm. Shih: Ibid, f. 102. 15. Është cilësi e amshueshme që ekziston nga Vetë Qenia e Allahut. Ka të bëjë me realitetin që ka ndodhur dhe është shfaqur apo është e padukshme dhe ende nuk ka ndodhur. Ajo shpalos dhe përfshin gjërat mu ashtu sikurse janë në realitetin e tyre apo si do të jenë në të ardhmen. Shih: Ibid, f. 101. 16. Është cilësi e përjetshme që ekziston nga vetë Qenia e Allahut xh.sh. Allahu ekziston vetvetiu. Nuk mund të parafytyrohet ekzistimi i cilësive të tjera të Allahut pa ekzistimin e kësaj cilësie. Shih: Ibid, f. 111-112. 17. Është e pafillim, që ekziston nga vetë Qenia e Allahut. Ka të bëjë me ato që mund të dëgjohen (mesmuat) ose me ekzistencat. Ky dëgjim bëhet në mënyrë absolute dhe jo nëpërmjet efektit të shqisës apo përmes përcjelljes së ajrit. Shih: Ibid, f. 104. 18. Cilësi e përjetshme që ekziston nga vetë Qenia e Allahut xh.sh. Ka të bëjë me ato që mund të shihen (mubarat) ose me ekzistencat. Ky shikim arrihet në mënyrë absolute dhe të pavarur nga shqisa apo rrezet. Ibid, f. 104. 19. Edhe kjo cilësi është e përjetshme dhe ekziston nga vetë Qenia e Lartë. Ai flet me të folurit e Vet hyjnor. Allahu xh.sh. urdhëron, ndalon dhe lajmëron. Të folurit e Tij nuk është i ngjashëm me atë njerëzor, e as me ndonjë të folur tjetër. Shih: Ibid, f. 106. 20. Këto janë në përgjithësi cilësitë diktuese (el-me'ani). Duhet t'i besojmë këto cilësi të Allahut xh.sh. dhe t'i mohojmë të kundërtat e domethënieve të tyre. Shih: Ibid, f. 112. 21. Cilësitë sifatum ma'nevijetun, rezultuese kuptimore (kualifikimi, zotësie), janë të pandashme nga shtatë cilësitë el-me'ani-diktuese dhe janë rrjedhime që burojnë nga pohimi i cilësive el-me'ani. Shih: Ibid, f. 113.

Resul ef. Rexhepi

# O njeri, pse nuk pendohesh?!

“Thuaj: “O robërit e Mi që keni tejkaluar caqet kundër vetvetes (duke bërë gjynahe)! Mos i humbisni shpresat nga Mëshira e Allahut, po Allahu i falë të gjitha gjynahet. Vërtet që Ai është Falës i Madh, Mëshirëplotë.”<sup>1</sup>

## Hyrje

Allahu i Madhërishtëm e ka krijuar njeriun me një natyrë të ndryshme nga krijesat e tjera, me mundësi për t'u orientuar edhe kah e mira edhe kah e keqja. Prandaj, njeriu, nëse orientohet drejt së mirës, ai mund të arrij gradën e melaqeve, sikundër që, nëse shkon kah e keqja, mund të bjerë në një shkallë më të ulët se kafshët.<sup>2</sup> Ndonëse Allahu ka kërkuar nga njeriu që ai t'i përmbahet rrugës së Tij, t'i respektoj urdhëresat dhe ndalesat e Tij, ai, megjithatë nganjëherë, me vetëdije ose pa të, me qëllim ose pa të, mund edhe të futet në vorbullën e mëkateve, të bëjë gabime prej më të ndryshmeve, të bëjë gjynahe.

Gjynahu, si fenomen, daton që nga njeriu i parë Ademi a.s., i cili i nxitur nga shejtani i mallkuar, e shtyri që ta hajë pemën e ndaluar (pemën e përjetësisë - shegjeretulluldi). Me këtë veprim, Ademi nuk e respektoi udhëzimin e Allahut dhe bëri veprim të gabuar përse meritoi dënimin. Kështu që, bërja e gabimeve ka vazhduar që nga hazreti Ademi e do të vazhdojë derisa të ketë jetë në këtë Tokë. Në të vërtetë, ata, Ademi a.s. dhe Hava, qenë të ndërgjegjshëm për gabimin e bërë, prandaj me përlësi i kërkuan ndjesë Allahut:

“Ata (të dy) thanë: “Zoti ynë! Ne gabuam dhe dëmtuam vetveten, e nëse Ti nuk na falë dhe nuk na mëshiron, sigurisht se do jemi nga të humburit.”<sup>3</sup>

**Pendesa ose pendimi është që njeriu ta ndjenë në shpirtin e tij ndjenjën e pishmanllëkut, të pendohet për veprën e ligë që ka bërë dhe të vendos me sinqeritet që të njëjtën ose të ngjashme më mos me bërë.**

Natyrisht, Allahu i Gjithëmëshirshëm, i Cili është pranues i pendimit dhe Falës i Madh, Ademit dhe Havasë ua pranoi pendimin - teuben dhe i fali. Duke qenë se, mëshira e të Madhit Zot gjithmonë ka qenë mbi çdo gjë, dhe, pikërisht, falë kësaj mëshire të pakufizuar, njerëzimit iu ka dhuruar edhe mundësia e pendimit dhe e kërkim-faljes, e që me të drejtë mund të konsiderohet ndër dhuntitë më të mëdha të Allahut ndaj robërve të Tij.

Ç'është në të vërtetë pendimi ?

Në gjuhën arabe, nocioni “pendesë” kuptohet nga shprehja “et-teubetu” dhe derivatet që dalin



nga kjo. Ç'është në të vërtetë pendimi?

Pendesa ose pendimi është që njeriu ta ndjenë në shpirtin e tij ndjenjën e pishmanllëkut, të pendohet për veprën e ligë që ka bërë dhe të vendos me sinqeritet që të njëjtën ose të ngjashme më mos me bërë. E njëjtë me këtë është edhe kërkim falja (istigfari), madje aq sa në përdorimin e zakonshëm njëra është bërë sinonim i tjetrës. Lidhur me pendesën - teuben, për ta kuptuar akoma më saktë, nuk mund e të mos e përmendim me këtë rast hadithin e Pejgamberit a.s., i cili me një rast kishte thënë:

Abdullah ibni Ma'kili tregon: babai im ka qenë bashkë me Abdullah ibni Mesudin dhe e kishte dëgjuar duke thënë: e kam dëgjuar Pejgamberin a.s. kur thoshte: "Të pendohesh (të ndjehesh pishman) nga mëkati quhet teube."

Ndërkaq, me një rast tjetër, Pejgamberi a.s. kishte thënë: Transmeton Abdullah ibni Mesudi se Pejgamberi a.s. kishte thënë: "Të pendohesh nga mëkati, do të thotë ta braktisësh mëkatin dhe mos të kthehesh kurrë më në të."<sup>4</sup>

Nga thëniet pejgamberike kuptohet se pendesa është e kushtëzuar me sinqeritet, jo thjesht një formalitet, sepse në të kundërtën, ajo nuk do të kishte ndonjë vlerë.

## Pendimi-teubeja në dritën e disa ajeteve kuranore

Pendimi gëzon vend meritore në ajetet e Kuranit, është i përmendur shpeshherë dhe në kontekste të ndryshme. Me këtë rast, do t'i përmendim vetëm disa prej tyre, aq sa për të vërtetuar se sa rëndësi madhore ka ky parim tejet i rëndësishëm islam.

Megjithatë, që në fillim duhet potencuar se, kur besimtari e konsideron këtë parim dhuratë të Allahut të Gjithëmëshirshëm ndaj robërve të Tij, i cili për të qenë me efekt të plotë duhet detyrimisht t'i plotësoj kushtet

e nevojshme, e mbi të gjitha të jetë me shumë bindje dhe sinqeritet. Lidhur me këtë, i Madhi Zot në Kuran ka urdhëruar: "O ju që besuat! Pendohuni te Allahu me pendim të vërtetë (të sinqertë). Është për të shpresuar se ndoshta Zoti juaj t'ju mbulojë gjynahet tuaja dhe t'ju bëjë të hyni në xhenete nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Ditën që Allahu nuk do e turpërojë Pejgamberin dhe ata që besuan me të. Drita e tyre do të ndriçoj para tyre dhe nga ana e djathtë e tyre, dhe do të thonë: "Zoti ynë! Na e plotëso dritën tonë dhe na falë ne! Vërtet Ti je në gjendje me bërë gjithçka."<sup>5</sup>

E pra, për të qenë pendesa e pranuar, ajo para së gjithash duhet të jetë plotësisht e sinqertë, sepse vetëm ajo të rikthen në rrugë të drejtë, në rrugë të Zotit. I Madhi Zot është kurdoherë i gatshëm me pranuar pen-desën e robërve të Tij e mos me i lënë të humbur në humnerë. Kurani këtë e ka theksuar shumë qartë: "Ai (Allahu) është i Cili pranon pendimin nga robërit e Tij dhe falë gjynahet dhe Ai di mirë se çka bëni ju!"<sup>6</sup>

Ndërkaq, në suren "Nisa" shprehet qartë dëshira e të Madhit Zot që robërit e Tij gjynahqarë të pendohen: "Allahu donë t'jua pranoj juve pendimin, kurse ata që ndjekin epshtet e tyre, duan t'ju largojnë larg e më larg (nga rruga e vërtetë)."<sup>7</sup>

Megjithatë, kurrë nuk duhet harruar se, ndonëse mëshira e Allahut është e pakufishme, se ajo përfshinë çdo gjë, se është më e madhe se akëcili mëkat i njeriut, i Madhi Zot nga kjo amnisti ka përjashtuar një kategori e ajo është shirku ndaj Zotit. Nëse besimi i besimtarit nuk është i plotë, por njolloset me shirk, atë Allahu nuk e pranon dhe rrjedhimisht edhe po të ketë pendesë, të tillëve nuk ua fal: "Padyshim se Allahu nuk fal që Atij t'i bëhet ortak në adhurim, ndërkaq Ai, përveç këtij mëkati, ia falë kujt të do. Kushdo që i bënë ortak Allahut, s'do mend se ai ka shpifur një gjynah të tmerrshëm."<sup>8</sup>

Madje, përtej kësaj, të tillëve Allahu xh.sh. ua ka ndaluar xhenetin, kështu që do të ngelën të privuar nga kënaqësitë e xhenetit. Allahu i Madhërishëm në Kuran ka thënë: "Nuk ka dyshim se ai që i bënë Allahut ortak, Allahu atij ia ka ndaluar xhenetin."<sup>9</sup>

## Disa emra të Allahut që kanë të bëjnë me faljen, pendimin dhe mëshirën

Lidhur me temën e trajtuar, e shohim të udhës që t'i përmendim disa nga Emrat e bukur të Allahut, sepse këta emra kanë rëndësinë e tyre të pa kontestuar, dhe se Ai i ka ata emra, se ai i meriton të njëjtët. Të tillë emra të bukur, Esmat-husna të Allahut, të cilët janë të natyrës së pendimit dhe faljes, më së miri e tregojnë rëndësinë e pendimit, e të tillë janë:

Err-Rahman - I Gjithëmëshirshëm,<sup>10</sup> "Falënderimi dhe lavdia i qoftë vetëm Allahut, Zotit të botëve. Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit."<sup>11</sup>

Err-Rahim - Mëshirëploti "...e ndaj besimtarëve qe Mëshirëplotë."<sup>12</sup>

El-Gaffar - Falësi i madh, "...dhe se Unë, vërtetë jam Falës për atë që pendohet, beson të vërtetën dhe bënë vepra të mira, pastaj përqendrohet në rrugën e drejtë."<sup>13</sup>

El-Vehhab - Dhuruesi: "Zoti ynë! Mos na i lërë zemrat tona të shmangën nga e vërteta pasi Ti na ke udhëzuar, dhe na dhuro mëshirë nga Mëshira Jote. Vërtet Ti je Dhuruesi më i Madh."<sup>14</sup>

El-Gafur - Ai që falë shumë: "Vërtet se Ai (Allahu) është shumë Falës dhe Mëshirëplotë."

El-Vedud - I Dashuri: "Ai (Allahu) është Falës i Madh dhe plotë Dashuri (për robërit e Tij)."<sup>15</sup>

Et-Tevvab - Pendimpranuesi: "Vërtet Ai (Allahu) është i Cili kurdoherë pranon pendimin (e robërve të Tij), dhe është Mëshirëploti!"<sup>16</sup>

“O njerëz!  
Pendohuni tek  
Allahu dhe  
kërkoni falje nga  
Ai, sepse unë  
pendohem nga  
njëqind herë në  
ditë.”

(*Muhamedi a.s.*)

El-Afuv - Falësi i gjynaheve: “Vërtet që Allahu është Ai që ju ndjenë, gjithnjë Falës i Madh!”<sup>17</sup>

Err-Reuf - I Dhembshuri: “Allahu është plotë mirësi ndaj robërve të Tij!”<sup>18</sup>

Këta emra të Allahut janë vetëm disa nga 99 sosh, të cilët janë edhe cilësi-atribute të Allahut nga rrafshi i pendimit, kërkim faljes, magfiritit dhe mëshirës. Këta emra të Allahut tregojnë shumë qartë se Ai i donë aq shumë ata që pendohen: “S’ka dyshim se Allahu i donë ata që pendohen sikurse dhe ata që pastrohen.”<sup>19</sup>

Nuk ka dyshim, gjithashtu, se Allahu i Gjithëmëshirshëm është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë ndaj krijesave të Tij e në veçanti ndaj njeriut, kurse ndaj besimtarëve Ai, Allahu, gjithmonë është me plot mëshirë, aq sa mëshira e Tij përfshinë çdo gjë: “Ndaj besimtarëve gjithmonë qe Mëshirëplotë.”<sup>20</sup>

Po, po, sepse Mëshira e Allahut ka përfshirë çdo gjë, tërë krijimin: “...E Mëshira Ime ka përfshi çdo send...”<sup>21</sup>

Madje, aq sa besimtarët që pendohen tek Allahu, besojnë bindshëm dhe veprojnë punë të mira, e po të tillëve Allahu ua zëvendëson veprat e liga me të mira, sepse Allahu gjithmonë është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë. Kjo është e konfirmuar në Kuran në mënyrë shumë precize: “...Përveç atij që pendohet, pastaj beson dhe bënë vepra të mira, të tillëve Allahu veprat e tyre të liga



ua zëvendëson me vepra të mira. Allahu gjithmonë është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.”<sup>22</sup>

## Praktika e Pejgamberit a.s. në raport me pendimin

Nuk ka dyshim se Pejgamberi a.s. është shëmbëlltyra më e përsosur në çdo aspekt të jetës e gjithashtu edhe kur bëhet fjalë për pendesën. Në këtë kuptim, vërejmë se ka shumë hadithe të Pejgamberit përkitazi me kërkim faljen dhe pendimin.

Pejgamberi a.s., ndonëse ka qenë njeriu që më së shumti është ruajtur nga mëkatet, ndonëse atij ia ka falur Allahu xh.sh. të gjitha mëkatet eventuale, të kaluarat dhe të së ardhmes, megjithatë ai shpeshherë iu ka drejtuar Allahut me lutje për ta falur. Ja se si e përshkruan El-Egarr el-Muzeni rastin e Pejgamberit: Transmeton El-Egarr bin Jesar el-Muzeni r.a., se ka thënë: ka thënë Pejgamberi a.s.: “O njerëz! Pendohuni tek Allahu dhe kërkoni falje nga Ai, sepse unë pendohem nga njëqind herë në ditë.”<sup>23</sup>

Jo vetëm kaq, por Resulullahu me një rast, siç transmeton Enes bin Maliku, kishte konstatuar: Enes bin Maliku tregon se Pejgamberi a.s. kishte thënë: “Të gjithë bijtë e Ademit janë gabimtarë, por më i miri nga gabimtarët është ai i cili pendohet.”<sup>24</sup>

Nuk ka dyshim se mëshira e të Madhit Zot ndaj robërve të Tij është shumë e gjerë, dyert e saj për ta janë vazhdimisht të hapura, Ai e zgjat

dorën e Tij ditën që të pendohet keqbërësi i natës, dhe e zgjat dorën e Tij natën që të pendohet keqbërësi ditës. Transmeton Ebu Musa el-Esh’arij r.a. se Pejgamberi a.s. kishte thënë: “Allahu e zgjat dorën e Tij ditën që të pendohet keqbërësi i natës, dhe e zgjat dorën e Tij natën që të pendohet keqbërësi ditës. Kjo zgjat deri sa të lind dielli nga Perëndimi.”

Për më tepër, Pejgamberi a.s. me një rast kishte konstatuar se besimtari që pendohet sinqerisht për mëkatet e tij, është sikurse ai që nuk ka fare mëkate, sepse mëshira e Allahut xh. sh. është aq e madhe sa që këtë ia mundëson besimtarit. Pejgamberi a.s. kishte deklaruar: Transmeton Ebu Ubejde bin Abdil-lahu se babai i tij (Abdullah ibni Mesudi) kishte dëgjuar Pejgamberin të ketë thënë: “Ai që pendohet nga mëkati është si ai që nuk ka bërë mëkat.”<sup>25</sup>

*1 Kurani, Ez-Zumer, 53, 2 Kurani, Esh-Shems, 7-8, 3 Kurani, El-A’raf, 23, 4 Transmeton Ibni Hanbeli, 5 Kuran, Et-Tahrim, 8, 6 Kuran, Esh-Shura, 25, 7 Kuran, En-Nisa’, 27, 8 Kuran, En-Nisa’, 8, 9 Kuran, El-Maide, 72, 10 Këta emra të bukur të Allahut, në Kuran përmenden në kontekste të ndryshme dhe më shumë se një herë, ne sa për ilustrim do ta përmendim vetëm nga një ajet për secilin prej tyre., 11 Kuran, El-Fatiha, 2-3, 12 Kuran, El-Ahzab, 43, 13 Kuran, Taha, 82, 14 Kuran, Ali Imran, 8, 15 Kuran, El-Buruxh, 14, 16 Kuran, El-Bekare, 54, 17 Kuran, El-Haxh, 60, 18 Kuran, El-Bekare, 207, 19 Kuran, El-Bekare, 222, 20 Kuran, El-Ahzab, 43, 21 Kuran, El-A’raf, 156, 22 Kuran, El-Furkan, 70, 23 Transmeton Muslimi, 24 Transmetojnë Tirmidhiu dhe Ibni Maxheh, 25 Transmeton Ibni Maxheh.*

Isa Tërshani

## Në përcjellje të Ramazanit

I themi lamtumirë me shpresë që agjërimi ynë në Ditën e Gjykimit të jetë ndërmjetësuesi ynë në lehtësimin dhe shpëtimin tonë nga pesha e asaj dite.

**T**ë nderuar besimtarë, po e përcjellim një muaj të veçantë, muajin Ramazan.

“...atij (njeriut) i takon ajo që e fitoi dhe atij i bie ajo (e keqe) që e meritoi...”<sup>1</sup>

I lumtë atij që e ka kaluar këtë muaj në adhurime dhe mirësi, ndërsa përcjellja e Ramazanit e lë duke qenë i falur nga Allahu xh.sh. për mëkatet e bëra. Çdo ditë e tij (Ramazani) ishte një thesar i çmuar, të cilin mund ta blinte çdokush, i riu dhe i moshuari, i sëmuri dhe i shëndoshi, i pasuri dhe i varfëri, pushtetari dhe njeriu i pa pushtetshëm.

Për ta fituar atë thesar, për hir të Zotit, agjëruam me besim të plotë

**Le të gëzohen ata besimtarë, që kanë vizituar të afërmit e tyre dhe shoqërinë e tyre, sepse Ramazani është muaj i respektit dhe afrimit ndërmjet tyre.**

dhe duke shpresuar për falje e mëshirë. U munduam që me përkushtimin tonë të jemi më afër Allahut xh.sh. dhe më afër njerëzve, sidomos atyre në nevojë. E kontrolloam gjuhën dhe nuk ramë pre e përgojimit dhe e thashethemeve. E braktisëm shtratin në mes të natës për ta ndjerë ëmbëlsinë e adhurimit dhe për t'i fituar begatitë e syfyrit. Lexuam Kuranin më shumë se në ditët e tjera dhe u thelluam më shumë te mesazhi i tij. E vizitua më shpesh xhaminë dhe e përmendëm më shumë emrin e Zotit. U munduam të jemi më të dashur, më të butë e më të paqësorë me njëritjetrin. E kërkuam dhe u munduam



## Nëse konstaton se sjelljet tua janë përmirësuar dhe ke ndryshuar për të mirë edhe pas Ramazanit, gëzohu, pasi është shenjë e pranimit të Ramazanit.

që Natën e Kadrit ta kalonim me adhurim dhe t'i luteshim Zotit që të caktonte më të mirën për ne. Myslimani nuk i gëzohet shkuarjes së këtij muaji, sepse ai është i bindur se ai sërish do të vijë nëse ka jetë ta pres, por i gëzohet përfundimit me sukses të një adhurimi sikur agjërimi, pas shkuarjes së të cilit pasojnë shpërblimet nga Allahu i Madhërishëm për agjëruarit. Transmetohet nga Ibni Mesudi r.a., se Muhamedi a.s., ka thënë:<sup>2</sup> “Sikur ithtarët e ymetit tim të dinin për dobitë e muajit Ramazan, me siguri që do të kishin dashur që i tërë viti të jetë Ramazan.”



Këtu është për qëllim nxjerrja në shesh e të gjitha atyre mirësive të cilat i ngërthen në vete muaji Ramazan, e për vlerën dhe mirësitë e shumta që i ka, e di vetëm i Madhi Zot. I themi lamtumirë këtij muaji me shpresë dhe dëshirë që Allahu i Madhërishëm të na i mundësojë t'i kalojmë edhe shumë ramazane të tjerë në paqe dhe lumturi. I themi lamtumirë me shpresë që agjërimi ynë në Ditën e Gjykimit të jetë ndërmjetësuesi ynë në lehtësimin dhe shpëtimin tonë nga pesha e asaj dite. Le të gëzohen ata besimtarë, që kanë vizituar të afërmit e tyre dhe shoqërinë e tyre, sepse Ramazani është muaj i respektit dhe afrimit ndërmjet tyre.

E lusim Allahun për të gjithë ata mësues e profesorë, të cilët për hir të këtij muaji të bekuar ua kanë lehtësuar agjërimin dhe mësimin nxënësve dhe studentëve tanë në përgjithësi. Po edhe ata pronarë që ua kanë lehtësuar punën punëtorëve të tyre. Shpërblimet e Allahut qofshin mbi të gjithë besimtarët që për hir të këtij muaji e dhuruan zekatulfitr-in (vitrat) për të varfrit, Medresenë dhe FSI-në. Aferim ju qoftë atyre që në agjërimin e tyre kanë qenë të kompletuar, dhe në çdo çast kanë shprehur devotshmërinë e tyre, në veçanti në ruajtjen e gjuhës nga fjalët e ulëta. Lumturia më e madhe është për ata, që edhe pas këtij muaji, do ta

vazhdojnë drejtimin e mbarë që e kanë marrë në muajin Ramazan. Kështu pra, duke i dhënë lamtumirën muajit Ramazan të kemi kujdes që mos t'i japim lamtumirën edhe shkuarjes në xhami, adhurimit, vepërimeve tona të mira si dhe solidaritetit tonë, por të bëjmë përpjekje shpirtërore që këto që i kemi arritur t'i aplikojmë edhe jashtë Ramazanit.

## Të vazhdojmë me vepra të mira

Transmetohet nga Aisheja r.a., se Pejgamberi a.s., ka thënë:<sup>3</sup> “Vepra më e dashur tek Allahu është ajo që ka vazhdimësi, edhe pse mund të jetë e vogël.”

A do të thotë vallë se pas një muaji intensiv, si në adhurim, ashtu edhe në sferën shoqërore, secili duhet t'i kthehet jetës së tij të mëparshme, si zakonisht?! Apo, mos ndoshta nuk e kemi kuptuar qëllimin e vërtetë të agjërimit?

Megjithatë, ekziston një tregues dhe indikator, i cili na tregon nëse Zoti na i ka pranuar veprat e mira gjatë këtij muaji. Pra, prej teje pritet që edhe pas Ramazanit të vazhdosh me vepra të mira dhe të dobishme. Nëse i neglizhon adhurimet dhe rrëshqet në gjynahe, frikësohu.

Nëse konstaton se sjelljet tua janë përmirësuar dhe ke ndryshuar për të mirë edhe pas Ramazanit, gëzohu, pasi është shenjë e pranimit të Ramazanit. Dijetarët thonë se vazhdimësia në vepra të mira është shenjë se dikujt i është pranuar agjërimi dhe veprat e mira. Prandaj, le të marrim mësim nga shembulli i shkëlqyer i muslimanëve të parë, të cilët gjashtë muaj pas Ramazanit i luteshin Zotit t'ua pranonte agjërimin dhe veprat e mira. I lutemi Zotit të na i ketë pranuar ibadetet gjatë Ramazanit! Amin!

1. El-Bekare, 286.2. Ibni Maxhe. 3. Buhariu, 6465. Muslimi, 783.

Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

# Jetën e kalojmë duke fituar pasuri

Kur televizioni erdhi në shtëpitë tona, harruam si t'i lexojmë librat.

Kur automjeti erdhi para dyerve tona, harruam të ecim.

Kur i morëm mobilët dhe kompjuterët, harruam të shkruajmë letra.

Për shkak të veprimtarisë me bankat, harruam vlerën e të hollave.

Pas paraqitjes së parfumeve të ndryshëm, harruam aromën e trëndafilut.

Për shkak të paraqitjes së ushqimit të shpejtë (fast food), harruam të gatujmë ushqimin.

Për shkak të paraqitjes së WhatsApp-it, harruam të vizitojmë farefisën dhe miqtë.

Kur vdesim, të hollat tona mbesin në bankë, edhe pse derisa jemi gjallë nuk kemi të holla të mjaftueshme të harxhojmë. Në të vërtetë, kur vdesim shumë të holla tona do të mbesin pa u harxhuar.

Pas vdekjes së një pasaniku kinez, e veja e tij u martua me shoferin e burrit të saj. Kur u kurorëzuan, shoferi tha: "Tërë kohën kam menduar që punoja dhe i shërbeja zotërisë tim, po tani kuptova që zotëria im tërë kohën paska punuar për mua."

Në mobilin tuaj më të mirë, 70% e përmbytjes nuk ju nevojitet.

Në automobilat më të shtrenjtë, 70% të pajisjeve shtesë dhe shpejtësisë nuk do të ju shpëtojnë.

Nëse keni shtëpi apo vilë të madhe e luksoze, 70% e hapësirës nuk shfrytëzohet.

Sa i përket rrobave, 70% rrallë apo asnjëherë nuk i përdorni.

Jetën e kalojmë duke fituar pasuri, ndërsa 70% të saj e shfrytëzojnë tjerët, e jo ne.

Andaj, duhet të kënaqemi me 30% që na takon.

Shkoni te mjeku edhe nëse nuk ankoheni në sëmundje.

Mësoni të harroni, qoftë edhe kur bëhet fjalë për një problem të madh.

Bëhuni modest madje edhe kur jeni të pasur dhe të fuqishëm.

Mëshohuni të jeni të kënaqur edhe nëse nuk jeni shumë të pasur.

Trajnioni mendjen dhe trupin, madje edhe kur jeni tejet të zënë.

Ndani kohë për ata që i doni.

Në veçanti gjeni kohë për vete që të lexoni, meditoni, shfrytëzoni kohën e lirë për ibadete vullnetare (dhikër, lexim të Kuranit, namaz të natës) dhe më shumë madhëroni dhe falënderoni Allahun për begatitë e dhëna.



Prof. dr. Fikret Karçiç

# Analiza tekstuale në studimin e Kuranit<sup>1</sup>

Sipas një definicioni teologjiko-ligjor mysliman, Kurani është «fjalimi i shpallur te Pejgamberi a.s., leximi i të cilit paraqet akt përkushtimi, surja më e shkurtë e të cilit është sfidë për njerëzimin që të nxjerr në pah diçka të tillë, çdo shkronjë e të cilit është transmetuar te ne përmes zinxhirit të padiskutueshëm (autentik) të autoritetit (tevatura / tawātur), i cili është shkruar në mes të kopertinave të Mus'hafit, duke filluar nga surja el-Fatiha dhe duke përfunduar me suren en-Nas.<sup>2</sup>

Kurani, pra, është fjalim i shpallur i Zotit, i cili është i pamundur për t'u imituar, i shpallur në gjuhën arabe, i regjistruar në Mus'haf dhe i ruajtur pa ndonjë ndryshim. Kurani, njëkohësisht, është teksti gojor dhe i shkruar. Ai është Kuran ("lexim") dhe Kitab ("Libër").<sup>3</sup> Myslimanët, për këtë arsye, kanë zhvilluar shkenca të veçanta që merren me aspektet gojore dhe të shkrimit të Kuranit. Me shkrimin e tekstit të Kuranit merret ortografia kuranore (kitāba, rasm ose nash al-Qur'ān). Me tekstin verbal të Kuranit merret "shkenca e leximit" (ilm el-kira'at / 'ilm al-qirā'āt). Kjo shkencë merret me mënyrat e ndryshme të leximit të tekstit kuranor duke krijuar dallimin në mes mënyrave të pranueshme dhe të papranueshme (të leximit). Kjo disiplinë është unike në mesin e shkencave që merren me libra të shpallur në fetë komparative. Përveç kësaj discipline, ekziston edhe disiplina e recitimit të saktë dhe të

**Kurani është fjalim i shpallur i Zotit, i cili është i pamundur për t'u imituar, i shpallur në gjuhën arabe, i regjistruar në Mus'haf dhe i ruajtur pa ndonjë ndryshim. Kurani, njëkohësisht, është teksti gojor dhe i shkruar.**

bukur të leximit të Kuranit, teganni (tağanni) / intonacioni, tertil (tartīl) / "të mësuarit", texhvid (tağwīd) / recitim.

Qëllimi i parë i analizës tekstuale - vërtetimi i autenticitetit të tekstit - në kuptimin e tekstit kuranor është arritur nëpërmjet konceptit të zbulësës (ihbar / 'ihbār) dhe transmetimit (nakl / naql). Dijetarët e usul el-fikhut e shpjeguan këtë metodë të vërtetësisë së autenticitetit të tekstit (thubut en-nass), si më poshtë. Pejgamberi ynë, a.s., mori shpallje nga Allahu xh.sh., dhe këtë ua përhapi (ihbar) bashkëkohësve të tij. Bashkëkohësit e tij (sahabët) këtë e mësuan nëpërmjet të dëgjuarit (sem' / sam') e shpalljes së Pejgamberit. Gjeneratat e mëvonshme e pranuan tekstin e Kuranit përmes transmetimit

(tevaturo / tawātur). Dëgjimi i shpalljes së caktuar dhe tevaturori kanë të njëjtën vlerë për vërtetimin e autenticitetit.<sup>4</sup> Kështu, i tërë Kurani posedon autenticitetin absolutisht të vërtetuar (kat'ijje eth-thubut / qat'iyya al-tubūt). Teksti kuranor që ne e lexojmë sot është i njëjti tekst që iu shpall Pejgamberit a.s., dhe kjo është absolutisht e vërtetuar, e cila bën një prej çështjeve të besimit për myslimanët.<sup>5</sup>

Të dyja koncepte - ihbar dhe nakl - do të thonë se Kurani është tekst (metn) të cilin Pejgamberi a.s., e transmetoi nga Allahu xh.sh., dhe se është transmetuar nga një gjeneratë në tjetrën me transmetim me karakter tevaturoren. Tevaturo është "raportimi i njëpasnjëshëm i një grupi që jep njohuri për faktin që u është raportuar."<sup>6</sup> Transmetimi mutevatir është ai transmetim i cili është i njohur si i vërtetë, pa referim në ndonjë faktor tjetër përveç në vetë atë. Ky lloj i transmetimeve na jep një njohuri të sigurt në vetvete (jekin / yaqīn) dhe nuk kërkon kurrfarë prove të jashtme (karīna / qarīna) për vetë konfirmim. Prandaj, dijetarët myslimanë nuk kërkonin ndonjë provë të jashtme, në përjashtim të provave kuranore, për të treguar të vërtetën e tekstit kuranor. Në të kundërtën, e vërteta kuranore i shtyri myslimanët për të studiuar Universin, dhe për të zbuluar dhe kuptuar ligjet e Zotit që e lëvizin atë.

Nëse dikush dëshiron të vënë në pikëpyetje vërtetësinë e dëshmimeve të tekstit kuranor me dëshmi të jashtme,





atëherë duhet të ketë në vëmendje gjëra të mëposhtme. Në aspektin e përmbajtjes, teksti kuranor përmban deklarata të cilat i përkasin kategorive të ndryshme: tevhidin (të mësuarit rreth Zotit), tedhkir (“premtimin dhe paralajmërimin”, eskatologjinë), ahkam (rregullat e sjelljes) dhe ahbar (lajmërimet për ngjarjet e ndodhura). Deklaratat në lidhje me këto katër kategori ndryshojnë nga njëra-tjetra për sa i përket karakteristikave të verifikimit përmes provave jashtë tekstuale. Të gjitha deklaratat në lidhje me botën e padukshme (gajb / gayb) nuk mund të kontrollohen me anë të përvojës njerëzore. Shprehjet që përmbajnë normat, nga natyra e tyre, nuk janë subjekt i verifikimit, sepse normat nuk përmbajnë as të vërtetën e as gënjeshtërinë, por vejnë rregulla të sjelljes. Më në fund, lajmet në lidhje me ngjarjet në historinë njerëzore mund të verifikohen përmes eksplorimit njerëzor. Për shembull, deklarata në Kuran: “Bizantinët (rumët) u mundën, në tokën më afër (tokës së arabëve), po pas disfatës së tyre, ata do të ngadhënjëjnë.” (Er-Rum, 2-3). Historiani mund të gjejë prova tekstuale për këtë pretendim në burimet bizantine rreth humbjes që Perandoria Romake Lindore vuajti

nga Persia në Siri dhe Palestinë nga viti 614 deri në vitin 615 dhe fitoren bizantine mbi persianët në betejën e Issusit në vitin 623.<sup>7</sup> Megjithatë, dijetarët myslimanë kurrë nuk e lidhën të vërtetën e tregimeve kuranore për prova jashtë tekstuale që i jep dija relative e njeriut. Sipas epistemologjisë islame, Kurani është lajm nga Zoti (ḥabar 'an Allāh), dhe

**Çështja e të kuptuarit dhe interpretimit të Kuranit është subjekt i studimit të shumë disiplinave. Disa nga këto disiplina janë përqendruar në gjuhën, disa në stilin dhe disa prej tyre në strukturën e Kuranit.**

nga natyra e vet e jep të vërtetën absolute. Në këtë mënyrë, konceptet ihbar dhe en-nakl bi et-tevatur u përgjigjën në dy pyetje të analizës tekstuale në kuptim të tekstit kuranor: autenticitetin e tij dhe vërtetësinë.

Çështja e të kuptuarit dhe interpretimit të Kuranit është subjekt i studimit të shumë disiplinave. Disa nga këto disiplina janë përqendruar në gjuhën, disa në stilin dhe disa prej tyre në strukturën e Kuranit. Këto përfshijnë: analiza gramatikore ('i rāb), fjalët vështirë për të kuptuar (garā'ib / ġarā'ib), retorika (belāga / balāga), leksikologjia semantike (el-vuxhuh ve en-nedha'ir / al-wuġūh wa al-nazā'ir), mos përsëritja e tekstit kuranor (i'xhaz / i'ġāz), struktura dhe organizimi i tekstit (nadhḥ / naẓm), abrogimi (al-nasiḥ wa al-mansūḥ) dhe të ngjashme.

Disiplinat e tjera studiojnë ngjarjet që janë jashtë tekstit - kontekstin historik dhe vendin e shpalljes. Konteksti historik është subjekt i disiplinës rreth shkaqeve të shpalljes (ilm esbab en-nuzul / 'ilm 'asbāb al-nuzūl), kurse vendi i shpalljes studiohet në kuadër të disiplinës rreth sureve mekase dhe medinase (ilm mekki ve el-medeni / 'ilm makkī wa al-madanī).

Disiplinat që janë të lidhura me gjuhën dhe studimin e kontekstit historik dhe vendit të shpalljes janë në funksion të kuptimit dhe interpretimit të duhur të tekstit. Këto disiplina përfshijnë korniza të ndryshme ekzegjetike, parime dhe procedura të ndryshme.

Sipas kornizës referuese të interpretimit të Kuranit, ai ndahet në: interpretimin tradicional (tefsir bi el-me'thur / tafsir bi al-ma'tūr) dhe interpretimin racional (tefsir bi er-re'j / tafsir bi al-ra'y). Sipas kritereve të qasjes interpretuese, ekzistojnë: interpretimi gjuhësor (tefsir luġawī / tafsir luġawī), interpretimi juridik (tefsir fikhi / tafsir fiqhī), interpretimi mistik (tefsir sufi / tafsir šūfī), interpretimi teologjik (tefsir kelamī / tafsir kalāmī), etj.

Dijetarët islamë, po ashtu kanë zhvilluar një teori sistematike dhe metodologjinë e interpretimit - hermeneutikën (usul et-tefsir, menahixh et-tefsir). Sipas kësaj teorie, janë identifikuar kornizat ekzegjetike si dhe metodologjia graduale hermeneutike (rend i duhur i referencave gjatë procesit të interpretimit). Metodologjia ekzegjetike ndryshonte nga autori në autor. Megjithatë, ishte e mundur nxjerrja në pah e disa parimeve të përgjithshme. Për ilustrim, ne do të japim shembuj të parimeve dhe procedurave të përcaktuara në interpretim nga dy autorë bashkëkohorë myslimanë.

Amin Ahsan Işlahi (1906-1999) i ndau parimet ekzegjetike në dy lloje: (1) ato që janë në kuadër të tekstit kuranor dhe (2) ato që janë jashtë tekstit kuranor.<sup>8</sup> Në mesin e principeve të llojit të parë, vëmendje duhet t'i kushtohet gjuhës kuranore

(fjalorit, idiomave, strukturës, stilit), koherencës së shprehjes kuranore, paraleles tematike dhe paraleleve të tjera. Në principet e llojit të dytë bëjnë pjesë: sunnet mutevatir / sunna mutawātira ose praktika pejgamberike përgjithësisht e njohur normative - hadith apo tradita e transmetuar nga Pejgamberi a.s., asar / 'āṭār apo transmetime që burojnë nga sahabët, esbab en-nuzul / 'asbāb al-nuzūl ose ngjarjet historike që janë relevante vetëm atëherë kur vetë Kurani referon për to, komente të hershme kuranore, librat e shenjta të shpallura më parë, dhe më në fund, historia e vjetër arabe, për arsye se vetë Kurani rrëfen për ngjarje të kaluara – paraislame. Parimet që janë në kuadër të tekstit kuranor dhe sunnetit mutevatir nga kategoria e dytë përbëhet prej parimeve kategorike (kat'i / qaṭ'i), ndërsa shumica e të tjerëve janë parime të përgjithshme (dhanni / ḍanni).



Muhamed al-Dassuqi, i përmbodhi parimet e përgjithshme të qasjes në tekstin kuranor si në vijim:<sup>9</sup> 1) Fillimi me gjuhën e tekstit, t'u përmbahet rregullave të gjuhës arabe të Kuranit dhe t'i jepet përparësi kuptimit literal në krahasim me atë alegorik. 2) Fokusimi në qëllimin e parë të shpalljes së Kuranit - të jenë udhëzimet për njerëzimin - dhe interpretimi i fjalëve dhe qëndrimeve e caktuara në këtë dritë. 3) Të qasurit në tekstin kuranor duke qenë i vetëdijshëm për kohën e shpalljes si dhe kohën e interpretimit. 4) Të qasurit në tekstin kuranor sistematikisht duke marrë parasysh të gjitha ajetet që kanë të bëjnë me të njëjtën temë, hadithe dhe rrethana të shpalljes, duke i dhënë prioritet shprehjes së përgjithshme në krahasim me rrethanave të veçantisë së shpalljes.

Këto dhe përpjekje të ngjashme kanë vendosur kritere të duhura për një interpretim të vlefshëm të tekstit kuranor. Interpretimi i vlefshëm është i mundur kurse dallimet eventuale në kuptimin dhe interpretimin (e Kuranit) zgjidhen nëpërmjet mendimit të përgjithshëm ose dominues të dijetarëve islam.

*Përktheu dhe përshtati nga gj. boshnjake: Dr. Azmir Jusufi*

1. Prof. dr. Fikret Karčić, Metodi iстраživanja u islamskim naukama (kratak uvod), Botimi i parë, El-Kalem dhe CNS, Sarajevë, 2013, f. 33-38. 2. Taha Jabir al-Alwani, Usul al-Fiqh al-Islami. Source Methodology in Islamic Jurisprudence (Herndon, VA. USA: The International Institute of Islamic Thought, 1990), 5. Shih: Al-Mawsu'aa al-fiqhiyya (al-Kuwayt: Wizara al-'awqāf wa al-šū'ūn al-'islāmiyya, 1995) 33: 30; Yūsuf Qāsim, Mabādi' al-fiqh al-'islāmī (Kajro: Dār al-nahda al-'arabiyya, 1983), 173. 3. Qur'an, 56: 77-80. 4. Muḥammad Zakī 'Abd Al-Barr, Taqni'n 'uṣūl al-fiqh (Kairo: Maktaba dār al-turāt, 1409/1989), 38; Sayf al-Dīn al-'Āmidī, Kitāb al-'ihkām fi 'uṣūl al-'ahkām (Kajro: Dār al-kutub al-'hidiwiyya, 1914), 2:69. 5. Shih: Islamic Creeds: A Selection, pr. William Montgomery Watt (Edinburgh: Edinburgh University Press, 1994), 49, 58, 63, 76 etc. 6. Sayf al-Dīn al-'Āmidī, Kitāb al-'ihkām fi 'uṣūl al-'ahkām, 2:21. Përkthimi sipas Bernard G. Weiss, Search for God's Law, 274. 7. The Meaning of The Holy Qur'an by Abdullah Yusuf Ali, new edition with revised translation and commentary (Brentwood, USA: Amana Corporation, 1412/1992), 1008, nr. 3505, 3506. 8. Muṣṭansir Mir, Coherence in The Qur'an: A Study of Işlahi's Concept of Nazm in Tadabbur-i Qur'an (Cambridge, U.K.: Adab Books, 1986), 25. 9. Muḥammad al-Dassūqī, Manḥağ al-baḥṭ fi al-'ulūm al-'islāmiyya (Qatar: Dār al-'Awzā'i, 1984), 222-225.

Prof. ass. dr. Rexhep Suma

## Polemika, dialogu dhe debati

Islami si mesazh nga ana e Allahut xh.sh. është ngritur mbi bazën e paqes, sigurisë dhe mirësisë. Ai që në filltet e tij ka përjashtuar të gjitha format e dhunës mbi detyrimin e individëve që t'i përqafojnë vlerat dhe kulturën islame, por edhe nuk është përhapur nëpërmjet detyrimit.

Islami i ka kushtuar një rëndësi tejet të veçantë çështjes së ligjërimit dhe artit të folurit bukur në përgjithësi me të gjitha format. Mënyra e artikullimit të mendimit që del nga njeriu pasqyron mendjen e tij, natyrshmërinë e brendshme të tij, si dhe formën dhe edukatën që bartë me vete. Kjo ngase gjuha e të folurit te shoqëritë e botës në realitet është gjuha e sjelljes, dhe me këtë standard edhe vlerësohet. Kjo njëherësh na jep indeksin e qartë se sa është prezente vlera në atë ambient apo edhe sa thellë ka lëshuar rrënjë e keqja dhe korrupsionit në të. Nga ana tjetër, mësimet fetare kanë rregulluar formën e dialogut, polemikës ndërmjet njerëzve, duke ruajtur standardet dhe vlerësuar qenien njeri dhe duke pasur në fokus gjithnjë këtë. Nga këshillat që i jepte Llukmani birit të tij ishte: “Biri im, mos polemizo me dijetarët se do të urrejnë.” Bilal bin Sadi thoshte se nëse e sheh një njeri polemizues dhe

**“Në shumë biseda të tyre të fshehta nuk ka kurrfarë dobie, përveç (bisedës) kush këshillon për lëmoshë, për ndonjë të mirë ose pajtim mes njerëzve, e kush i bën këto duke pasur për qëllim vetëm kënaqësinë e Allahut, Ne do t'i japim më vonë (në botën tjetër) shpërblim të madh.”**

*(En-Nisa, 114).*

kokëfortë që bartë në vete egon, dije se ai e ka të garantuar humbjen.<sup>1</sup> Po ashtu transmetohet nga Uthman Enehdiu, se e kishte dëgjuar Omer bin Hatabin duke ligjëruar në mimber: “Ruajuni nga mynafiku i dijshtëm.” Të pranishmit e pyetën se si mund të jetë mynafiku dijetar? “Flet të vërtetën dhe vepron keq” - tha ai.<sup>2</sup> Kurse në një rast tjetër, hazreti Omeri r.a. paskësh thënë: “Fenë e shkatërrojnë tri gjëra: shkarja e gjuhës së dijetarëve, argumentimi i hipokritit me Kuran si dhe dijetarët e devijuar.”<sup>3</sup>

Para se të flasim mbi debatin, dialogun dhe polemikën, e shohim të rrugës të prezantojmë disa porosi kuranore që na japin sinjale se si duhet të zotërojmë edukatën e sjelljes në të folur, ligjërimit etj.. “Në shumë biseda të tyre të fshehta nuk ka kurrfarë dobie, përveç (bisedës) kush këshillon për lëmoshë, për ndonjë të mirë ose pajtim mes njerëzve, e kush i bën këto duke pasur për qëllim vetëm kënaqësinë e Allahut, Ne do t'i japim më vonë (në botën tjetër) shpërblim të madh.” (En-Nisa, 114). “Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët: ata të cilët janë të përlulur dhe janë të kujdesshëm gjatë faljes së namazit, dhe ata të cilët i shmangën të kotës (fjalë a punë).” (El-Muminun, 3). “(përkujtoni) Kur Ne morëm zotimin e bijve të Israilit; mos adhuronit tjetër kë, përveç Allahun, të silleni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj jetimëve, ndaj miskinëve (të varfërve) dhe njerëzve u thoni fjalë të mira; faleni namazin dhe jepeni zekatin, e pastaj ju e thytet





zotimin dhe përveç një pakice prej jush, ia kthyet shpinën zotimit.” (El-Bekareh, 83). “Zoti i juaj më së miri e di gjendjen tuaj, nëse Ai do, ju mëshiron dhe nëse Ai do, ju dënon, e ty (Muhamed) nuk të kemi dërguar rojë të tyre (nuk të besuam ty punën e tyre e t’i fusësh me dhunë në besim).” (El-Isra, 53). “Një fjalë e mirë dhe një lehtësim (që i bëhet lypësit) është më e mirë se një lëmoshë që përcillet me të keqe. Allahu nuk ka nevojë për askënd, është i Butë.” (El-Bekareh, 263). “E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: “Paqe!”” (El-Furkan, 63). “Dhe kur e dëgjojnë ndonjë llomotitje marrëzie, i kthejnë shpinën dhe thonë: “Ne kemi vepra tona e ju tuajat, qofshi larg nesh, ne nuk na duhen injorantët!” (El-Kasas, 55).

Allahu xh.sh. e ka lejuar polemikën me të gjitha format e saj, ku futen edhe debati e dialogu. Këto janë nga rrugët më të rëndësishme në thirrjen për te Zoti. Këtu nuk kemi për qëllim të shtjellojmë me hollësi mënyrat dhe kriteret e këtyre mjeteve. Dhe këtë më së miri e dëshmon edhe argumenti kuranor: “Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson tagutët, e i beson Allahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka

këputje. Allahu është dëgjues i dijshtëm!” (El-Bekareh, 256).

Në këtë fe thirret nëpërmjet prezantimit të qartë, paraqitjes së argumenteve dhe rrëzimit të së pavërtetës. Allahu i Plotfuqishëm thotë: “Përkundrazi, Ne të pavërtetën e godasim me të vërtetën dhe ajo (e vërteta) triumfon mbi të ndërsa ajo (gënjeshtra) zhduket. E juve (jobesimtarëve) u takon shkatërrimi, për atë që i përshkruani (Zotit, si fëmijë etj.)” (El-Enbija, 18).

Polemika (xhidal) në shqip do të thotë: Diskutim i gjallë, me përgjigje e kundërpërgjigje, që zhvillohet ndërmjet dy a më shumë njerëzve, palëve, partive etj.. Kur ndeshen pikëpamje të kundërta ose rrihen çështje politike, shkencore, letrare etj., bëj polemikë me dikë. Që është si polemikë; që përmban polemikë; artikull polemik.<sup>4</sup>

Debati (munadharah), do të thotë: Rrahje mendimesh ndërmjet dy a më shumë vetave rreth një çështjeje politike, shoqërore etj.; diskutim i gjerë, i hapur për një çështje me rëndësi; debat i gjallë (i ashpër); hynë në debat.<sup>5</sup>

Dialogu (hivar) në shqip do të thotë: Bisedë që bëhet ndërmjet dy a me shumë vetave, bashkëbisedim; rrahja e një çështjeje nga dy a me shumë veta duke biseduar drejt-përdrejt. dialogu (hivar) dhe lidhja

kuptimore që këto fjalë kanë me njëra-tjetrën, janë të një rëndësie të veçantë.<sup>6</sup> Ligjërimi i thirrësit islam duhet t’u përshtatet të gjitha situatave, për të përfshirë të gjithë njerëzit. Siç e kemi thënë edhe më parë, njerëzit dallojnë nga të kuptuarit e tyre, kultura dhe mënyrat se si ftohen në fe. Ndaj përdorimi i larmishëm i ligjëritimit duke u zhvendosur sa te dialogu, te debati dhe te polemika, është një nga armët më të forta të tij dhe një nga më të dobishmet për njerëzit. Nocioni dialog në Kuran përmendet në shumë raste: “Vërtet, Allahu dëgjoji fjalët e asaj e cila bisedoi me ty lidhur më burrin e vet, që u ankua tek Allahu; prandaj Allahu e dëgjon bisedën tuaj, Allahu dëgjon çdo bisedë dhe sheh çdo punë.” (El-Muxhadeleh, 1).

Pra, dialogu në kuptimin terminologjik ka kuptimin e debatit mes dy palëve apo më shumë që synon korrektimin e fjalës, sjelljen e argumentit, vërtetësinë e drejtës, shmangien e dyshimit. “Stil i bisedës ndërmjet dy palëve, në të cilin bëhet shqyrtimi dhe gjykimi i pikëpamjeve dhe ideve në mënyrë shkencore, metodologjike, kritikuese të ndërsjellë, për ta arritur vlerën e vërtetë të dialogut, e që është e vërtet me plot kuptimin e saj.”<sup>7</sup>

Në rrafshin tonë shqiptar, Kosova si shumicë myslimane vazhdimisht ka pasur qëndrime historike sa i përket zhvillimit të dialogut dhe manifestimit të tolerancës dhe kjo meritë është e shqiptarëve mysliman karshi pakicave të tjera joislame. Këto marrëdhënie janë ndërtuar nga thellësia e shekujve dhe vazhdojnë të ruhet me xhelozinë më të madhe sepse mbështetemi në mësimet hyjnore, ku pakicat janë amanet yni. Madje Allahu e urdhëroi Muhamedin a.s., t'i frojë për dialog, si e vetmja mënyrë për të arritur tek e vërteta. Allahu thotë: "Thuaju (o i dërguar): "O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njëri - tjetrin zot pos Allahut!" E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi myslimanë (besuam një Zot)!" (Ali Imran, 64).

Kurani na mëson se si duhet zhvilluar dialogu: "Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kur i thirrni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thoni: Ne i besuam asaj që na u zbrit dhe që u zbrit juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij." (El Ankebut, 46).

Po ashtu, në Kuran thuhet: "Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira." (En-Nahl, 125). "E për këtë shkak (të përçarjes së tyre), ti thirr dhe përqendrohu ashtu si të është urdhëruar dhe mos shko pas dëshirave e thuaj: "Unë kam besuar në librat që i shpalli Allahu, jam urdhëruar të mbajë drejtësi mes jush, Allahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj; Ne kemi përgjegjësinë e veprave tona e ju të veprave tuaja, nuk ka polemikë mes nesh dhe jush; Allahu bën tubimin mes nesh dhe vetëm te Ai është përfundimi." (Esh-Shura, 14-15).

Kjo urtësi, këshillë e bukur, pos tjerash është vendosje e një çështjeje

në vendin e saj, në kohën e saj aq sa mundet.<sup>8</sup> Pra, janë parime universale që e drejta evropiane ka se çfarë të implemetoj nga këto platforma juridike që prora janë aktuale, ai ishte i mëshirshëm edhe ndaj armiqve të tij. Edhe pse në jetë, Muhamedin a.s. e kishin sulmuar dhe kërcënuar me jetë, ai prapëseprapë nuk i mbylli dyert e dialogut me rrethin dhe ambientin e vet. Dikush i tha Pejgamberit a.s., o i Dërguar i Allahut, lutu kundër idhujtarëve ai tha: "Nuk jam dërguar mallkues, por jam dërguar mëshirë."<sup>9</sup>

Disa gjuhëtarë janë të mendimit se fjalët: polemikë, dialog, debat, diskutim (munakasha), etj., janë sinonime dhe kanë kuptim të njëjtë ose të përafërt.<sup>10</sup> Ai që ndjek përdorimin e këtyre fjalëve në Kuran dhe në traditën profetike, do të shohë se kanë gjëra shumë të përbashkëta në kuptim, por gjithashtu kanë edhe dallime që tregojnë se çdonjëra prej tyre ka nga një kuptim të caktuar. Për shembull, Allahu e ka urdhëruar polemikën, por pa caktuar formën e jashtme të saj, ndërkohë që caktoi të ishte me mënyrën më të mirë të saj.

"Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit." (En-Nahl, 125).

Ne mund të ndeshim në historinë e Profetit tonë, por edhe të atyre që qenë para tij, raste ku kanë debatuar dhe dialoguar. Allahu, duke parë bisedën që u bë mes Profetit dhe Haules, vajzës së Thalebes, e cila po ankohej për burrin e saj, e përshkroi si polemikë dhe dialog në të njëjtën kohë. Allahu, jobsimitarët kryeneçë i përshkruan si polemizues me të pavërtetën. Ai thotë: "Ne nuk i dërgojmë ndryshe të dërguarit pos vetëm si përgëzues e qortues. E, megjithatë, ata që nuk besuan polemizojnë me të, ta mbizotërojnë të vërtetën, dhe argumentet e Mia dhe atë me çka u qortuan i marrin për tallje." (El-Kehf, 56).

Allahu disa prezantime të fesë që profetët i bënë para popujve të tyre, i quan si polemika: "Ata thanë: "O Nuh, ti polemizove me ne dhe e zgjate polemikën tonë. Urdhëro, e nëse flet të vërtetën, silleni pra, të na godasë ajo me çka na kërcënohesh!" (32)

Allahu polemikën e quan edhe ngrënie me fjalë, - rragatë në shqip. (arabisht: mira 'un), si në fjalën e Tij: "E ti (Muhamed) mos polemizo për numrin e tyre vetëm ashtu në tërësi, dhe askënd mos e pyet për ta." (El-Kehf, 22).

Ibrahimi a.s. i solli prova (huxhe) mbretit dhe dijetarët këtë e kanë quajtur debat. I Dërguari i Allahut a.s. polemikën me diçka të pavërtetë e quajtur mira' (të hahesh me fjalë-rragaten). Ai thotë: "Unë bëhem garant për një shtëpi në rrethinat e Xhenetit, për atë që nuk hahet me fjalë (rragatet) edhe nëse ka të drejtë."<sup>11</sup>

Duke u nisur nga sa thamë, në pamje të parë këto fjalë muxhadaleh (polemikë) muhavereteh (bashkëbisedim), munadharah (debat) dhe mira (ngrënie me fjalë, rragatet), që përmenden në këto tekste, ose janë sinonime me ndonjë dallim të vogël në kuptim ose muhaurete, muna-dharah dhe mira, janë forma të xhidal-it (polemikës). Kjo është fjala e tyre përmbledhëse, ndërsa të tjerat janë degë të saj. Kjo e fundit ka të ngjarë të jetë edhe më e saktë.

Ibën Ethiri ka thënë: "El-muxhadale: është debat (munadharah) dhe grindje (muhasame).<sup>12</sup> Për këto fjalë ka edhe përkufizime filozofike e logjike, por nuk do t'i përmendi më gjatë, sepse këtu po trajtojmë çështje që kanë të bëjnë me thirrjen islame dhe jo me shkollën e teologjisë. Do të mundohem t'i thjeshtoj përkufizimet e këtyre fjalëve dhe t'i bëj sa më të kuptueshme për thirrësit dhe njerëzit.

Xhidal, nga ana gjuhësore do të thotë: ashpërsimi i grindjes, i kundërshtimit, dhe ai bëhet me fjalë.<sup>13</sup>

Ibën Ethiri ka thënë: xhidal, do të thotë përplasja e argumentit me argument.<sup>14</sup>

Xhidali, në përgjithësi, përkufizohet si: prezantim i së vërtetës që mbart folësi dhe paraqitja e idesë së tjetrit si e gabuar, si dhe përgjigje ndaj paqartësive që ngre kundërshtari. Hivari (dialogu) në gjuhë do të thotë: përgjigje dhe diskutim.<sup>15</sup>

Dialogu përkufizohet si shkëmbim mendimesh ndërmjet palëve të ndryshme, duke dashur që secili të vërtetojë mendimin e tij, por pa pasur si qëllim thyerjen apo lëndimin e kundërshtarit. Në këtë rast, çdo palë paraqet idenë që ka, me fjalë të përmbledhura apo me një leksion të shkurtër, ku secili prezanton të vërtetën e tij, mundohet të zhdukë dyshimet dhe paqartësitë rreth saj, si dhe sqaron se ku qëndron gabimi i kundërshtarit dhe paqartësitë që ka. E gjitha kjo zhvillohet në një atmosferë qetësie, heshtjeje dhe vëmendjeje. Qëllimi i dialogut është të pasqyrohet e vërteta dhe pala tjetër të bindet nëpërmjet mirëkuptimit, këshillës dhe sqarimit. Gjykimi për të është gjykimi që ka edhe për vetë thirrjen islame, pra është detyrë për atë që ka mundësi. Në Kuran do të gjejmë forma të këtij dialogu, si për shembull në suren El-Kehf: “Atij ai shoku i vet (besimtari) i tha - duke e polemizuar atë: “A e mohove Atë që të krijoi ty nga dheu, pastaj nga një pikë uji, pastaj të bëri njeri të plotë?” (El-Kehf, 37).

Munadharah (debati) në gjuhë do të thotë: ndeshje me argumente. Debati përkufizohet si prezantimi i së vërtetës ose i së drejtës së njëres palë dhe zhvlerësimi i mendimit të palës tjetër. E gjitha kjo kryhet në formë pyetjesh dhe përgjigjesh, për ta detyruar, mundur dhe vënë në vështirësi kundërshtarit. Kjo është forma më delikate e më e vështirë e polemikës dhe ka nevojë për një art të veçantë, shumë më tepër sesa dija dhe të kuptuarit. Për këtë arsye, nuk lejohet që çdo nxënës dijeje të zhvillojë debate, sepse është një armë e mprehtë me dy presa. Kjo sepse mbrojtësi i së vërtetës mund të jetë i ditur dhe ka memorie të fortë, por ai nuk është i aftë të debatojë. Nëse ai futet në debat dhe dështon kjo do të

japë efekte negative ndaj së vërtetës që ai mbart, ndaj duhet pasur kujdes me këtë gjë.

El-Mira' (rrugatë, të hahesh me fjalë) në gjuhë do të thotë: polemikë. Rragata përkufizohet si polemikë e kotë. Allahu i Lartësuar thotë: “Ata që nuk i besojnë atij, kërkojnë ngutjen e tij, ndërsa ata që i besojnë, i frikësohen dhe e dinë se ajo është e vërtetë. Ta dini se ata që bëjnë polemikë, duke dyshuar në momentin e katastrofës së përgjithshme, janë në një humbje të thellë.” (Esh-Shura, 18).

Ndonjëherë kjo fjalë vjen në kuptimin gjuhësor: “E ti (Muhamed) mos polemizo për numrin e tyre vetëm ashtu në tërësi, dhe askënd mos e pyet për ta.” (El-Kehf, 22).

Polemika me të mirë do të thotë që të zhvillohet me një mënyrë sa më të mirë, me një prezantim të pranueshëm, pa sharë, fyer dhe tallur. Polemika më e keqe është ajo që zhvillohet me një mënyrë të keqe, pa etikë, me ndërprerje dhe të bërtitura, me fjalë të këqija dhe dalje nga diskutimi akademik në një diskutim personal etj..<sup>16</sup>

## Karta e Medinës dhe zhvillimi i dialogut

Për të drejtat që iu janë garantuar komunitetit fetar hebre si pakicë në shtetit e ri të Islamit më së miri e kemi shembullin në Kartën apo Kushtetutën e Medinës. Neni 16 i kësaj karte thotë: “Ata nga hebrenjtë që varen prej nesh, do të fitojnë të drejtën e ndihmës dhe mbështetjes nga ana jonë, pa u shkakuar padrejtësi dhe pa bërë bashkëpunim me kundërshtarët tanë.” Neni 24: “Në rast lufte ashtu si myslimanët e edhe hebrenjtë janë të detyruar që shpenzimet e luftëtarëve që zhvillojnë vetë, t'i përballojnë vetë.” Neni 35: “Personat që strehohen te hebrenjtë (bitane) do të trajtohen njëllor si vetë hebrenjtë.” Me këtë veprim Muhamedi a.s. vendosi një urë komunikimi të paparë deri më atëherë me këtë

komunitet, duke i konsideruar ithtarët e Librit si qytetarë plotësisht të barabartë me tërë myslimanët. Madje Islami kërkon nga ne që të tregojmë vëmendje shtesë ndaj pakicave (dhimmijve) duke thënë: “Kujdes, kush i bën zullum një “të besatuar”, apo ia pakëson të drejtën e tij, ose e ngarkon mbi kapacitetin e tij, ose i merr diçka pa pëlqimin e tij, unë do të jem armiku i tij në Ditën e Gjykimit.”<sup>17</sup>

Madje thotë: “Kushdo që vret një të “besatuar” nuk e ndien aromën e Xhenetit. Edhe pse, në të vërtetë, aroma e tij ndihet nga një distancë prej dyzet vjetësh.”<sup>18</sup>

Drejtësia jonë nuk duhet të ketë kufi, por ajo duhet të shtrihet dhe të gjejë terren edhe tek të tjerët që nuk na kanë bërë padrejtësi: “Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë. Allahu ju ndalon t'u afroheni vetëm atyre që ju luftuan për shkak të fesë, që ju nxorën prej shtëpive tuaja dhe që ndihmuan dëbimin tuaj; ju ndalon të miqësoheni me ta. Kush miqësohet me ta, të tillët janë dëmtues të vetvetes.” (El-Mumtehineh, 8-9).

1. El-Gazali, “Ihja ulumu-din”, 3/117. 2. El-Mutaki el Hindi, “Kenzul ummal fi sunenik akvali vel ef'ali Errisale”, Bejrut, 2008, v.10, f. 271. 3. Taberaniu dhe Imam Ahmedi. 4. Jani Thomai, Miço Samara, Pavli Haxhillazi, Hajri Shehu, Thanas Feka, Valter Memisha, Artan Goga. Fjalor i Gjuhës Shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2003, f. 829. 5. Jani Thomai, Miço Samara, Pavli Haxhillazi, Hajri Shehu, Thanas Feka, Valter Memisha, Artan Goga. Fjalor i Gjuhës Shqipe, Ibid. f. 173. 6. Ibid. 192. 7. Kajs Salim Muajitah, “Kriteret e dialogut në mendimin islam”, revista jordanze për studime islame, vëll. 3, nr.1, 2007, f.148. 8. Xhemil Saliba, “El mu'xheemul felsefi”, Esherikatul alemijetu lil kitabi, Bejrut, pa vit botimi, bot. i 5-të, f. 493-495. 9. Muslimi në sahih, libri “El birr ve es-sileh”, babu: “E-nehju an la'ni ed-devabbi” nr. 4704. 10. Kitab “El-Xhedel” e Ibën Akilit, f.16. “El-Lisan, el-kafije fi el-xhedel” f. 19. 11. Ebu Davudi, 4800. 12. En-nihaje fi garibi -l- hadith. 13. El-Lisan, 11/103. 14. En-Nihaje fi garibi el-Hadith. 15. Mu'xhemul vesit. 16. Adnan al Araur, “Menhexhu eddavefi fi dav'il kitab ve essune”, f. 262. 17. Ebu Davudi në Sunen, “El Harraxh, vel immrane vel fej'ë”, babu fit ta shiri ehli-dh-dhimeh, nr.2654. 18. Buhariu në sahih, kitab, “El Xhizje”, babu, “Ithmu men katele muahiden”, nr. 2930.

Dr. Ilmije Kuqi

# Marrja e fëmijëve në xhami, parim themelor, por sipas rregullave

**X**hamia ka një pozitë të lartë në Islam. Dyert e saj janë të hapura për të gjithë besimtarët, të moshuar qofshin ata apo të rinj, të mëdhenj apo të vegjël. Ajo është një inkubator edukativ për të gjithë pa përjashtim, është vend përkushtimi dhe nënshtrimi ndaj Zotit të Madhëruar, vend përkujtimi dhe madhërimi. Në të, njerëzit i gjen në ruku, në sexhde, duke lexuar Kuran, duke i kërkuar falje Zotit dhe duke medituuar për krijimin e Tij. Zoti i Plotfuqishëm në lidhje me të thotë: “(ajo dritë) Është në shtëpitë (xhamitë) që Allahu lejoi të ngrihen, e që në to të përmendet emri i Tij, t’i bëhet lutje Atij mëngjes e mbrëmje. Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin.”<sup>1</sup>

Xhamia, si vendi më i rëndësishëm për myslimanët, tërheq klasa të ndryshme njerëzish të të gjitha gradave, statuseve dhe moshave, e që në mesin e tyre hyjnë edhe fëmijët. Për marrjen e fëmijëve në xhami tregojnë një sërë tekstesh, siç janë: namazi i Pejgamberit a.s. duke bartur vajzën e vajzës së tij Umamen, lehtësimi i namazit nga ana e tij për shkak të të qarit të fëmijës, që të mos ia vështirësojë atë nënës së fëmijës dhe të ngjashme me këtë. Prandaj, mund të themi se është parim themelor që fëmijët të sillen në xhami, sepse shtëpitë e Zotit janë vende të edukimit të njerëzve të mëdhenj, të cilët janë të mbushur me dashuri ndaj Zotit.

**Rritja e fëmijëve në bindje ndaj Zotit të Plotfuqishëm ka shpërblim të madh dhe ky proces kërkon përpjekje, sinqeritet dhe lutje Zotit Fuqplotë për t’i udhëzuar fëmijët tanë drejt asaj që Ai do dhe është i kënaqur me të.**

Rritja e fëmijëve në bindje ndaj Zotit të Plotfuqishëm ka shpërblim të madh dhe ky proces kërkon përpjekje, sinqeritet dhe lutje Zotit Fuqplotë për t’i udhëzuar fëmijët tanë drejt asaj që Ai do dhe është i kënaqur me të. Nuk ka dyshim, se edukimi më i mirë i fëmijëve në bindje ndaj Zotit Fuqplotë, është mësimi i namazit dhe rrënjësia e dashurisë ndaj xhamive. Fëmijët duhet të mësohen t’i duan ato, në mënyrë që zemrat e tyre të vogla të lidhen me dashuri ndaj shtëpive të Zotit, në të cilat do të gjejnë: hallka ligjëratash, udhëzime, shoqërim të mirë, si dhe do të edukohen në kuptimet e besimit. Në lidhje me personin, zemra e të cilit është e lidhur për xhami, Pejgamberi a.s. ka thënë: “Shtatë lloje njerëzish do të jenë nën hijen e Arshit të Allahut, atë



ditë, kur nuk do të ketë hije përveç hijes së Tij: ..., një i ri që është rritur në adhurimin e Zotit dhe një burrë zemra e të cilit është e lidhur me xhamitë.”<sup>2</sup>

Një nga këta shtatë lloje, që është premtuar se Ditën e Gjykimit do të jetë nën hijen e Arshit, është i riu që është rritur duke iu bindur Zotit Fuqplotë, si dhe ai person, zemra e të cilit është e lidhur me xhamitë. Por, për të arritur te njeriu me zemër të lidhur për xhamitë dhe tek i riu që rritet në bindje ndaj Zotit, është e domosdoshme rritja dhe edukimi i fëmijëve që nga vegjëlia që t'i duan xhamitë. Andaj, ndër hapat e parë për të rrënjosur dashurinë për xhamitë te fëmijët është dërgimi i tyre atje dhe mësimi i tyre me to.

Ndoshta një ndër urtësitë e kësaj është mësimi i tyre në bindje ndaj Zotit dhe marrja pjesë në tubimet e xhematit që në fëmijërinë e hershme, sepse ato skena që shohin në xhami dhe ato që dëgjojnë nga dhikri, leximi i Kuranit, tekbiri, lavdërimi dhe madhërimi, kanë ndikim të fortë në shpirtat e tyre nga ata nuk e perceptojnë, i cili nuk largohet ose është e vështirë të largohet kur arrijnë moshën madhore dhe hyjnë në fushën e betejës së jetës dhe kurtheve të saj. Prandaj, qëllimi i marrjes së fëmijëve në xhami është për të rrënjosur dashurinë për vendet e shenjta në zemrat e fëmijëve tanë dhe ta bëjmë fëmijën të ndjejë anën shpirtërore dhe madhështinë e xhamisë, për të zhvilluar tek ata ndjenjën e rëndësisë së namazit dhe kryerjes së tij në kohën e vet, në formë kolektive, sepse fëmija mëson nga lëvizja më shumë se sa nga shpjegimi dhe nga ky këndvështrim garantojmë rritjen e një brezi të lidhur me xhamitë dhe duke qenë dashamirës të namazit, për të qenë element aktiv në shoqëri. Këtë e dëshmon ajo që ka thënë Profeti ynë i dashur, a.s.: “Urdhëroni fëmijët tuaj me namaz kur t'i mbushin shtatë vjeç, ndërsa ndëshkoni për të kur t'i mbushin dhjetë.”<sup>3</sup>

Hafidh Ibën Haxheri, në lidhje me këtë hadith, ka thënë: “Fëmijët nuk

**Disa namazli asnjëherë nuk i marrin fëmijët e tyre në xhami dhe kështu fëmija rritet duke mos u mësuar me xhaminë dhe duke mos e ndier vlerën e saj si shtëpi e Zotit.**

janë të ngarkuar (me këtë obligim), prandaj nuk është obligim për ta, por kërkesa u drejtohet prindërve që t'ua mësojnë atë atyre.”<sup>4</sup> Kjo që thotë Hafidh Ibën Haxheri është e vërtetë, se urdhërimi i fëmijëve për faljen e namazit nuk është i detyrueshëm për ta, para moshës shtatë vjeçare, por kjo nuk do të thotë se ne nuk duhet t'i mësojmë dhe të mos kërkojmë nga ata që të falen në xhami para kësaj moshe.

## Rregullat e marrjes së fëmijëve në xhami

Edukimi i fëmijëve që në moshë të re për t'i dashur xhamitë është një nga metodat e edukimit të drejtë për fëmijët, ashtu siç e theksuam më lart. Gjithashtu, mësimi i tyre për të marrë pjesë në to, çon në lidhjen e zemrave të tyre me to, si dhe në lidhjen e koncepteve të xhamisë në shpirtat e tyre me konceptet e namazit, përqendrimit, qetësisë dhe respektit. Prindërit që i rrisin fëmijët e tyre me këtë edukim, korrrin rezultate të mira.

Ka prindër që e kuptojnë rëndësinë e xhamisë në jetën e të rinjve, prandaj dhe rrënjosin te fëmijët e tyre dashurinë për shtëpitë e Zotit Fuqplotë. Ata i mësojnë se xhamia është për t'u falur në të dhe i nxisin

që të kujdesen për të, t'i pastrojnë dhe respektojnë, si dhe atyre u mësojnë të mbajnë qetësinë brenda saj. Këta prindër gjithashtu ua tërheqin vërejtjen fëmijëve të tyre, që të mos luajnë brenda xhamive, sepse ato janë shtëpitë e Zotit të Madhëruar. Kështu që fëmija mëson se ai është mysafir i Zotit në xhami dhe se ai duhet të respektojë dhe të mos luajë, të mos e ngrit zërin, të mos bërtasë, sepse kjo i shqetëson dhe i dëmton namazlitë.

Prandaj themi, xhamia, si vendi më i rëndësishëm për myslimanët, është një inkubator edukativ për të gjithë, duke përfshirë edhe fëmijët, ku personi, për sjelljen e tij në të, shpërblehet, për shkak të trajnimit, mësimi dhe adaptimit të tij me namazin me xhemat që nga fëmijëria. Por, shkuarja e fëmijëve në xhami duhet të jetë në përputhje me rregullat e saj, që të mos sjell dëme që e tejkalojnë dobinë. Ndër këto rregulla është përkujdesja e prindërve ndaj fëmijëve nga mosha e hershme me edukim dhe udhëzim në mbjelljen e vlerës së xhamisë dhe shenjtërisë së saj, si dhe qartësimin se ajo është shtëpia e Zotit të Madhëruar dhe nuk lejohet lozja në të dhe nuk lejohet ndotja e saj.

## Shqetësimi i namazlive

Nëse meditojmë, rreth realitetit të shumë myslimanëve lidhur me çështjen e marrjes së fëmijëve në xhami, vërehet se disa namazli asnjëherë nuk i marrin fëmijët e tyre në xhami dhe kështu fëmija rritet duke mos u mësuar me xhaminë dhe duke mos e ndier vlerën e saj si shtëpi e Zotit. Një grup tjetër i namazlive i sjellin fëmijët e tyre në xhami dhe më pas i lëshojnë ata, kështu që ata dalin dhe argëtohen dhe luajnë me gjërat në xhami, pra e marrin xhaminë si një vend për të luajtur që i ngjan një parku. Madje mund të shkojnë përtej duke dëmtuar vetveten kur luajnë me pajisjet elektrike dhe gjithashtu



shqetësojnë namazlitë duke kaluar para tyre ose duke lëshuar zhurma që shpërquendrojnë mendjen e tyre, dhe si rezultat i kësaj namazlitë e humbin përqendrimin. Kjo ndodh shpesh gjatë namazit të teravive në muajin e bekuar Ramazan. Kur falet namazi i teravive, shumë baballarë dhe nëna, të cilët janë ndër ata që i vizitojnë xhamitë dhe falin namazin në to, nuk kujdesen t'i udhëzojnë fëmijët e tyre me udhëzim të duhur, për të ndjekur etikën në respektimin e xhamive dhe shenjtërinë e tyre. Ky fenomen përhapet çdo Ramazan, në namazin e teravive në shumicën e xhamive në vendin tonë, veçanërisht në vendfaljen e grave dhe të gjithë namazlitë ankohen për këtë. Në shumicën e xhamive vërehet se kur gratë vijnë me fëmijë të vegjël, ato shqetësojnë namazlitë, ngase fëmijët e tyre luajnë në xhami me libra, mus'hafe etj., ecin ndërmjet rreshtave dhe argëtohen, dhe ndonjëherë ata bërtasin dhe qajnë. Prandaj, themi se gratë që kanë fëmijë të vegjël, të cilët nuk kuptojnë, të falen në shtëpitë e tyre, sepse namazi i gruas në shtëpinë e saj është më i mirë se namazi i saj në xhami. S'ka dyshim se nëse qëndrojnë në shtëpitë e tyre dhe falen në to dhe i mbrojnë fëmijët e tyre nga dëmtimet, kjo është më e mirë për to. Këtë e dëshmon hadithi, të cilin e transmeton Umu Humejdi, gruaja e Ebu Humejd es-Saidiut r.a., e cila ka thënë: "Shkova të Pejgamberi a.s. dhe i thashë: O i Dërguar i Allahut! Më pëlqen të falem me ty. Ai tha: "E di që të pëlqen të falesh me mua, por namazi yt në dhomën tënde (të gjumit) është më i mirë për ty se namazi në dhomën tënde të ndejës, kurse namazi yt në dhomën tënde të ndejës është më i mirë se namazi yt në shtëpinë tënde (darike),<sup>5</sup> ndërsa namazi yt në shtëpinë tënde është më i mirë për ty se namazi yt në xhaminë e popullit tënd, kurse namazi yt në xhaminë e popullit tënd është më i mirë për ty se namazi yt në xhaminë time."<sup>6</sup>

Kjo nuk do të thotë se gruas nuk i lejohet të falet në xhami. Përkundrazi,

Pejgamberi a.s. i ka ndaluar burrat që t'i ndalojnë gratë të dalin dhe të falen në xhami, por tregon se namazi në shtëpinë e saj është më i mirë dhe ka shpërblim më të madh. Këtë e dëshmon fjala e të Dërguarit tonë a.s., i cili në lidhje me këtë ka thënë: "Mos i pengoni gratë tuaja nga xhamitë, ndërsa shtëpitë e tyre janë më të mira për to."<sup>7</sup>

Kështu që gratë që nuk mund të shkojnë në xhami përveçse me fëmijët e tyre, qëndrojnë në shtëpitë e tyre dhe falen atje, sepse namazi i tyre në shtëpitë e tyre është më i mirë për to se namazi i tyre në xhami, sidomos në këtë rast kur fëmijët nuk pranojnë udhëzime. Kjo, për shkak se prioritet në Sheriat është që interesi i përgjithshëm ka përparësi ndaj interesit të individit. Prandaj, e drejtë e namazlive, kur janë të zënë me namaz, është të mos i shqetësojë ndokush.

Bazuar në këtë, themi se nëse fëmijët janë në moshën e aftësisë dalluese, duhet t'u bëhet e ditur se çfarë është xhamia dhe cila është shenjtëria e vendit ku shkojnë, sepse ajo ka më shumë privatësi dhe shenjtëri se vendet e tjera, si dhe ka ndalesa që duhet larguar nga ato. Atyre duhet t'u mësohen rregullat e mirësjelljes në xhami dhe urdhërohen që t'u përmbahen atyre, si dhe inkurajohen për të shkuar në të. Shkuarja e fëmijës duke qenë plotësisht i vetëdijshëm për qëllimin e shkuarjes së tij, çon në ruajtjen e atmosferës shpirtërore të namazlive, si dhe ruan shenjtërinë dhe pozitën e xhamisë. Kështu që, nëse fëmija është i vetëdijshëm për shenjtërinë e xhamisë, nuk ka kundërshtim për sjelljen e tij në xhami.

Sa i përket fëmijës që nuk respekton rregullat e xhamisë dhe insiston në mosrespektimin e saj, çështja e tij i ngritët kujdestarit të tij që ta dispijnojë dhe edukojë atë. Fëmija i tillë, nëse nuk dispijnohet, nuk sillet në xhami përderisa nuk mund të kontrollohet dhe të parandalohet nga shqetësimi dhe shpërquendrimi i namazlive. Kjo, për të ruajtur atmosferën shpirtërore

për namazlitë dhe për të mos shkatërruar shtyllat e qetësisë gjatë faljes së namazit, si dhe për të ruajtur shenjtërinë e vendit nga rrëmuja e fëmijëve që shoqërohet me sjellje të pakëndshme. Këtë e mbështesim me atë që e përmend Hafidh Ibën Kethiri, i cili ka thënë: "Umer ibën el-Hatabi r.a., kur shihte fëmijë duke lozur në xhami, ai i godiste ata me mihkefa, e që ky është shkopi dhe ai e kontrollonte xhaminë pas darkës dhe nuk e linte asnjë në të."<sup>8</sup>

Sa u përket atyre që janë nën moshën e aftësisë dalluese, të cilët nuk kuptojnë, nëse mund të jenë me të afërmit e tyre në mënyrë që të mos i shqetësojnë namazlitë dhe të mos e ndotin xhaminë, nuk ka asgjë të keqe në praninë e tyre. Por, nëse nuk është e mundur shmangia e shqetësimit dhe dëmtimit të namazlive, atëherë ata pengohen të hyjnë në xhami gjatë kohës së namazit, sepse e keqja që ndodh nga hyrja e tyre në xhami është më e madhe se sa dobia, dhe parimi është se largimi i së keqes ka përparësi ndaj përfitimit. Këtë duke u mbështetur në fjalën e Imam Malikut, i cili kur u pyet për fëmijët, me të cilët vihet në xhami, ai tha: "Nëse ai nuk luan për shkak të moshës së tij të vogël dhe ndalet nëse ndalohet (nga tjetri), atëherë nuk shoh asgjë të keqe në këtë. Dhe ka thënë: Nëse ai luan për shkak të moshës së tij të vogël, nuk mendoj se duhet të sillet në xhami."<sup>9</sup> Prandaj, kujdestarët e fëmijëve duhet t'i edukojnë ata me një edukatë të mirë, në mënyrë që ata të bëhen të denjë për të hyrë në xhami.

1. En-Nur: 36-37. 2. El-Buhari, nr: 660, 1/133, Muslimi, nr: 1031, 2/715. 3. Ebu Davudi, nr: 495, 1/133; Ahmedi, nr: 6689, 11/284-285, Shejh Shuajbi thotë: "Senedi është i mirë". 4. Fet'hu el-Bari, 9/348. 5. Fjala "Dar" është emër që përfshin shtëpinë dhe oborrin. 6. Ahmedi, nr: 27090, 45/37, Shejh Shuajbi thotë: "Hadithi është i mirë". Po ashtu, Ibën Haxheri, në Fet'hu el-Bari, 2/349, dhe Ez-Zerkani, në Sherhu ez-Zerkani al-ala el-Muvetta, 1/673, thonë: "Senedi i Ahmedi është i mirë". 7. Ahemdi, nr: 5468, 9/337; Ebu Davudi, nr: 567, 1/155; El-Muštredrek, nr: 755, 1/327, el-Hakimi thotë: "Ky hadith është sahih sipas kritereve të dy "shejhave". Këtë e miraton edhe Dhehebi. En-Nevevi në El-Hulasa, 2/678, thotë: "E transmeton Ebu Davudi me sened të saktë sipas kritereve të Buhariut". 8. Tefsir Ibën Kethir, 6/64. 9. El-Mudeveneh, 1/195.

Bajram Zeqiri

## “Kjo është ditë feste”

“Ju keni pasur dy festa në të cilat argëtoheshit gjatë tyre, tani Allahu ua ka zëvendësuar ato me dy të tjera më të mira: Fitër-Bajramin dhe Kurban-Bajramin.” (Muhamedi a.s.)

S’do mend se njerëzit gjatë jetës së tyre janë të prirë që të shënojnë me festime e gëzime ngjarjet e rëndësishme të jetës së tyre. Kjo gjë manifestohet edhe në fenë islame, ngase festat në Islam përkohjnë të bëhen pas kryerjes së dy prej kushteve themelore të Islamit, atij të agjërimit të muajit Ramazan, e që pasohet me festën e Fitrit, dhe atij të kryerjes së haxhit, e që pasohet me festën e Kurbanit.

Allahu i Madhëruar e ka bërë ditën e Bajramit ditë gëzimi e hareje për të gjithë myslimanët. Në këtë ditë myslimanët takohen e vizitohen ndërmjet vete. Ata festojnë e gëzojnë për suksesin e arritur me rastin e përfundimit të agjërimit të muajit Ramazan. Jo se gëzohen për përfundimin e Ramazanit, por gëzohen në shpirt, që me vullnet dhe me durim, arritën që t’i përgjigjen Zotit të tyre në thirrjen e Tij për agjërime. Gëzimin e agjërimit na e kishte mësuar edhe Pejgamberi a.s., kur kishte thënë se “Agjëruesi ka dy gëzime, gëzohet kur ta çelë iftarin e tij dhe gëzohet kur ta takojë Zotin e tij.”<sup>1</sup>

Bajrami është ndjenjë e fitores në zemrat e besimtarëve dhe në zemrat e atyre që përgatiten se si do të dalin para Allahut të Lartësuar. Festa e Bajramit është rasti thelbësor që me dinjitet besimtarët të tregojnë falënderimet ndaj Allahut të Lartësuar për begatitë e panumërta që Ai na i ka dhuruar, përfshirë këtu edhe muajin Ramazan, por edhe këtë Bajram që po festojmë. Në këtë ditë shfaqet shkëlqimi i mëshirës së

**Festa e Bajramit është manifestuar edhe në të gjallë të Pejgamberit a.s.. Madje ai kishte porositur Ebu Bekrin r.a., që t’i linte të loznin e të festonin vajzat e vogla që këndonin e festonin në shtëpinë e të Dërguarit a.s..**

Allahut, por njëkohësisht besimtarët në safat e tyre madhërojnë emrin e Zotit, duke forcuar kështu imantin në zemrat e tyre, por edhe duke falënderuar Zotin për fitoren dhe ngadhënjimin që kanë arritur me agjërimit të muajit Ramazan. Bajrami është një ditë e veçantë dhe duhet të jetë e tillë, si një ditë që harrohet pikëllimi e shqetësimi, si një ditë kur shumëfishohet gëzimi e hareja.

Edhe pse të dy Bajramet ishin shpallur qysh në vitin e parë hixhri, festimi i tyre është bërë në vitin e dytë hixhri. Me ardhjen e Pejgamberit a.s. në Medine, ai i kishte gjetur banorët e Medinës teksa festonin dy herë në vit. Këto ishin ditët e Nevruzit dhe Mirixhanit.<sup>2</sup> Në kohën kur Pejgamberi a.s. erdhi në Medine dhe i pa ensarët teksa festonin në dy ditë



## Fotografia e unitetit të besimtarëve gjatë Bajramit, duhet të jetë motivi ynë dhe shpresa jonë për të jetuar edhe ditëve të tjera të bashkuar.

të veçanta, ai i pyeti për karakteristikat e këtyre ditëve. Ata i thanë se në periudhën e injorancës argëtoheshim në ato ditë. Pas kësaj, Pejgamberi a.s. urdhëroi: “Pa dyshim se Allahu ato festa i ka ndryshuar me dy festa më të mira dhe më të vlefshme, e ato janë: Fitër-Bajrami dhe Kurban-Bajrami.”<sup>3</sup>

Festa e Bajramit është manifestuar edhe në të gjallë të Pejgamberit a.s.. Madje ai kishte porositur Ebu Bekrin r.a., që t'i linte të loznin e të festonin vajzat e vogla që këndonin e festonin në shtëpinë e të Dërguarit a.s.. Ishte dita e Kurban Bajramit në Medinë. Dy vajza të vogla në praninë e Aishes r.a. këndonin këngë dhe këndonin poezi me përmbajtje të luftës së Buathit, e cila kishte ndodhur para ardhjes së Islamit në Medinë. I Dërguari a.s. ishte në dhomën tjetër i shtrirë në shtratin e tij, i mbuluar dhe me shpinën e kthyer duke pushuar. Në atë moment hyri Ebu Bekri r.a. dhe me siguri duke menduar se janë duke e shqetësuar të Dërguarin e Allahut gjatë pushimit iu drejtua Aishes: “Pranë Pejgamberit me instrumente të shejtanit?!” Pas këtij reagimi të Ebu Bekrit, i Dërguari i Allahut zbuloi fytyrën dhe urdhëroi: “O Ebu Bekër! Mos u përziej me to sepse këto janë ditë feste.”<sup>4</sup>

Gjithashtu, gjatë jetës së Pejgamberit a.s., sidomos gjatë periudhës së Medinës, transmetohet se ai së bashku me sahabët e tij i kishte kaluar

festat në një atmosferë gëzimi e hareje. Transmetohet se në një ditë Bajrami, disa vajza të vogla po këndonin në xhami, ndërsa disa etiopianë bënë lojëra me shtiza dhe mburoja. I Dërguari a.s. së bashku me Aishen r.a. i kishin shikuar dhe ai e kishte parandaluar Omerin r.a. që të ndërhynte në shfaqje dhe nuk kishte lejuar shqetësimin e tyre.<sup>5</sup>

### Dita e Bajramit, ditë e veçantë

Duke qenë Bajrami një ditë gëzimi e lumturie për besimtarin, ajo ditë në vete ka edhe rregullat dhe traditat e shënimit të saj, ashtu siç na janë mësuar dhe transmetuar nga vetë i Dërguari i Allahut a.s.. Dita e Bajramit është ditë tubimi dhe grumbullimi i besimtarëve në faltoret e hapura, apo ndryshe siç i quajmë namazgja (vendfalje), me të cilën në njëfarë mënyrë shënohej edhe fillimi i festës së Bajramit. Në fakt, vetë tubimi i myslimanëve në një vend dhe drejtimi drejt një kible me ndjenja të njëjta është një festë në vete. Fotografia e unitetit të besimtarëve gjatë Bajramit, duhet të jetë motivi ynë dhe shpresa jonë për të jetuar edhe ditëve tjera të bashkuar dhe duke ndihmuar njëri-tjetrin. Meqenëse kushtet moderne që sot jemi duke i jetuar kanë bërë që njerëzit të largohen ndërmjet vete, është pikërisht dita e Bajramit, ajo që bashkon njerëzit, përqafohen ndërmjet vete, heqin mallin, pajtohen e afrohen me njëri-tjetrin. Bajrami duhet të shndërrohet në moment të përmbushjes së nevojave vëllazërore. Për nder të kësaj dite, duhet të pajtohen edhe ata që janë të hidhëruar, të pastrohen lidhjet dhe miqësitë, të bëhen vizita sinqeriteti tek të varfrit dhe skamnorët, që nëpërmjet saj të përfitohet afërsia e Allahut dhe afrimi ndërmjet njerëzve.

Zbukurimi dhe veshja e rrobave më të mira shënon njërën ndër mirësitë me të cilat kujtohet Allahu i Madhëruar dhe bukuria e Tij e përsosur. Edhe vetë Pejgamberi a.s. e

praktikonte këtë mirësi, duke veshur kështu rrobën më të mirë që kishte për festën e Bajramit. Transmetohet nga Ibën Omeri r.a., të ketë thënë: “Për Bajram, ai e vishte rrobën më të mirë dhe më të bukur që kishte.”<sup>6</sup>

Fitër-Bajrami karakterizohet me dhënien e sadakatul-fitrit, të cilën Pejgamberi a.s. e urdhëroi që myslimani ta bënte para se të dilte ta falte Bajramin (duke thënë:): “Sadakatul-fitri të jepet para daljes së njerëzve për në namaz.”<sup>7</sup> Po ashtu, gjatë festës së Bajramit të Fitrit, në bazë të mësimëve të Pejgamberit a.s., kuptojmë se ai: “nuk dilte nga shtëpia në ditën e Fitër-Bajramit derisa i hante disa kokrra të hurmave.”<sup>8</sup> Këtë gjë ai nuk e vepronte në ditën e Kurban-Bajramit, në të cilën nuk ushqej derisa kthehej e të hante nga kurban i tij.<sup>9</sup>

Shkuarja në Bajram në njërën rrugë dhe kthimi nga Bajrami në rrugën tjetër ishte traditë që e vepronte i Dërguari a.s. dhe pas tij kështu vepruan edhe Aliu, Omeri, Ebu Hurejra, Abdullah ibën Omeri r.a., dhe disa nga sahabët e tjerë.<sup>10</sup> Në një hadith të Pejgamberit a.s. thuhet: “Pejgamberi a.s. shkonte për në namaz të Bajramit në këmbë, e falte Bajramin pa ezan dhe ikamet, pastaj kthehej në këmbë nga ndonjë rrugë tjetër.”<sup>11</sup>

Për të treguar madhështinë dhe rëndësinë e ditës së Bajramit, Pejgamberi a.s. kishte kërkuar që edhe gratë të dilnin në namazgja (vendfalje), për t'i shijuar dhe për t'i përjetuar kështu gëzimet dhe të mirat që ka dita e Bajramit. Transmetohet nga Hafsa të ketë thënë: “Të nxjerrim jashtë vashat e rritura, edhe ato nga dhomat e grave, kurse ato që janë me menstruacione të shmangen nga namazgjaja (vendfalja).”<sup>12</sup>

1. Transmetojnë Buhariu, 1904 dhe Muslimi, 1151.  
2. Sherh Sunen Ibën Maxhe, 123. 3. Transmetojnë Ebu Davudi dhe Nesaiu. 4. Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi, marrë nga libri “Islami nëpërmjet haditheve, VII”, botoi: Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, fq.493. 5. Transmeton Buhariu, nr. 3530 6. Bejhakui në “Sunenul-kubra” (3/281). 7. Transmetojnë Buhariu, 1509 dhe Muslimi, 986. 8. Taberaniu në “Muxhemul-kebir” 9. Tirmidhiu, 542, Ahmedi e të tjerë. 10. Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, “Islami nëpërmjet haditheve VII”, fq. 495. 11. Transmeton Ibën Maxhe, 1300. 12. Transmetojnë Buhariu, 974 dhe Muslimi, 890.

Blerim Musliu

# Ti mos e bëj, ti je i veçantë!

Nëse të gjithë shkelin dhe nuk brengosen për haramë, ti brengosu, se ti je i veçantë!

**Z**oti i Plotfuqishëm e i Urtë, nga rahmeti i Tij nuk ka kërkuar nga ne, njerëzit, që të jemi të pagabueshëm. Por, Ai xh.sh. nga ne ka kërkuar që gabimet të mos na mbizotërojnë, e aq më pak të na bëhen vlera, por të jetë gjithmonë dikush që thërret për të mirë, t'i tregojë vlerat e së mirës, shpërblimet, si dhe të tërheq vërejtjen për të këqijat, shëmtimet e tyre dhe për dënimet, në mënyrë që njerëzit të dallohen se kush është i mirë e kush është i keq, kush beson e kush mohon, jo për të gjykuar, por që të ketë një garë të mirëfilltë dhe se pa dyshim që secili ta marrë atë që ka mbjellë.

Kur përgjatë historisë, e keqja bëhet dominuese dhe e mira mbetet e strukur dhe e turpëruar, pikërisht këtu duhet ta bëjmë shpërthimin e madh të mësimëve, në mënyrë që të



dëshmojmë se ne nuk i peshojmë punët me atë që e shohim përreth, e nuk punojmë atë që e punojnë të gjithë, vetëm se kështu duhet dhe se nuk bën ndryshe.

Pikërisht këtu dalin në shesh besimin në Zotin, pasimi i Pejgamberit a.s., e besimi në Ringjalljen, besime këto që na bëjnë të mos jemi si gjithë të tjerët, të mos veprojmë vetëm se po veprojnë të gjithë, të mos shkelim vlera e parime se po i shkelin të gjithë. Jo! Ti mos e bëj, ti je i veçantë, sepse besimi dhe pasimi është i veçantë.

Eja t'i referohemi disa mësimëve kuranore dhe profetike

Në fillimet e njerëzimit, Zoti na e sjellë tregimin e bijve të Ademit a.s., kur pas zënkës së tyre, njëri tha: “Dhe, nëse ti e zgjatë dorën tënde tek unë për të më mbytur, unë nuk e zgjasë dorën te ti për të të mbytur, unë i frikësohem Allahut, Zotit të botëve!”<sup>1</sup>

Jo se nuk ju dhimbsej jeta, jo se nuk donte të jetonte, jo se nuk kishte mundësi kundërvënie apo përballje me të, por tha se unë nuk jam si ti pavarësisht çmimit.

Ajo që më dallon mua është se kam frikë Zotin, ndërsa vetë Pejgamberi a.s. na e jep shembullin më të papërsëritshëm, kur atyre që ishin mbledhur për ta mbytur, për ta e kishte lënë Aliun r.a. përgjegjës që t'ua kthente amanetet që i kishin lënë te Pejgamberi a.s.. Pra ai nuk u bë si ata, nuk mendoi me logjikën e as me veprimet e tyre, ishte aq i veçantë, madje puna shkoi aq thellë sa që pas shumë shtypjesh, izolimesh, vrasjesh

e dëbimesh, i thanë lutu kundër tyre, e ai tha: “Nuk jam dërguar mallkues, por jam dërguar mëshirë.”<sup>2</sup>

Historia na tregon se burrat e mëdhenj dëshmuar se janë të veçantë

Kur Urve ibën Muhamedi, u dërgua mëkëmbës në Jemen, ai iu tha popullit, unë kam ardhur me këtë deve, nëse kur të kthehem, kthehem me diç më shumë, dijeni se ju kam vjedhur.

Ti mos vjedh edhe nëse të gjithë vjedhin, ti je i veçantë, merr shembuj nga këta burra.

Nëse të gjithë shkelin dhe nuk brengosen për haramë, ti brengosu, se ti je i veçantë, siç ishte Ebu Duxhane, i cili pas namazit të sabahut dilte me nxitim për disa ditë rresht. I Dërguari a.s. e ndali dhe e pyeti, pse nuk qëndron më gjatë në xhami, a nuk ke nevojë për shpërblimet e qëndrimin pas namazit në xhami? “Po, o i Dërguari i Allahut, por arsyeja është se një degë e palmës së hurmës së fqinjit tim çifut është në oborrin tim, e nga ajo po bien hurma në oborrin tim, e kam frikë se fëmijët zgjohen, e nga uria hanë diçka nga to, e unë dalë shpejt e i mbledh për t'ia kthyer në oborrin e fqinjit, që fëmijët të mos hanë diçka nga harami.”

Këto e shumë tregime që ndriçojnë si fanar në errësirë na tregojnë rrugën të cilën duhet ndjekur, për të dëshmuar se ti nuk i bën gjërat që thjesht i bëjnë të gjithë, por dëshmo se besimi na bënë të veçantë dhe se punët janë të veçanta nga vlera dhe përmbajtja e tyre.

1. El-Maide, 28. 2. Transmeton Muslimi, nr. 2599.

Msc. Abdullah Klinaku

# Thellësia historike e raporteve shqiptaro - turke

Në përpjekje për çlirimin e territoreve nga pushtuesi sllav, princër shqiptarë nisën bashkëpunimin me komandantët osman. Në bazë të kësaj, rrjedhimisht historia shqiptaro-turke nis që nga viti 1371, përkatësisht që nga 26 shtatori i vitit 1371, kur trupat osmane nën komandën e bejlerbeut të Rumelisë, Lala Shahin Pasha, korrën një fitore të rëndësishme ndaj trupave serbe në betejën e Çirmenit, pranë lumit Maricë.

**S**hqiptarët duke qenë populli më i vjetër në territorin ballkanik i cili shtrihet midis lindjes dhe perëndimit në kuptimin gjeografik, bizantinëve dhe romakëve në kuptimin historik, si dhe islamit dhe krishterimit në kuptimin fetar e civilizues, kanë krijuar raporte të ndryshme me etni, qytetërime, perandori e kombe me të cilat i ka prekur historia.

Ndër raportet më të diskutueshme në diskursin tonë shkencor, publik e politik janë raportet shqiptaro-turke, si në aspektin historik, ashtu edhe në atë aktual. Megjithatë duke ju referuar një momenti tejet të rëndësishëm historik të Perandorisë Osmane, por edhe të rolit të shqiptarëve në këtë ngjarje historike siç është çlirimi i Stambollit i cili ka ndodhur me 29 maj të vitit 1453, fokus i këtij trajtimi janë elementet e thelbësore që shpërfaqin thellësinë historike të raporteve shqiptaro-turke.

## Fillet e para të historisë shqiptaro-osmane

Gjatë pushtimit të plotë të Kosovës së sotme nga Serbia mesjetare, që nga viti 1196 e deri në vitin 1389 shqiptarët i ishin ekspozuar një



sundimi plotësisht konvertues në planin fetar dhe asimilues në atë etnik.<sup>1</sup> Pra, lufta sistematike për asimilimin e shqiptarëve ishte platformë e mirë hartuar nga popujt fqinjë, sllavë e grekë. Janë shumë dëshmi përmes të cilave dëshmohet lufta për asimilimin e emrave latinë (katolikë), toponimeve, rriteve e doktrinës fetare katolike, me qëllim zëvendësimin e tyre me doktrinën ortodokse. Ligji i car Dushanit që në fillimin e tij afirmonte synimin e “pastrimit” të fesë së rritit ortodoks nga riti katolik latin. Sipas burimeve kishtarë serbe, Dushani gjatë viteve 1334-1336 kishte ndërmarrë një

fushatë të egër të spastrimit të shqiptarëve të Dardanisë duke tentuar që t'i sllavizojë.<sup>2</sup>

Në përpjekje për çlirimin e territoreve nga pushtuesi sllav, princër shqiptarë nisën bashkëpunimin me komandantët osman. Në bazë të kësaj, rrjedhimisht historia shqiptaro-turke nis që nga viti 1371, përkatësisht që nga 26 shtatori i vitit 1371, kur trupat osmane nën komandën e bejlerbeut të Rumelisë, Lala Shahin Pasha, korrën një fitore të rëndësishme ndaj trupave serbe në betejën e Çirmenit, pranë lumit Maricë. Në këtë luftë u vranë despotët serbë Uglesha dhe Gojko, gjithashtu u vra edhe vëllai i tyre, kral Vukashini. Pas kësaj disfate të thellë të kral Vukashinit dhe aleatëve të tij ballkanas, viset e rrafshit të Dukagjinit me qytetet Prizren dhe Pejë, deri në Krivarekë të Novobërdës, hynë nën sundimin e Balshajve. Balshajt dëbuan prej viseve lindore të Kosovës knjazin serb L Lazar Hrebelanoviç, i cili zhvendosi selinë e tij në Krushec. Edhe selia e patrikanës serbe asokohe nga Peja qe vendosur në Zhiqë, aty ku edhe ishte para pushtimit të Kosovës.<sup>3</sup>

Derisa jemi në këto vite historike që nisin të ndjekin një dinamikë të rëndësishme deri në vitin 1389, princërit shqiptarë herë pas here nisin bashkëpunimet me ushtrinë osmane, bashkëpunime të cilat ishin të

vullnetshme dhe kishin synime për forcimin ndaj rivalëve të tyre në atë kohë. Gjatë kohës së Muratit I, osmanët nuk ndërmorën ndonjë nismë që të shtinin në pushtetin e tyre Shqipërinë dhe Epirin. Megjithatë ata u ftuan nga princërit e këtyre vendeve. Despoti i Janinës, Tomasi, në vitin 1382 kërkoi nga osmanët ndihmë ushtarake kundër suliotëve. E dy vjet më vonë, pas vdekjes së Tomasit, shqiptarët me ndihmën osmane e rrethuan Janinën. Lufta civile, që u shkaktua nga e veja e Tomasit, u hapi rrugë osmanëve që të depërtonin deri në Gjirin e Artës.<sup>4</sup> Të njëjtin bashkëpunim me ushtrinë osmane e kishte pasur edhe Karl Topia, kur në vitin 1385 kishte kërkuar ndihmën e osmanëve për të sulmuar Balsha II, i cili ishte dëbuar nga Durrësi.<sup>5</sup>

Këto bashkëpunime të herëpashershme të shqiptarëve me Perandorinë Osmane ishin njëfarë paralajmërimi se mund të ndodhte sundimi i të gjitha trojeve shqiptare nga Perandoria Osmane dhe në të njëjtën kohë këto ishin edhe

**Më 29 maj të vitit 1453 ka ndodhur një nga ngjarjet më të rëndësishme historike të kohës dhe me ndikimin më të madh për të ardhmen e civilizimit islam. Kjo datë shënon fitoren e Sulltan Mehmet Fatihut ndaj bizantit dhe çlirimin e Kostandinopojës.**

fillet e bashkëpunimit shqiptar-osman / turk.

Kthesa e madhe për shqiptarët ndodhi në vitin 1389, kur nisi

sundimi i trojeve shqiptare nga osmanët, pjesë integrale e së cilës u bënë edhe shqiptarët. Kosova, përfundimisht dhe tërësisht ka rënë nën pushtetin osman në vitin 1455, kur u sundua nga Sulltan Mehmet Fatihu.<sup>6</sup>

## Roli i shqiptarëve në çlirimin e Kostandinopojës - Stambollit

Më 29 maj të vitit 1453 ka ndodhur një nga ngjarjet më të rëndësishme historike të kohës dhe me ndikimin më të madh për të ardhmen e civilizimit islam. Kjo datë shënon fitoren e Sulltan Mehmet Fatihut ndaj bizantit dhe çlirimin e Kostandinopojës. Natyrisht shqiptarët kanë qenë pjesë aktive e këtij momenti historik dhe e kanë trajtuar si vlerë të përbashkët çlirimin e Stambollit, në kuadër të milletit osman. Si dëshmi e kësaj historie të përbashkët janë edhe monumentet fetare, kulturore e historike që janë



emërtuar në emër të Sulltan Mehmet Fatihut siç janë, Xhamia Sulltan Mehmet Fatih, e njohur si xhamia e madhe në Prishtinë apo hamami i madh i Prishtinës i emëruar po me këtë emër.

Me të drejtë ish-ministri i jashtëm turk Ahmet Davutoğlu, gjatë vizitës së tij në Prishtinë në vitin 2011, në xhaminë e madhe “Sulltan Mehmet Fatih” pati deklaruar se “shqiptarët kanë merita për çlirimin e Stambollit, sepse, nga këtu, pra nga xhamia “Sulltan Murat”, e ndërtuar në vitin 1393, u nisën ushtarë për ta çliruar Kostandinopojën.”<sup>7</sup>

Në lidhje me këtë, edhe në librat e historisë rrëfëhet tregimi kur gjatë kohës së çlirimit të Kostandinopojës, disa nga komandantët nisën të hezitojnë të vazhdojnë luftën për çlirim derisa filluan të mendojnë për një qetësi të përkohshme. Ndërsa nga ata që reagon ashpër ndaj hezitimit, ishte Zognush Pasha, me origjinë shqiptar, që kishte qenë i krishterë dhe ishte bërë mysliman. Ai e vlerësonte entuziazmin e ushtarëve dhe kthimin mbrapa e konsideronte demoralizim. Ai nuk i konsideronte asgjë forcat e tjera krahas sulltanit. “Kursesit dhe larg asaj, o sulltan, nuk pushojmë as nuk hezitojmë, ne kemi ardhur këtu për të vdekur e jo për t’u kthyer. O udhëheqës i sulltanatit, më pyete për mendimin tim dhe unë po ta shpall me fjalë të qarta: Ne duhet t’i kemi zemrat tona si shkëmbi dhe duhet ta vazhdojmë luftën pa shfaqur asnjëfarë shenjë dobësimi e ligështimi...” Në fytyrën e sulltanit u vu re gëzimi dhe qetësia, pasi e dëgjoi Zognush Pashë shqiptarin. Pas kësaj, sulltani iu drejtuar mësuesit të tij, Ak Shemsedinit, i cili miratoi mendimin e Zognush Pashës.<sup>8</sup> Historia jonë e përbashkët ishte edhe në çlirimin e Stambollit.

Perandoria osmane nuk ishte institucion vetëm i turqve, por i gjithë klasës sunduese të Perandorisë përfshirë edhe shqiptarët.

## Kontributi i shqiptarëve në Perandorinë Osmane

Deri në pavarësimin e Shqipërisë nga Porta e Lartë (1912), në pozitën e kryeministrit të Perandorisë Osmane (sadriazem), që është pozita më e lartë shtetërore osmane, pas pozitës së sulltanit, kanë arritur të ngrihen 44 shqiptarë, në pozitën e shejh-ul-islamit 5 shqiptarë; në pozitën e admiralit të flotës detare osmane (kapudan-i-derya) 25 shqiptarë. Nga populli shqiptar po ashtu dolën rreth 400 poetë e shkrimtarë, shumë myderrizë, myftilerë, kadilerë, vezirë, pashallarë, velilerë, bejlerbej, myteselimë etj..<sup>9</sup> Numri i kryezirëve (kryeministrave) shqiptarë, sipas disa burimeve është 33, ndërsa i ministrave është 101. Por, fundja pa marrë parasysh saktësinë fikse, i pa konstatuar është numri i madh të shqiptarëve në udhëheqjen e Perandorisë Osmane.

Numri i dijetarëve shqiptarë në Perandorinë Osmane ishte shumë i madh. Duke u nisur që nga pozitën e larta “shejhu’lislam”, arkitekt të mëdhenj, rektor si hoxhë Hasan Tahsini, rektori i parë i Universitetit të Stambollit e deri te një numër i madh i dijetarëve shqiptarë që tanimë një pjesë të dhënave i kemi të mblëdhura në literaturën shqipe.<sup>10</sup>

Ferid Pashë Vlorë ishte kryeministri i fundit shqiptar, i cili u emërua në këtë pozitë nga Sulltan Abdul Hamidi, duke e shkarkuar Said Pashën, për shkak të mosmarrëveshjes me të për trajtimin e shqiptarëve.<sup>11</sup>

Madje shumë shqiptarë mbërritën jo vetëm në postet më të larta në perandori, por krijuan edhe shtete më vete dhe i sunduan ato. Mehmet Aliu, i cili e pushtoi Egjiptin, vetëm me një grusht shqiptarë dhe u shpall mbret. Madje i biri i tij ia mësyu dhe sulltanatit.<sup>12</sup> Duke marrë parasysh sistemin osman, në të cilin shqiptarët kishin prani të madhe kudo në viset

arabe prej Irakut deri në Algjeri e prej Sirisë deri në Jemen vinin figura shqiptare si guvenatorë, ushtarakë, kadilerë, nëpunës të lartë e të tjerë që lanë gjurmë në ato vende.<sup>13</sup>

Thjesht lidhshmëria ndërmjet popullit shqiptar dhe popullit turk ishte e brumosur gjatë gjithë këtyre shekujve. Eqrem bej Vlorë, në librin e tij “Kujtimet”, me të drejtë pyet, kur nis shtjellimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet dy popujve, se, “cili ishte, në të vërtetë, thelbi i ngritjes së atyre viteve ndërmjet shqiptarëve dhe turqve, dy popuj që për shekuj të tërë kanë qenë të lidhur dhe kanë bashkëpunuar ngushtë për themelimin dhe ruajtjen e Perandorisë”? Pyetje shumë logjike, por përfundimet e së cilës mund të gjinden te shumë faktorë, por i pandryshueshëm është fakti se shqiptarët në Perandori ishin të mbrojtur, ishin kontribuues aktivë në ruajtjen e saj, si dhe ishte mundësi e artikullimit të identitetit kombëtar në një gjeografi politike ku fqinjët synonin asimilimin tonë dhe gllabërimin e tokave tona.

1. Krasniqi, Milazim “Krimet e vjetra dhe marrëzitë e reja”, Shënja, Shkup, 2018, fq. 43.  
2. Bajrami, Hakif “Kosova, njëzet shekuj të identitetit të saj”, Sh.B. “Era”, Prishtinë, 2001, fq. 30.  
3. Krasniqi, Nehat “Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare” Institutit Albanologjik, Prishtinë, 2017, fq. 46.  
4. Krasniqi, Nehat “Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare” Institutit Albanologjik, Prishtinë, 2017, fq. 46.  
5. Krasniqi, Nehat “Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare” Institutit Albanologjik, Prishtinë, 2017, fq. 47.  
6. Krasniqi, Nehat “Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare” Institutit Albanologjik, Prishtinë, 2017, fq. 50.  
7. Deklarim publik i ish-ministrit të jashtëm turk, gjatë vizitës së tij në Prishtinë, në vitin 2011.  
8. Salabi Ali, Muhammed, “Perandoria Osmane, faktorët e ngritjes dhe rënies së saj” Sh.B. Fjala e Bukur, Prishtinë, 2009, fq. 53.  
9. Krasniqi, Nehat “Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare” Institutit Albanologjik, Prishtinë, 2017, fq. 86.  
10. Rëndësi të jashtëzakonshme në këtë ka botimi i librit “Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane 1880-1912” të botuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, me autorët e nderuar, Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmeti dhe Ramadan Shkodra, viti 2021.  
11. Kirkimiz, Abdulhamid, “Ferid Pashë Vlorë – një jetë shtet”, Logos-A, Shkup, fq. 248.  
12. Sadiku, Xhafer, “Midis perandorive dhe religjioneve” ARS&Academic Publishing, Tiranë, fq. 235.  
13. Vlorë, Eqrem bej, “Kujtimet 1885-1925”, IDK, Edicioni i tretë i botimit, Tiranë, fq. 150.

Prof. ass. dr. Ferid Selimi

# Rrjetet sociale, komunikimi i pambikëqyrur, stereotipat dhe islamofobia

Rrjetet sociale kanë mundësuar komunikimin e lehtë e të shpejtë jo vetëm me familjarët, farefisnin e me miqtë e njohur prej kohësh, por edhe me miqtë, që tani po konsiderohen si miqtë virtual kudo që janë.

Kjo mundësi komunikimi ka bërë që njerëzit kudo që janë anë e mbanë botës të informohen në kohë e me kohë për ngjarjet e ndryshme, qofshin të rëndësishë shoqërore qofshin të rëndësishë personale. Platformat e krijuara, lehtësisht mundësojnë publikimin e informatës, por që, pos të mirave, sikur ka krijuar një hendek a vakum medial, sepse publikohen e lexohen artikuj të ndryshëm pa ndonjë redakturë dhe pa mbikëqyrje editoriale, e që vërtetësia e lajmit jo vetëm që anashkalohet, por as provohet dhe derisa të dalë e vërteta në shesh ajo konsiderohet si e mirëqenë. Në kontekst të kësaj, studiuesja e komunikimit, Laura Berk, në vitin 2010 e ka konsideruar këtë dukuri si thikë me dy tehe, sepse, meqë nuk ka ndonjë redakturë e as mbikëqyrje editoriale, atëherë mund të publikohet gjithçka e që mund të konsiderohet ngacim dhe bullizëm virtual, por që këtë pastaj do të mund ta përcaktojë gjyqësia, nëse do të ketë rast të hapur e të paraqitur në gjyq.

Për çudi, publikimet, sidomos ato sulmuese, shpërndahen në rrjet me shpejtësi të jashtëzakonshme dhe identiteti i publikuesit mund të mbetet anonim. Prandaj, rrjetet sociale që lehtësisht mund të konsiderohen edhe media, sepse

**Në Britani të Madhe, nga 548 rastet e urrejtjes ndaj myslimanëve, 402 ishin pjesë e rrjeteve sociale (73%). Për rrjedhojë, në këto platforma, arabët shfaqen si terroristë, radikalistë dhe injorantë, duke shkaktuar frikë dhe urrejtje te lexuesit e postimeve.**

kanë disa karakteristika të mediave, shpesh, pa fajin e tyre, bëhen kanale të shpërndarjes së gjuhës së urrejtjes dhe të racizmit. Fillet e të menduarit se si konceptohet racizmi në mendjet e njerëzve, i shpjegon mirë, studiuesi Munoz, e që fillon me paragjykim dhe vazhdon me diskriminimin e një grupi shoqëror, për të asgjësuar elementet multi-kulturor dhe heterogjenë të kulturës dhe etnisë së atij vendi. Në të vërtetë individë të ndryshëm duke shfrytëzuar rrjetet sociale në internet manipulojnë opinionin pa u mbështetur në fakte. Kleland dhe Putri, dy studiues në hulumtimet e tyre të veçanta, gjuhë të urrejtjes konsiderojnë çdo lloj komunikimi që fyen, nënçmon dhe poshtëron një individ, apo grup njerëzish. Ndërkohë që F. Ortiz, kishte paralajmëruar se kjo dukuri si proces kulturor shfaqet më së miri në shtetet e pazhvilluara nga qytetërimi





me pushtet në kohët moderne. Për më tepër, këto fenomene vërehen vazhdimisht në ato rrjete sociale, të cilat ndërtojnë imazhin e “tjetrit”, duke mbuluar vetëm raste a çaste jetësore.

Kështu, duke publikuar “raste” e “çaste” të veçanta e të izoluar, sipas autorit të njohur Daroqui, duan që të ngjallin idenë, se myslimanët janë kërcënim i brendshëm në shumicën e vendeve perëndimore, duke harruar dhe bërë të padukshëm faktin, se në vendet islame ku terrorizmi luftohet, myslimanët janë vetë viktimë. Nëse u referohemi dokumenteve të ndryshme ligjore si dhe konventave e raporteve të ndryshme, mund të thuhet që gjithçka është paraparë dhe është bërë përpjekje që të inkriminohen në ligj. Bazuar në këto dokumente, liria e mendimit, e shprehjes së lirë dhe e fesë është e garantuar për secilin individ. Organizata për raportimin e islamofobisë në Britani të Madhe, “Tell MAMA”, ka raportuar që nga 548 rastet e urrejtjes ndaj myslimanëve, 402 ishin pjesë e rrjeteve sociale (73%). Për rrjedhojë, në këto platforma, arabët shfaqen si terroristë, radikalistë dhe injorantë, duke shkaktuar frikë dhe urrejtje të lexuesit e postimeve. Prandaj, do të mund të thuhet që interneti ka mundësuar që individëve të papërgjegjshëm e të

## Publikimet e ndryshme nëpër rrjetet sociale, qofshin me fjalë a me fotografi natyrisht që ndikojnë në “ndryshim opinionit” dhe në perceptimin e tjetrit për tjetrin, e sidomos kur ato shfaqen si sensacione.

pandërgjegjshëm t’u bëjë strehë për të paragjykuar grupe apo komunitete të ndryshme. Kjo, ishte njëra nga arsyet që prokurori i përgjithshëm i Mbretërisë së Bashkuar të kërkonte largimin dhe fshirjen e të gjitha mesazheve të urrejtjes në Twitter dhe Facebook, në mënyrë që të ketë mbarëvajtje normale të shoqërisë.

Publikimet e ndryshme nëpër rrjetet sociale, qofshin me fjalë a me fotografi natyrisht që ndikojnë në “ndryshim opinionit” dhe në perceptimin e tjetrit për tjetrin, e sidomos kur ato shfaqen si sensacione,

e që, asnjëherë nuk arrijnë të shfaqin faktet apo të argumentojnë rastet e tilla. Mediat në përgjithësi merren me një nga obligimet fetare, sidomos me veshjen e femrës islame e që ka të bëjë me bartjen e shamisë. Ky fenomen ka ekzistuar me decenie e decenie në Kosovë dhe në rajonet ku jetojnë shqiptarët me përkatësi fetare islame, por që është shpeshuar edhe më shumë, sidomos pas 11 shtatorit të vitit 2001, sepse pesha e këtyre historive, faktikisht edhe nëse do të ishin të sakta, nxjerrin në pah anët negative të stereotipave myslimane.

Për shembull, studimi i bërë nga Akademia e Universitetit Cardiff, ka rezultuar që shumica e lajmeve për 11 shtatorin e vitit 2001 ishin negative për myslimanët. Hulumtimi i tyre rreth mbulimit mediatik për myslimanët në Britani, gjeti se të paktën dy e treta e artikujve ishin fokusuar rreth historive mbi terrorizmin. Sot, sipas Edwards, dhe Shaeen, ky fenomen është bërë trend në rrjetet sociale, por edhe në mediat sociale anembanë botës, pasi për të përshkruar një mysliman në mënyrë negative, shpesh përdoren fjalët si: “militantizëm” dhe “radikalizëm”, që janë produkt i një paragjykimi të gjerë anti-mysliman. Ka edhe epitete të tjera denigruese që u japin myslimanëve, siç janë “radikal”, “fanatik” dhe “funda-mentalist”. Këto



dukuri konsiderohen si kërcënim për sigurinë, e përveç kësaj, edhe reagim i qartë dhe i ashpër kundër myslimanëve, sepse publikohen komente të pakontrolluara kërcënuese që nxisin islamofobinë.

## Roli i rrjeteve sociale në krijimin e stereotipave

Roli i medias në krijimin e imazhit të tjetrit është i rëndësishëm, e kur bëhet fjalë për islamofobinë, atëherë vërtet do të duhej pasur e shtuar më shumë kujdes. Fillimisht do të duhej të vërehej ndikimi i tyre në përfaqësimin e të tjerëve që konsiderohen minoritarë për nga etniciteti. Sipas Gandit, koncepti i etnicitetit u propozua nga ekspertë të shkencave shoqërore, si një mënyrë për ta tjetërsuar idenë e racës nga një koncept biologjik apo kulturor. Në këtë formë, grupet etnike paraqesin një vazhdimësi të kulturës, gjuhës dhe zakoneve të përditshme të përbashkëta. Në anën tjetër, thotë Gandi, raca është një term i ndërtuar me aspektin biologjik dhe fiziologjik të një personi dhe nuk lidhet drejtpërdrejtë me kulturën e tij. Për më tepër, sipas Saalem, roli i medias në përfaqësimin pozitiv të pakicave, ndikon në përmirësimin e raporteve të tyre me shumicën. Ndërsa Xhojs, prezantimin e pakicës e sheh nga një pikëpamje pozitive që ngjall ndjenja pozitive ndërgrupore dhe ndikon që shumica ta pranojë pakicën si pjesë të shoqërisë. E gjithë kjo, thotë Brown, ndikon në krijimin e një rrethi vicioz ku, për shkak të mospranimit dhe diskriminimit nga shumica, pakicat refuzojnë integrimin në shoqëri. Në një studim të udhëhequr nga Hartmann dhe Husband, i bërë në vitin 1974, mund të vërehet efekti i medias në keq përfaqësimin e minoriteteve etnike. Sipas tyre, “njerëzit me ngjyrë” shihen si problem, të çuditshëm dhe jo të civilizuar.

## Islamofobia në Facebook

Facebook-u është bërë një platformë ku përdoruesit ndajnë mendime, rrinë në kontakt me familjen dhe miqtë dhe në të përcjellin lajme. Në të njëjtën kohë, ky rrjet social është një platformë, ku grupe të caktuara kanë gjetur strehim dhe vazhdojnë të sulmojnë të tjerët në bazë të racës, gjinisë dhe besimit. Kur në vitin 2013, u bë një studim nga qendra për urrejtje online, të titulluar “Islamofobia në internet” nga 50 faqe të të analizuarat të Facebook-ut, ishin gjetur mbi 349 raste të gjuhës së urrejtjes. Ky studim nxori në pah gjetjet e që kishin të bënin me kërcënimin e sigurisë, kërcënimin kulturor, kërcënimin ekonomik, demonizimin e myslimanëve, kërcënime për dhunë dhe gjenocid ndaj myslimanëve, urrejtje ndaj refugjatëve dhe azil-kërkuesve, si dhe forma tjera të urrejtjes. Ndërkohë që, në një studim tjetër nga një organizatë tjetër jofitimprurëse, “Faith Matters” ishin

**Nga analiza kuptohet që në ato faqe interneti ishte gjetur që myslimanët konsiderohen terroristë, përdhunues, gratë myslimane si kërcënuese të sigurisë dhe ata, pra myslimanët do të duhej të dëboheshin nga vendet evropiane.**

analizuar postime të ndryshme të përdoruesve dhe si gjetje ishte, se fjalët më të zakonshme që ishin përdorur ishin: aziatikë (97), dëbim (48), paki (58) – pakistanez, banda (27), pederast (25). Dhe një studim të tretë, i bërë nga Imran Awanit në vitin 2016, që ishte paksa më i thukët i titulluar “Islamofobia në rrjetet sociale: Një analizë kualitative e mureve të urrejtjes së Facebook-ut”, ishin trajtuar 100 faqe, komente dhe postime të Facebook-ut, nga ku ishte konstatuar që ekziston gjuha e urrejtjes kundrejt myslimanëve. Nga analiza kuptohet që në ato faqe interneti ishte gjetur që myslimanët konsiderohen terroristë, përdhunues, gratë myslimane si kërcënuese të sigurisë dhe ata, pra myslimanët do të duhej të dëboheshin nga vendet evropiane. Bile, shkohet aq larg sa që mendohet që nuk ka ndonjë dallim ndërmjet myslimanëve dhe terroristëve.

## Islamofobia në Instagram

Duke pasur për bazë të dhënat që jep Statista e vitit 2020, Instagrami është rrjeti social me rritjen më të lartë të përdoruesve, sidomos gjatë kohës sa ishte aktive karantina nga covid-19. Kjo e bën shumë të rëndësishme si media, sepse, Instagrami luan rol të rëndësishëm për komunikimin e përdoruesve anembanë botës. Gjithmonë duke pasur parasysh që edhe në këtë rrjet ka postime të ndryshme e më tepër fotografi me pak fjalë, ashtu si edhe Facebooku, edhe këtu vërehet gjuha e urrejtjes si dhe diskriminimi mbi baza etnike e racore. Bazuar në studimin e bërë në vitin 2020 nga Civila me bashëpunëtorë e ku ishin analizuar 474 postime me thurjen (hashtagun) #Stopislam të publikuara nga 1 janari deri më 31 korrik të 2020, terminologjia që haset është kjo: Lufta ndërmjet myslimanëve, myslimanët janë terroristë, gratë myslimane janë kërcënim për



sigurinë e vendit, myslimanët duhet të dëbohen, myslimanët janë përdhunues, etj. Në atë studim shihen edhe tabela e figura sipas përqindjes mujore që në këtë artikull nuk do të bashkëngjiten, sepse natyra e këtij artikulli është ionformativ dhe analitik. Por ajo që është e rëndësishme për t'u theksuar është që, në ato postime myslimanët paraqiten si arsyeja kryesore se pse Suedia ka më shumë bombardime dhe përdhunime krahasuar me Hungarinë dhe Poloninë. Apo edhe rasti tjetër, në të cilin thuhet se: "Personat që ushqehen me proshutë të dërrit, kanë më pak gjasë të bombardojnë veten".

## Islamofobia në Twitter

Twitter është një tjetër platformë e shprehjes dhe e publikimit të mendimit, ku përdoruesit ndajnë opinionet e tyre. Pasi që, edhe Twitteri nuk i vërteton lajmet e shpërndara, në këtë platformë shpesh ndërtohen rrugë të keqinformimit. Në një studim të kryer në vitin 2014, studiuesi Awan, analizoi 500 cicërima (tweet) nga 100 përdorues të ndryshëm. Kjo analizë u bë nga janari i vitit 2013 deri në gusht të 2014. Këto data përkujnë me vrasjen

e ushtarit britanik Lee Rigby nga Michael Adebolajo dhe Michael Adebolajo, e cila ndodhi në maj të vitit 2013. Ky sulm u arsyetua nga dy terroristët si hakmarrje ndaj dhunës së ushtruar kundrejt myslimanëve në Lindje. Si rezultat, dhjetëra raste dhune ndaj myslimanëve u denoncuan në polici, në javët vijuese nga ku edhe ky punim u inspirua. Për më tepër, gjetjet e kësaj analize nuk dallojnë nga ato që u përmendën më lart, sepse edhe këtu shprehjet dhe fjalët që ishin përdorur më shpesh ishin: "digjini xhamitë", "terrorist", "derr", "ninxha", etj.

Rrjetet sociale, strehë e të papërgjegjshmëve dhe të pandërgjeshmëve Nga kjo analizë e postimeve nëpër rrjetet sociale mund të konkludohet që këto rrjete sociale që mund të konsiderohen edhe media, mundësojnë komunikimin e lehtë e të shpejtë jo vetëm me familjarët, farefisin e me miqtë e njohur prej kohësh, por edhe me miq, që, tani po konsiderohen si miqtë virtual kudo që janë. Meqë nuk ka ndonjë mbikëqyrje editoriale, publikohen edhe postime që mund të konsiderohen si ngacmime e bullizma virtuale. Kosova si një nga vendet e pazhvilluara nuk mund si t'i ikë një komunikimi të tillë, sepse siç shprehen edhe autorë të ndryshëm, ky

proces kulturor shfaqet më së miri në shtetet e pazhvilluara nga qytetërimi me pushtet në kohët moderne. Pavarësisht, që dokumentet ligjore dhe konventat ndërkombëtare si dhe raportet e ndryshme kanë bërë përpjekje që veprat e tilla që kanë të bëjnë me abuzim e diskriminim mbi baza etnike, racore e fetare të inkriminohen në ligj, megjithatë, edhe pse këto dukuri konsiderohen si kërcënim për sigurinë dhe që nxisin islamofobinë, interneti u ka mundësuar individëve të papërgjegjshëm të shprehen lirshëm, pavarësisht fakteve që e tregojnë të kundërtën apo pavarësisht mos argumentimit të postimeve të tilla.

Roli dhe ndikimi i rrjeteve sociale konsiderohet ndër më të rëndësishmit, sepse përhapet shpejt dhe lehtë dhe mund të ndikojnë në krijimin e stereotipave të ndryshme etnike, kulturore, racore e fetare. Kështu, si Facebooku ashtu edhe Instagrami e Twitteri, janë bërë platforma ku përdoruesit, pos që ndajnë mendime, rrinë në kontakt me familjen dhe miqtë dhe të përcjellin lajme, sulmojnë të tjerët në bazë të racës, gjinisë dhe besimit.

Ndali o Zot!

*(Autori është dekan në Fakultetin Media dhe Komunikim në UBT në Prishtinë)*

Msc. Njomza Sadriu

## Kurani fisnik – mrekullitë shkencore

Kurani diskuton rreth elementeve të ndryshme kimike. Është interesante se Allahu ka përmendur vetëm disa elemente me emër. Rëndësia e tyre në të ushqyerit është e mahnitshme.

Elementet kimike, komponimet dhe përzierjet që përmenden në të

**K**imia është shkencë natyrore, e cila studion ndërtimin e natyrës dhe të përbërësve të saj. Ajo hulumton ndryshimet që ndodhin në materie. Kimia bënë analizën e përbërjes së lëndëve të ndryshme që gjenden në natyrë. Ajo njëkohësisht merret me studimin e metodave të përfitimit të metaleve nga mineralet e ndryshme, të përpunimit të tyre, të përfitimit të materialeve ndërtimore dhe të shumë

artikujve, të cilët shfrytëzohen në jetën e përditshme.

Kimia jep shumë informacione për pasuri të ndryshme, shumica prej të cilave shërbejnë si lëndë të para për zhvillimin e industrisë kimike, metalurgjisë, të ndërtimitarisë etj., si degë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit. Tash kimia është e kudondodhur dhe jeta pa të do të ishte shumë e varfër. Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik i një vendi përcaktohet nga zhvillimi i kimsisë.

Në këtë shkrim do të diskutojmë rreth ajeteve të Kuranit që lidhen dhe shpjegojnë elementet kimike, komponimet si dhe përzierjet. Kurani iu shpall profetit Muhamed a.s. mbi 1400 vjet më parë.

Kurani diskuton rreth atomit

Surja Junus, ajeti 61: “Ti nuk angazhohesh me asnjë çështje, nuk lexon nga ai pjesë nga Kurani dhe nuk bëni ndonjë vepër, vetëm se ne jemi dëshmitarët tuaj, kur ju ndërmerrni atë. Zotit tënd nuk mund t’i fshihet as në Tokë e as në qiell as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe, por vetëm se është evidentuar në Librin e Sigurt.”

Surja En-Nisa, ajeti 40: “S’ka dyshim se Allahu nuk bën padrejtë as sa grimca, e nëse ajo vepër është e mirë, Ai e shumëfishon atë dhe Vetë Ai i jep shpërblim të madh.”



Surja El-Zelzeleh, ajeti 7: “E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.”

Surja El-Zelzeleh, ajeti 8: “E kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.”

Surja Sebe’ë, ajeti 22: “Thuaj: “Thirrni ata, të cilët i menduat për zota pos Allahut!” Ata nuk posedojnë sa një grimcë as në qiell e as në Tokë dhe as që kanë në to ndonjë pjesë, dhe Ai nuk ka prej tyre ndonjë përkrahje.”

Në Kuran, atomi i njohur si “dherah”, është si gjëja më e vogël dhe asgjë nuk është më e vogël se ai. John Dalton ka një teori që ne e njohim si “teoria e atomit të Daltonit” e cila thotë se pjesa më e vogël e grimcave është atomi. Atomi nuk mund të ndahet më në pjesë më të vogla. Edhe një herë na shfaqet mrekullia e Kuranit fisnik.

Kurani diskuton rreth elementeve të ndryshme kimike.

Është interesante se Allahu ka përmendur vetëm disa elemente me emër. Rëndësia e tyre në të ushqyerit është e mahnitshme.

Këto elemente specifike Allahu i ka përmendur në Kuran:

- Hekuri,
- Bakri,
- Argjendi,
- Ari.

Hekuri (Fe)

Surja El-Hadid, ajeti 25: “Ne i dërguam të dërguarit tanë me dokumente të qarta dhe Ne zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t’i përmbahen njerëzit të së drejtës. Ne e kemi zbritur edhe hekurin që në të ka forcë të fortë dhe dobi për njerëz, e edhe për t’u ditur tek Allahu se kush ndihmon Atë (rrugën e Tij) dhe të dërguarit e Tij duke i besuar të fshehtës. S’ka dyshim se Allahu është i Fuqishëm, Mbizotërues.”

Hekuri është një nga elementet e theksuara në Kuran.

Në kimi ne e njohim “Fe” si hekur, por në Kuran hekuri përmendet si El-Hadid.

## **Kur marrim parasysh kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës “anzalna”, që është, “zbritje fizike nga qielli”, si në rastin e shiut apo rrezeve të Diellit, ne kuptojmë se ky ajet përfshin një mrekulli shkencore shumë të rëndësishme.**

Surja “Hadid” është e 57-ta në Kuran. Vlera numerike e fjalës “El-Hadid” në arabisht është 57. Vlera numerike e vetëm fjalës “hadid” është 26. Siç dihet, nga tabela e sistemit periodik të elementeve kimie, numri i atomit të hekurit është 26. Me ajetin e shpallur në suren Hadid, Allahu i Plotfuqishëm tregon se si është formuar hekuri, dhe me kodin matematikor që përmban ajeti, Ai na zbulon një mrekulli shkencore.

Fjala “anzalna”, e përkthyer si “zbritur” dhe e përdorur në ajet për hekurin, mund të mendohet se ka

një kuptim metaforik për të shpjeguar se hekuri është dhënë që njerëzimi të përfitojë. Por, kur marrim parasysh kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës, që është, “zbritje fizike nga qielli”, si në rastin e shiut apo rrezeve të Diellit, ne kuptojmë se ky ajet përfshin një mrekulli shkencore shumë të rëndësishme. Kjo, sepse gjetjet moderne astronomike kanë zbuluar se hekuri që gjendet në botën tonë ka ardhur nga yjet gjigante në hapësirën kozmike. Jo vetëm hekuri në tokë, por edhe hekuri në të gjithë sistemin diellor vjen nga hapësira e jashtme, pasi që temperatura në Diell është e papërshtatshme për formimin e hekurit. Dielli ka temperaturën e sipërfaqes prej 6,000 gradë celsius, dhe temperaturën e bërthamës prej rreth 20 milion gradë celsius. Hekuri mund të prodhohet vetëm në yje shumë më të mëdha se Dielli, ku temperatura arrin në disa qindra milion gradë celsius. Kur sasia e hekurit tejkalon një nivel të caktuar në një yll, ylli nuk mund ta mban më tej, dhe përfundimisht shpërthen në atë që quhet “nova” ose “supernova”. Këto shpërthime i mundësojnë hekurit të hidhet në hapësirë.

E gjithë kjo tregon se hekuri nuk është formuar në Tokë, por është bartur nga supernovat, dhe është “zbritur”, siç shpallet në ajet. Është e qartë se ky fakt nuk mund të ketë qenë i njohur në shekullin VII, kur u



shpall Kurani. Megjithatë, ky fakt është i rrëfyer në Kuran, fjala e Allahut, i Cili përfshinë çdo send në dijen e Tij të pafund.

Astronomia ka zbuluar gjithashtu se edhe elemente të tjera janë formuar jashtë Tokës. Në shprehjen “Ne e kemi zbritur edhe hekurin” në ajet, fjala “edhe” mund të jetë duke iu referuar atij nocioni. Megjithatë, fakti që ajeti përmend në mënyrë specifike hekurin është mjaft befasisues, duke marrë parasysh se këto zbulime janë bërë tek në fund të shekullit XX. Në librin e tij, “Nature’s Destiny” (Fati i natyrës), mikrobiologjisti i njohur, Michael Denton, thekson rëndësinë e hekurit.

Pa atomin e hekurit, në kozmos nuk do të kishte jetë të bazuar në karbon; pa supernova, pa ngrohje të tokës primitive, pa atmosferë ose hidrosferë. Nuk do të kishte fushë magnetike mbrojtëse, as zona rrezatimi Van Allen, as shtresë ozoni, as metal që do formonte hemoglobinën (në gjakun e njeriut), as metal për të zbutur reaktivitetin e oksigjenit dhe as metabolizëm oksidues. Marrëdhënia e ngushtë dhe intriguese ndërmjet jetës dhe hekurit, ndërmjet ngjyrës së kuqe të gjakut dhe vdekjes së ndonjë ylli të largët, jo vetëm që tregon rëndësinë e metaleve për biologjinë, por gjithashtu edhe biocentrikën e gjithësisë.

Roli i hekurit në trup është të ndihmojë qelizat e kuqe të gjakut të transportojnë oksigjen në pjesë të tjera të trupit. Brenda qelizës, hekuri luan një rol të rëndësishëm në procesin që prodhon energji për trupin. Kur ka mungesë hekuri, një nga simptomat e para është lodhja shumë e madhe që ndiejmë. Hekuri ruhet në mëlçi, por varfërohet nëse nuk marrim mjaftueshëm, por çfarë mjafton? Disa burime thonë 10-20 mg., ndërsa të tjera thonë 50 mg Fe.

Për më tepër, grimcat e oksidit të hekurit janë përdorur në një trajtim të kancerit në muajt e fundit dhe janë vënë re zhvillime pozitive. Një ekip i udhëhequr nga dr. Andreas Jordan, në spitalin me famë botërore Charité



Hospital në Gjermani, pati sukses në shkatërrimin e qelizave kanceroze me këtë teknikë të re të zhvilluar për trajtimin e kancerit – lëngu magnetik hipotermia (lëng magnetik me temperaturë të lartë). Si rezultat i kësaj teknike, e përdorur së pari herë në 26 vjeçin, Nikolaus H., nuk janë vërejtur qeliza të kancerit te pacienti në tre muajt vijues.

Kjo metodë e mjekimit mund të përmbledhet si më poshtë:

1. Një lëng që përmban grimca oksidi të hekurit injektohet në tumor me anë të një shiringe të posaçme. Këto grimca përhapen në tërë qelizat e tumorit. Ky lëng përbëhet nga mijëra miliona grimca, 1.000 herë më të vogla se grimcat e kuqe të gjakut, të oksidit të hekurit në 1 cm<sup>3</sup> që mund të rrjedh lehtësisht nëpër të gjitha enët e gjakut.(5)

2. Pacienti më pastaj vendoset në një makinë me një fushë të fuqishme magnetike.

3. Kjo fushë magnetike, e aplikuar jashtë, fillon të vë në lëvizje grimcat e hekurit në tumor. Gjatë kësaj kohe temperatura në tumorin që përmban grimcat e oksidit të hekurit ngritët deri në 45 gradë celsius. Në pak minuta, qelizat e kancerit, të paaftha për të mbrojtur veten nga nxehtësia, janë dobësuar ose shkatërruar. Tumori pastaj mund të çrrënjohet tërësisht me kimioterapi pasuese.

Në këtë mjekim janë vetëm qelizat kanceroze që ndikohen nga fusha magnetike, sepse vetëm ato përmbajnë grimcat e oksidit të hekurit. Përhapja e kësaj teknike është një zhvillim i madh në trajtimin e kësaj sëmundjeje potencialisht vdekjeprurëse. Në trajtimin e një sëmundje aq të përhapur sikurse kanceri, përdorimi i shprehjes “hekurin që në të ka forcë të fortë dhe dobi për njerëz” (Kurani, 57:25) në Kuran është veçanërisht i rëndësishëm. Vërtet, në këtë ajet, Kurani ndodh të jetë duke treguar përfitimet e hekurit për shën-

## ADN-ja përbëhet nga elemente dhe komponime të ndryshme, të endura dhe të llogaritura në mënyrë të ndërlkuar nga Krijuesi.

detin e njeriut (Allahu e di më së miri!).

Bakri (Cu)

Allahu xh.sh. përmend bakrin në Kuran, por ai mund të përkthehet edhe si bronz ose vaj i përmendur në suren El-Kehf, kapitulli 18 i shpellës, të cilin do të bënim mirë ta lexonim çdo të premte.

Bakri është një element metalik i lidhur me profetët e Testamentit të Vjetër / Tevratit, profetët Jahja a.s. dhe Zekeria a.s..

Zekeria ishte babai i profetit Jahja (alejhîs salam).

Surja El-Kehf, ajeti 96: “Më sillni copa të hekurit! E kur e niveloi ai me dy anët e kodrave, tha: “Ndizni!”, e kur e bëri atë (hekurin) zjarr (si zjarr nga të ndezurit) tha: “Më sillni bakër të shkriër t’ia hedhë atij!”

Surja El-Kehf, ajeti 29: “E ti thuaj: “E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë. Ne kemi përgatitur për jobesimtarët zjarr që muret e tij (të flakës) i rrethojnë ata, e nëse kërkojnë shpëtim, ndihmohen me një ujë si katran që fërgon fytyrat. E shëmtuar është ajo pije, e vend i keq është ai.”

Bakri punon në partneritet me hekurin për të formuar qelizat e kuqe të gjakut që bartin oksigjen. Bakri gjithashtu ndihmon në ruajtjen e enëve të gjakut të shëndetshme, kockave dhe nervave të forta. Ndih-

mon në mbështetjen e sistemit imunitar dhe përthithjen e hekurit. Ai gjithashtu ndihmon në shëndetin e zembrës. Është jetike në prodhimin e kolagenit dhe elastinës që siç e dini është jetike për lëkurën.

Ari (Au)

Surja Fatir, ajeti 33: “Xhenetet e Adnit janë që do të hyjnë në to, aty do të stolisen me rrethorëza nga ari e margaritari, e petkat e tyre janë të mëndafshta.”

## Kurani diskuton rreth komponimeve kimike

Kur Allahu xh.sh. flet për mënyrën se si është krijuar njeriu, Ai përmend tre përbërës, ujin, tokën dhe ajrin.

Uji (H<sub>2</sub>O)

Surja El-Furkan, ajeti 54: “Dhe Ai nga uji (fara) krijoi njeriun, dhe e bëri atë të ketë fis dhe të ketë miqësi. Zoti yt është i Plotfuqishëm për çdo send.”

Surja En-Neml, ajeti 60: “A (mos janë më të mirë ata që i adhuron) apo Ai që krijoi qiejt e tokën, që për ju lëshoi shi nga qielli, e Ne me të bëmë të lulëzojë kopshte të bukura, që për ju ka qenë e pamundshme t’i bëni të mbijnë bimët në to? A mos ka ndonjë të adhuruar me meritë pos Allahut? Jo, por ata janë popull që shtrembërojnë (të vërtetën).”

Ajri

Surja Sad, ajeti 72: “Dhe kur ta kem përsosur atë dhe t’i kem dhënë nga ana Ime shpirt, ju menjëherë përlunoni atij (në sexhde).”

Toka

Surja El-Mu’minun, ajeti 12: “Vërtet, Ne e krijuam njeriun prej një ajke (lëngu), e një balte.”

ADN-ja

Vetë ADN-ja përbëhet nga elemente dhe komponime të ndryshme, të endura dhe të llogaritura në mënyrë të ndërlkuar nga Krijuesi,

Allahu xh.sh.. Çdo qelizë njerëzore përmban ADN, por trupi i njeriut është më shumë se ADN. Trupi i njeriut përbëhet nga variacione të këtyre elementeve të njohur si hekuri, kalciumi, oksigjeni, natriumi, kaliumi, magnezi, hidrogjeni, klori, jodi, mangani, plumbi, karboni, zinku, squfuri dhe azoti. Rregullimi delikat i këtyre elementeve nuk mund të ishte shkaktuar nga një Big Bang i rastësishëm. Allahu xh.sh. ka llogaritur se si elementët e ndryshëm shpërndahen në mënyrë proporcionale në të gjithë trupin.

Trupi i njeriut përbëhet nga afërsisht 2 kg kalcium. Mungesa e kalciumit mund të shkaktojë thyerjen e dhëmbëve tanë. Trupi ynë ka nevojë për 120 gr. kalium. Mungesa e kaliumit mund të shkaktojë lodhje, probleme me tretjen, ngërçe të muskujve dhe rrahje të zembrës. Vetëm 2 deri në 3 gr. zink janë thelbësor për trupin.

Më pak se 2 gr. zink mund të shkaktojë probleme me aktivitetin e trurit; shkaktojnë humbje të kujtesës, ndikojnë në lëvizshmëri dhe dobësojnë shqisat e nuhatjes dhe shijes dhe madje shkaktojnë impotencë.

## Kurani diskuton rreth përzierjes

Përzierja e ujit dhe qumështit

Surja El-Muminun, ajeti 21: “Ju edhe nga kafshët keni një mësim, ngase ju freskojmë me lëng prej barqeve të tyre dhe keni shumë dobi prej tyre, e edhe prej tyre ushqeheni.”

Përzierja e tokës dhe ujit

Surja El-Kehf, ajeti 41: “Ose të bëhet uji i saj i shterur, e ti kurrsesi nuk mund ta kërkosh atë!”

Surja Kaf, ajeti 11: “Ushqim për njerëz, dhe me të, Ne e ngjallëm tokën e vdekur, e kështu do të jetë edhe ringjallja.”

Këto janë disa ajete të Kuranit që shpjegojnë shkencën e kimisë. Shpresoj se do ta studiojmë dhe ta duam Kuranin gjithnjë e më shumë.

Mirsad Aslani

# Edukimi i shpirtit, zembrës dhe mendjes

**B**esimtari beson se lumturia e tij në jetë, si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër, varet nga ajo se sa dhe si e ka edukuar dhe pastruar shpirtin dhe zemrën e tij, aq sa është i pastër në shpirt dhe në zemër aq do të jetë edhe i lumtur në këtë botë. Ashtu po na mëson vetë Kurani fisnik: “Më të vërtetë, ai që e pastron atë (shpirtin), do të jetë i lumtur, e, me të vërtetë do të humb ai që e devijon atë (shpirtin)!” (Esh-Shems, 9-10.)

Pedagogjia islame na mëson se shpirti dhe zemra edukohen me anë të madhërimit, devotshmërisë dhe ibadetit ndaj Zotit. Ndërsa, ato gjëra që e forcojnë shpirtin dhe zemrën e njeriut janë vepra të mira, pendimi dhe kontrollimi të egos. Ngase, veprat që i bënë janë shkaku i mbulimit të shpirtit dhe zembrës së tij, nëse gabon pendohet, gabimin e bërë e edukon me mirësi, duke bërë një vepër të mirë, ashtu që mirësia të mbizotëroj gabimin. Në këtë mënyrë po na mëson fjala e Zotit Mëshirëplotë: “Me të vërtetë, veprat e mira i shlyejnë veprat e keqja. Kjo këshillë vlen për ata që i pranojnë këshillat.” (Hud, 114.) Në këtë mënyrë na edukon edhe Pejgamberi i Zotit a.s. i cili thoshte: “Ke frikë Allahun kudo që të jesh! Nëse gabon, mbuloje me vepër të mirë, vepra e mirë do ta mbulojë të keqën (gabimin), dhe sillu mirë ndaj njerëzve!” (Ahmedi)

**Energjia shpirtërore që njeriu e ndjen në qenien e tij, është si një llambë që ndriçon rrugën e tij, e drejton drejt përbushjes së detyrimeve të tij, është fuqia që e udhëzon kah e mira dhe e ndalon nga e keqja.**



Në këtë mënyrë, duke vepruar në kontinuitet, njeriu e pastron dhe edukon shpirtin dhe zemrën e tij. Ndërsa benefitet e pastrimit të shpirtit dhe zembrës janë lumturi në këtë botë, ndërsa shpëtim në botën tjetër. Allahu Mëshirëplotë ka thënë: “... në Ditën kur nuk do të bëjë dobi as pasuria as djemtë, por do të bëjë (kenë) dobi (vetëm) ai që vjen me zemër të pastër te Perëndia, dhe të devotshmëve do t’u afrohet Xheneti.” (Esh-Shuara, 88-90.)

Në thellësi të shpirtit të njeriut ekziston një fuqi që syri nuk mund ta shoh, mikroskopi nuk mund ta vërejë dhe është e panjohur për anatominë njerëzore. Është energjia shpirtërore që njeriu e ndjen në qenien e tij. Ajo është si një llambë që ndriçon rrugën e tij, e drejton drejt përbushjes së detyrimeve të tij, është fuqia që e udhëzon kah e mira dhe e ndalon nga e keqja. Një forcë që e inkurajon dhe na paralajmëron. Është një aftësi që gjykon dhe ekzekuton. Këtë lloj energjie moralistët e quajnë ndërgjegje, disa e quajnë nëndërgjegje, disa e quajnë intuitë, aftësi shpirtërore ose njohje, ndërsa Islami këtë lloj potenciali e quan thjesht zemër.

Pejgamberi i fundit, Muhamedi a.s., na mëson në këshillat e tij edukuese që shpirti dhe zemra e njeriut janë motori menaxhues i trupit, aq sa është e shëndoshë zemra e njeriut aq është i shëndoshë dhe



**Krahas shpirtit dhe zemrës, Zoti Mëshirëplotë njeriun e dalloi me mendjen (racion) e tij dhe pikërishtë me këtë e bëri si krijesë më të përsosur në këtë ekzistencë duke e mbivlerësuar dhe ngritur vlerën e tij ndaj çdo krijesë tjetër.**



trupit i tij: “Nëse një pjesë e trupit është e shëndoshë i tërë trupi është i shëndoshë, e nëse ajo pjesë e trupit është e sëmurë i tërë trupi është i sëmurë, e ajo pjesë është zemra.” (Buhariu dhe Muslimi)

Andaj, njeriu duhet të përkushtohet për shumë kohë dhe duhet t'i kushtojë vëmendje që në mënyrë sa më të bukur të edukojë shpirtin dhe zemrën e tij, ngase edhe destinacioni në të cilën shikon Zoti Mëshirëplotë është pikërishtë ky potencial i njeriut e që është shpirti dhe zemra e tij: “Vërtet Allahu nuk shikon në trupat tuaj as në fizionomitë tuaja, por shikon në zemrat tuaja.” (Muslimi)

Krahas shpirtit dhe zemrës, Zoti Mëshirëplotë njeriun e dalloi me mendjen (racion) e tij dhe pikërishtë me këtë e bëri si krijesë më të përsosur në këtë ekzistencë duke e mbivlerësuar dhe ngritur vlerën e tij ndaj çdo krijesë tjetër. Zoti Mëshirëplotë, nga njeriu insiston që të edukon dhe zhvillon të menduarit e tij, të mendoj thellë dhe të përdorë logjikën. Këtë insistim dhe imperativ Zoti Mëshirëplotë e përsëritë në mbi

njëqind e pesëdhjetë vende kuranore. Por e gjithë kjo është që njeriu të fitojë dhe kultivojë sa më shumë urtësi dhe mësim nga Zoti Mëshirëplotë: “Me të vërtetë, në këtë – ka këshillë për ata që janë largpamës.” (Kurani, 24:44.) Pra, njeriu vlerësohet dhe përfiton nga Zoti aq sa është duke e përdorur pasurinë e tij më të madhe, e që është mendja dhe logjika e tij, e për të qenë largpamës, njeriu duhet në mënyrë konstante të edukojë dhe zhvillojë mendjen e tij, duke e zhvilluar atë, zhvillon edhe konceptin e jetës dhe e bënë jetën më kuptimplotë. Përveç të menduarit dhe të përdorurit të mendjes, në Kuranin famëlartë insistohet që njeriu madje të thellohet sa më shumë në logjikën e tij, e që në shkencën psikologjike quhet meditimi. Meditimi mbi vlerat reale të kësaj ekzistence, meditimi mbi Krijuesin Mëshirëplotë me anë të krijimtarisë së Tij, duke filluar nga vetvetja, më pastaj për gjitha krijesat e Zotit në këtë ekzistencë në mënyrë që të merren mësim dhe udhëzime.

Meditim i thellë ishte parapërgatitja e Pejgamberit të fundit Muhamedit a.s., për shpalljen dhe misionin e tij të shenjtë, duke shkuar në shpellën Hira dhe duke medituar me orë, ditë, javë dhe muaj të tërë rreth mirësive dhe krijimtarisë së Zotit. Në këtë mënyrë, Zoti Mëshirëplotë e forcoi dhe e përgatiti për amanetin qiellor që t'ia përcjellë dhe mësojë njerëzimit.

Për edukimin e mendjes, logjikës, racios, për vlerën e mendimit të thellë dhe zhvillimin e mendjes, Muhamedi a.s. fliste shumë gjatë jetës së tij dhe insistonte në këtë drejtim duke thënë: “Nuk ka ibadet (vullnetar), të barabartë (të ngjashëm) me meditimin (të menduarit të thellë).” (Bejhaki IV:157.)

Njeriu me bashkimin e edukimit të komponentës, shpirti, zemra dhe mendja e bëjnë konceptin e plotë të karakterit të tij. Pra, shpirti i edukuar, zemra e pastërtë dhe mendja e shëndoshë janë pasuritë më të mëdhaja të kësaj bote që duhen edukuar, zhvilluar dhe kultivuar gjatë gjithë jetës së njeriut.

Mimoza Sinani

# Poligamia sipas Islamit

Kur Muhamedi a.s. e ri prezantoi fenë islame, poligamia ishte e zakonshme dhe kishte lëshuar rrënjë të thella në jetën sociale. Kurani nuk e injoroi e as nuk e refuzoi, por filloi ta organizojë dhe ta pastrojë institucionin në mënyrë që të çrrënjosë traditat e tij të këqija dhe të sigurojë përfitimet dhe anët pozitive.

**P**oligamia nuk u hartua dhe nuk zuri fill nga Islami, por është praktikuar në mbarë historinë njerëzore. Në fenë e Isait a.s. nuk ka ekzistuar ndonjë urdhër ndalimi për poligaminë. Ai e konfirmoi Ligjin e Musait a.s. dhe në të poligamia njihet zyrtarisht. Dhiata e Vjetër dhe shkrimet e rabinëve e argumentojnë legalitetin e poligamisë.<sup>1</sup>

Islami nuk e shpiku apo inicioi sistemin e poligamisë, por nuk e shfuqizoi apo e anuloi krejtësisht, mbase në periudha të caktuara në shoqëri shfaqen vështirësi, zgjidhja e të cilave varet ekskluzivisht nga poligamia.

Kur Muhamedi a.s. e ri prezantoi fenë islame, poligamia ishte e zakonshme dhe kishte lëshuar rrënjë të thella në jetën sociale. Kurani nuk

**Muhamedi a.s.  
e kufizoi një  
institucion  
ekzistues duke  
e kufizuar numrin  
e grave ligjore deri  
në katër dhe duke  
i dhënë çdo gruaje  
personalitet ligjor  
dhe të drejta  
ligjore**

e injoroi e as nuk e refuzoi, por filloi ta organizojë dhe ta pastrojë institucionin në mënyrë që të çrrënjosë traditat e tij të këqija dhe të sigurojë përfitimet dhe anët pozitive.<sup>2</sup> Islami bëri reforma në këto tradita duke vendosur ngushtime dhe kufizime mbi poligaminë.

Ai kufizoi një institucion ekzistues duke e kufizuar numrin e grave ligjore deri në katër dhe duke i dhënë çdo gruaje personalitet ligjor dhe të drejta ligjore, të cilat duhet të respektoheshin dhe të cilat e bënin çdo burrë legalisht përgjegjës për sjelljet e tij ndaj çdo gruaje. Se a do të ketë përparësi poligamia apo monogamia në një shtet të caktuar apo në një periudhë historike, kjo është çështje e bindjes sociale dhe ekonomike.<sup>3</sup>



## Martesa – shenjë e bekimit të Zotit

Lidhja bashkëshortore është një litar hyjnor që i bashkon zemrat dhe i qetëson ato kur janë të shqetësuara. Shtëpia është qendër dashurie, kujdesi dhe miqësie.<sup>4</sup>

Raporti midis burrit dhe gruas nuk është një raport thjesht utilitar. Ky raport ka karakter shpirtëror dhe prej tij burojnë: dashuria, mirëkuptimi, mbështetja, besimi reciprok, shpirti i sakrificës, përkrahja dhe ndihma.<sup>5</sup>

Marrëdhëniet martesore nuk kufizohen vetëm në çështjet materiale dhe fizike, pra ato nuk kufizohen vetëm në çështjet trupore dhe monetare. Në to, gjëja kryesore dhe themelore është ana shpirtërore dhe emocionale. Kjo përfshin dashurinë, emocionet dhe ndjenjat. Pika qendrore e harmonisë martesore është zemra.

Nëse jeta martesore kalohet në harmoni atëherë aty krijohet prehje, relaksim dhe çlodhje mendore mbas detyrave dhe obligimeve. Pas këtyre të mirave që janë fryte të harmonisë bashkëshortore, çdo i martuar mund t'i përkushtohet veprimtarisë së tij me një zell të ripërtërirë dhe më me devotshmëri.<sup>6</sup>

Burri gjithmonë ka paguar për nevojat materiale të gruas, deri në vetëflijimin. Po ashtu, nxitja më e mirë dhe më e fuqishme për punë dhe aktivitet është paqja dhe mirëqenia e jetës së tij familjare, pra, gruaja dhe fëmijët e tij.

Në çështjen e martesës ndikojnë dy elementë: elementi material dhe ai shpirtëror. Elementet materiale janë aspektet seksuale, të cilat në rini janë në zenitin e tyre dhe gradualisht shuhen dhe qetësohen. Aspekti shpirtëror lidhet me ndjenjat e sinqerta, të dhembshura dhe të buta dhe rriten me kalimin e kohës. Për gruan, ndryshe nga burri, elementi i dytë është më i rëndësishëm se i pari.

Për burrin, martesa është më e rëndësishme për nga aspekti material, ndërsa për gruan është më e

rëndësishme nga aspekti shpirtëror dhe emocional. Nëse një burrë e braktis jetën familjare dhe jepet pas aventurave të dashurisë, ai mund të kënaq gjysmën e nevojave të tij, por nëse gruaja e braktis ambientin familjar dhe jepet pas aventurave të dashurisë, ajo nuk mundet t'i kënaq as në masën më të vogël nevojat e saj materiale apo shpirtërore. Gruaja është nga natyra monogamiste. Poliandria (pasja e shumë burrave) është e papajtueshme me tendencën e saj natyrore. Gruaja dëshiron që zemra e burrit t'i përkasë asaj. Ai duhet të jetë mbrojtësi dhe përkrahësi i saj. Ai duhet të jetë vetëmohues dhe t'i përkushtohet asaj. Ai duhet të përpiqet t'i sjellë asaj të holla, t'i dhurojë asaj frytet e mundit dhe të ardhurat e tij dhe të përkujdeset për të me kujdes delikat.

## Gruaja rivale

Nëse burri dhe gruaja e tij vazhdojnë rrjedhën normale të jetës së tyre dhe befas burri bie në kontakt me një grua tjetër, magjepset prej saj dhe pushtohet nga dëshira për një martesë tjetër dhe, më pas, pas bisedimeve dhe marrëveshjeve të fshehta, papritmas një grua e dytë hyn në shtëpi, në strehën e mëparshme të gruas së parë dhe e rrëmben burrin e saj, atëherë është e pamundur të shpresosh vetëpërmbajtje dhe qëndrueshmëri nga gruaja e parë karshi këtij sulmi të papritur mbi jetën e saj.

Për një grua, kundërshtar më të urryer se sa një grua rivale nuk ekziston. Poligamia i hap rrugën ballafaqimit dhe konfliktit mes grave. Ambienti i jetës martesore, i cili duhet të jetë një mjedis paqeje dhe përzemërsie, shndërrohet në një fushëbetejë dhe në një vend dhe hakmarrjeje. Rivaliteti mes nënave transmetohet edhe te fëmijët e tyre përkatës. Ambienti familjar, i cili është shkolla e parë dhe fidanishtja shpirtërore për fëmijët dhe që duhet të jetë frymëzuesi i drejtësisë dhe

## Nuk ka asnjë dyshim se monogamia, nga pikëpamja e gëzimit dhe mirëqenies personale, është e më preferuar ndaj poligamisë.

mirësjelljes, bëhet një institucion i përçarjes.

Nuk ka dyshim se poligamia ua hap rrugën të gjithave këtyre përshlyetjeve të pakëndshme në lidhje me edukimin e brezave të ardhshëm. Por këto probleme nuk shkaktohen nga natyra e vetë poligamisë. Shumë nga këto probleme lindin nga mënyra se si ajo zbatohet në praktikë.

Disfata më e madhe për gruan është të mendojë dhe të shohë se dikush tjetër e ka fituar zemrën e burrit të saj. Kur burri merr një qëndrim kokëfortë dhe tekanjoh dhe gruaja e dytë mban pozicionin e një sulmi të papritur, atëherë të shpresosh vetëpërmbajtje dhe qëndrueshmëri nga gruaja e parë në këto rrethana është të shpresosh të pamundurën.

Ky mospranim mund të jetë relevant vetëm kur ky hap merret nga burri për hir të dëfrimit dhe nga dëshira për variacion. Nëse gruaja është në gjendje që të garantojë në çdo aspekt interesat e bashkëshortit të saj, burri nuk mund të justifikohet për marrjen e një tjetre. Në rastin kur nuk mendohet thjesht argëtimi dhe variacioni, por ekziston një nga arsyet, si për shembull nëse gruaja është sterile, apo ka arritur menopauzën e saj dhe burri dëshiron të ketë fëmijë, apo nëse gruaja është e sëmurë dhe nuk është e aftë ta kryejë funksionin e gruas, atëherë mospranimi i gruas së parë nuk është i vlefshëm.

Në të vërtetë, shumica e problemeve lindin për shkak të mënyrave të pahijshme që burrat zbatojnë në përdorimin e kësaj të drejte ligjore në praktikë.

Meqenëse në jetën e shoqërisë mund të shfaqen raste kur poligamia bëhet e nevojshme, ajo pranohet me kushtin e drejtësisë në sjellje. Kurani urdhëron në mënyrën më të qartë: “E nëse i frikoheni padrejtësisë (ndaj tyre), atëherë vetëm me një (grua).” (4:3)

Drejtësia është virtyti më i shkëlqyer njerëzor. Trajtimi një-trajtësisht i ngjashëm i secilës prej grave të tij, duke respektuar drejtësinë dhe duke shmangur diskriminimin, duhet të konsiderohet si një nga detyrat më të vështira për një burrë. Poligamia, me këtë kusht të ashpër dhe të rreptë moral, në vend se të jetë një burim epshi për burrin, merr trajtën dhe formën e kryerjes së një detyre.

## Monogamia është forma më e natyrshme e jetës bashkëshortore

Shumica e atyre njerëzve që janë të kënaqur dhe të lumtur me poligaminë, praktikisht, janë ata që i injorojnë obligimet fetare dhe përgjegjësitë morale. Ata që e kanë bërë poligaminë një burim për përmbushjen e epshit e kanë bërë ligjin islam një justifikim për një akt të shëmtuar. Shoqëria ka të drejtë t'i qortojë dhe mos t'i lërë të justifikohen.

Ata interesohen për një grua dhe i neglizhojnë krejtësisht të drejtat e gruas tjetër dhe “e lënë atë si të varur.” Kjo gjë, që këta njerëz e quajnë poligami, ka në fakt natyrën e monogamisë, por me një pamje të shëmtuar. Ata, duke e ditur plotësisht se nuk do të sillen me drejtësi, martohen me disa gra dhe e bëjnë atë në emër të Islamit dhe nën pretekstin e Islamit.

Në qoftë se një burrë mendon se poligamia, me të gjitha detyrimet e saj fetare dhe morale, është në interesin e tij dhe e konsideron atë si të dobishme për kënaqësinë e tij, ai gabohet rëndë. Për burrin ekzistojnë përgjegjësi të tilla të rënda dhe trullöse, sa që për t'i përmbushur ato ai duhet të heqë dorë nga kënaqësitë dhe lehtësitë e jetës. Nuk ka asnjë dyshim se monogamia, nga pikëpamja e gëzimit dhe mirëqenies personale, është e më preferuar ndaj poligamisë. Poligamia zbatohet në raste të skajshme dhe vetëm nëse gruaja është psikologjikisht e gatshme ta pranojë atë ide.<sup>7</sup>

Në parim, nëse nuk ekzistojnë faktorët personalë dhe socialë, poligamia nuk është e pëlqyeshme as edhe me lejen e gruas së parë.

Duhet të kujtojmë se çdo grua, e cila dëshiron që martesë e saj të mbetet monogamike, mund ta sigurojë këtë kusht sipas ligjit islamik.<sup>8</sup>

## Kur është e justifikueshme poligamia?

Monogamia nënkupton një jetë të qetë dhe të sigurt familjare dhe nuk ka asnjë dyshim rreth faktit se monogamia është më e mirë se poligamia. Fryma e jetës martesore është njëshmëria dhe uniteti dhe kjo arrihet më mirë dhe më me përsosmëri me një bashkëshort të vetëm.

Megjithatë, përveç arsyeve që përmendëm më lart, ekziston edhe një shkak i rëndësishëm për justifikimin e shoqërisë për pranimin e poligamisë. Madje, në këtë rast, poligamia është një e drejtë në favor të gruas dhe një detyrë dhe përgjegjësi për burrin dhe shoqërinë.

Sot në të gjitha vendet e botës janë në dispozicion statistika të sakta në lidhje me numrin e banorëve të tyre. Në raportet e regjistrimit, jo vetëm që mund të gjenden shifrat për

gjininë mashkullore dhe femërore, por evidentohet edhe numri krahasues për secilën gjini në grupmoshat e ndryshme, dhe kështu mund të dihet saktë përqindja krahasuese e numrit të meshkujve dhe femrave në moshën e martesës.

Nëse numri i grave të afta për t'u martuar e kalon numrin e meshkujve për martesë, ligji që e kufizon martesën në monogami do të jetë në kundërshtim me këtë të drejtë natyrore, pra do të jetë në kundërshtim me të drejtat themelore dhe natyrore të njeriut. E drejta e martesës është e drejta më e natyrshme njerëzore dhe asnjë person nuk duhet të privohet nga kjo e drejtë.

Nëse monogamia do jetë forma e vetme e ligjshme e martesës, një grup grash do të mbeten të privuara nga çdo lloj jete familjare. Në këtë rast, poligamia duhet të konsiderohet si e drejtë e grave të privuara dhe ‘përgjegjësi’ e burrave dhe e grave të martuara.

Ky fenomen ka ekzistuar pothuajse gjithmonë në jetën e njerëzimit. Komunitetet, uni shpirtëror i të cilave është i mbrojtur me devotshmëri nëpërmjet udhëzimit të feve të mëdha hyjnore, e kanë zgjidhur këtë problem nëpërmjet poligamisë dhe komunitetet, për të cilat, vlera e devotshmërisë dhe e virtytit nuk është aq e pëlqyeshme, e kanë zgjidhur nëpërmjet shthurjes. Komunitetet që janë dhënë pas imoralitetit kanë pësuar më shumë dëm se sa ato që e kanë miratuar poligaminë.

Nëse konstatojmë se ekziston nevoja e ngutshme shoqërore dhe se shoqëria është vërtet duke vuajtur nga tejkalimi i numrit të grave mbi numrin e burrave, apo në rastet kur për interesin e përgjithshëm të shoqërisë është i nevojshëm shtimi i popullsisë, atëherë poligamia bëhet një obligim altruist.

Një numër tepër i madh i grave të pamartuara gjermane, të cilat, si rezultat i numrit të madh të viktimave në mesin e gjermanëve në Luftën e Dytë Botërore ishin privuar nga pasja



e burrit ligjor dhe e jetës familjare, i ishin drejtuar zyrtarisht qeverisë së tyre për anulimin e ligjit të monogamisë dhe për lejimin e poligamisë. Qeveria gjermane, në bazë të kësaj kërkesë zyrtare, i kishte kërkuar Universitetit Islamik të El-Ez'herit që t'u siguronte atyre një formulë për të zbatuar këtë, por Kisha e kishte kundërshtuar prerazi këtë hap.<sup>9</sup>

Feja islame nuk përpiket të tërhiqet nga çështja dhe ta injorojë këtë problem. Ajo është mjaft reale, e hapët, e drejtpërdrejtë dhe praktike. Solucioni që ofron feja islame është ligjor, i ndershëm dhe bamirës.

Tani dikush mund ta pyes veten se cila është zgjidhja më e mirë për një shoqëri të llojit të tillë. A është e rekomandueshme që të lejosh kaosin dhe sjelljen e papërgjegjshme të shkatërrojnë bazat themelore të shoqërisë, apo të kthehesh e ta pranosh solucionin islam? Është shumë më mirë për një shoqëri t'u lejojë individëve të saj të bashkohen në një bazë legale, me mbrojtjen e Ligjit dhe nën kontrollin e autoriteteve përkatese.<sup>10</sup>

Islami e trajton problemin në tërësi dhe jo vetëm pjesët e tij. Zgjidhjet e pjesshme, nuk janë zgjidhje të përhershme. Poligamia është një valvul sigurimi që vepron kur domosdoshmëria e arsyeton atë.<sup>11</sup>

Ligji i poligamisë lind nga një pikëpamje progresive dhe e avancuar

për zgjidhjen e një problemi të madh social dhe kështu, në mënyrë të pashmangshme, përkrahësit e saj duhet ta vënë atë në praktikë në një nivel të lartë moral. Ata duhet të jenë të prirë nga vizioni më i lartë islam.

## Burri modern dhe poligamia

Burri modern nuk e dëshiron poligaminë jo si rezultat i dëshirës së tij për t'i mbetur besnik gruas së tij, por sepse ajo krijon detyrime financiare dhe detyra të caktuara për të. Burri modern i ndryshon dashnoret e tij pas intervaleve të shkurtra kohore dhe nuk ballafaqohet me asnjë obligim ose detyrim sa i përket kënaqjes së pakufizuar të epshit të tij.

Perëndimi i kritikon myslimanët, kurse në anën tjetër u lejon meshkujve të vet të kenë shumë dashnore, duke i injoruar të gjitha kufizimet dhe përgjegjësitë ligjore ose etike ndaj gruas ose ndaj rrjedhës që pason nga poligamia joligjore, jofetare e jomorale.<sup>12</sup>

Përkundrazi, 'bota moderne' vazhdimisht e fton burrin që ta përballojë me durim ekzistencën e rivalëve në çështjet martesore dhe që ta respektojë dashurinë e gruas së tij duke i dënuar rastet e padurimit me emrat: zili, ngurtësi, intolerancë, fanatizëm etj..

Në të vërtetë, perëndimorët që e kritikojnë poligaminë te myslimanët, e ushtrojnë atë praktikisht, mirëpo pa rregulla dhe pa caqe, pa ndonjë detyrim moral, fetar apo ligjor.<sup>13</sup>

Poligamia, pa dyshim, nuk imponohet prej Islamit dhe as është një praktikë universale. Përdorimi dhe perceptimi i këtij institucioni, është larg stereotipit hollivudian. Në vend të kësaj, ajo konsiderohet si përjashtim ndaj normës së monogamisë dhe ushtrimi i saj kontrollohet fuqimisht prej presioneve sociale. Myslimanët e vlerësojnë poligaminë si një institucion që duhet të vihet në veprim vetëm nën rrethana të jashtëzakonshme.<sup>14</sup>

1. Lois Lamya 'el-Faruki, Muhamed Xh. Bahonari, Muhamed Sharif, *Femra nën mbrojtjen e Islamit*, Gjiilan, 1998, f. 100. 2. Hamudeh Abd-Ul-Ati, *Islami në fokus*, Shkup, 1992, f. 199. 3. Meududi, *Letërkëmbimi mes Merjem Xhemiles dhe Ebu'l A'la el Meududit*, Shkup, 1992, f. 60. 4. Ibrahim Amini, *Etika bashkëshortore*, Tetovë, 2003, f. 11. 5. Ahmed Hurshid, *Familja dhe Islami*, Tiranë, 1999, f. 19. 6. Imam Muhamed el-Gazali, *Ilaçi i lumturisë*, Gjakovë, 2000, f. 76. 7. Dr. Murad Hofmann, *Islami si alternativë*, 2000, Shkup, f. 175. 8. Mimoza Sinani, *Vlerësimi i lëvizjes feministe nga këndvështrimi islam*, Prishtinë, 2008, f. 83. 9. Murteza Mutahari, *The rights of women in Islam*, 1980, f. 189. 10. Hamudeh Abd-Ul-Ati, *Islami në fokus*, Shkup, 1992, f. 202-203. 11. Prof. Sejid Kutub, *Islami dhe pagja universale*, Tetovë, 2005, f. 99. 12. Dr. Jusuf Kardavi, *Hallalli dhe Harami në Islam*, (2), Prishtinë, 2002, f. 234. 13. Dr. Jusuf Kardavi, *Mesazhi ynë në epokën e globalizmit*, Shkup, 2005, f. 224. 14. Lois Lamya Faruki, *Gratë, shoqëria muslimane dhe Islami*, Logos-A, 2007, f. 69.

PhD (C) Melihate Zeqiri

# Shumëgjuhësia institucionale (1)

Kosova, një Zvicër e vogël linguistike e ballkanike

**N**ë pikëpamje të zbatimit të shumëgjuhësisë institucionale, Kosova është tregimi më i suksesshëm, si të thuash një Zvicër e vogël linguistike e Ballkanit ose një Finlandë e Europës Veriore. Pakoja e Marti Ahtisaarit, e integruar në Kushtetutën e Kosovës, i ka të përcaktuara qartë kufijtë përfundi të cilëve nuk mund të bie. Për shembull, dy gjuhët zyrtare të Kosovës nuk mund të zbatohen asnjëherë në mënyrë selektive dhe arbitrare, diku po e diku jo. Ato zbatohen gjatë tërë kohës, në tërë Kosovën, pa përjashtim. Pakoja ka paraparë që edhe ndonjë gjuhë tjetër mund të jetë gjuhë zyrtare në vendbanime të ndryshme, aty ku një pakicë i plotëson disa kritere të përcaktuara, siç është p.sh. turqishtja në Mamushë. Pra, ajo që asnjëherë nuk mund të vihet në pikëpyetje është shumëgjuhësia institucionale në Kosovë.

**Nëse në Kosovë gjuhë zyrtare janë edhe ato që fliten nga më pak se një për qind (turqishtja), apo serbishtja që flitet nga rreth 5 për qind e popullsisë, atëherë si mund të mos jetë gjuhë zyrtare shqipja që flitet nga 25 për qind shqiptarët (sipas statistikës zyrtare) në Maqedoni?!**

Me këtë standard mund të thuhet se Kosova është shteti më i ri dhe më modern i Ballkanit, ku të gjitha gjuhët kanë trajtim të barabartë në komunikimin publik. Nëse kjo formulë ka arritur të implementohet me sukses në Kosovë, një vend me mazhorancë të madhe shqiptare dhe me minorancë të vogël serbe, ku serbishtja flitet në një masë prej 5 për qind, atëherë përse një formulë e tillë nuk mund të zbatohet në Maqedoni, një “vend me mazhorancë të vogël (maqedonase) dhe minorancë të madhe (shqiptare), ku shqiptarët, në këtë Republikë, sikundër kudo në Ballkan në tërësi, janë një vazhdimësi etnike e gjeografike dhe jo enklave” (Sali Berisha), dhe përbëjnë zyrtarisht 25 për qind të popullsisë?

Shteti i ri i Kosovës ka legjislacionin më të avancuar gjuhësor në Ballkan dhe ky mund të jetë model edhe për shtetet e tjera fqinje. Kosova ka



krijuar kushtet e duhura për t'u mundësuar të gjithë qytetarëve që lirshëm të kultivojnë, shprehin dhe zhvillojnë identitetet e tyre gjuhësore, duke ua garantuar këto të drejta përmes Kushtetutës dhe Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. E drejta për përdorimin e gjuhës së tjetrit në Kosovë nuk kontestohet nga askush. Nuk i shkon ndërmend askujt nga 90 për qind e popullsisë shqiptare që të kontestojë pse serbishtja që flitet nga 5 për qind e popullsisë serbe ka status të barabartë me shqipen. Ky tregim i përdorimit të gjuhës në Kosovë duhet të zbatohet një herë e mirë dhe sa më parë edhe në Maqedoni.

Të mësohet të bashkëjetosh me gjuhën e tjetrit, kjo është çështje hamletiane: të jesh a të mos jesh. Do të citojmë Vili Brand-in (1913-1992) – kancelarin e Republikës Federative të Gjermanisë (1968-1974) dhe mbajtësin e Çmimit të Nobelit për Paqe 1971. Ai thoshte: “Në qoftë se unë blej diçka prej teje, ti duhet të flasësh në gjuhën time. Por në qoftë se unë të shes ty diçka – unë jam i detyruar të flas në gjuhën tënde.”

Ndërsa Vergilio Ferreira e shihet gjuhën kështu: “Gjuha është vendi nga ku shihet bota e ku përvijohen kufijtë e mendimeve dhe ndjenjave tona. Nga gjuha ime shikohet deti. Nga gjuha ime dëgjohe zurma e tij,

## Gjuha kombëtare është tipar i çdo kombi. Nga një tipar i tillë karakterizohet edhe kombi shqiptar

*(Miço Samara)*

sikurse nga gjuhë të tjera do të ndihet ajo e pyllit ose heshtja e shkretëtirës.”

Të refuzosh gjuhën e tjetrit do të thotë të refuzosh tjetrin, identitetin e tjetrit, kulturën e tjetrit, të refuzosh komunikimin dhe bashkëjetesën me tjetrin, të jesh kundër idesë dhe vlerave civilizuese evropiane. Nuk duhet t'i përshtatet përdorimi i gjuhëve në një territor të caktuar kushtetues, por Kushtetuta duhet t'i përshtatet realitetit linguistik. Nëse në Afrikën e Jugut edhe gjuha me 2.9 për qind është gjuhë zyrtare (Afrika e Jugut ka njëmbëdhjetë gjuhë zyrtare dhe shteti ka njëmbëdhjetë emra), nëse në Kosovë gjuhë zyrtare janë edhe ato që fliten nga më pak se një për qind (turqishtja), apo serbishtja që flitet nga rreth 5 për qind e popullsisë, atëherë si mund të mos jetë gjuhë zyrtare shqipja që flitet nga

25 për qind shqiptarët (sipas statistikës zyrtare) në Maqedoni?!

Ndonëse në Jugosllavinë Socialiste, serbokroatishtja ka qenë gjuhë amtare për 73 për qind të popullsisë, ajo nuk është shpallur si gjuhë e vetme zyrtare në nivel shtetëror, por si gjuhë e barabartë me të gjitha gjuhët e tjera të asaj bashkësie. Ndërsa në Maqedoninë e sotme, maqedonishtja që flitet nga gjysma e popullsisë së këtij vendi, është shpallur me Kushtetutë gjuhë e vetme në përdorimin zyrtar!

Gjuha kombëtare është tipar i çdo kombi. Nga një tipar i tillë karakterizohet edhe kombi shqiptar (Miço Samara), edhe kombi maqedonas, edhe kombi bullgar, serb, kroat, grek, rumun etj., me gjuhët e tyre kombëtare. Gjuhët kombëtare sot nuk duhet të perceptohen si dikur si gjuhë që u bëjnë të liga të tjerëve, por si pasuri gjuhësore edhe për të tjerët. Gjuha shqipe është një pasuri e madhe dhe për kombin shqiptar është e vetmja pasuri. Gjuha shqipe është kult për shqiptarët dhe prandaj ata nga kjo gjuhë nuk mund të heqin dorë asnjëherë as në shtetin e tyre të quajtur Maqedoni.

Guy Parmelin, ministër i Sportit i Zvicrës, shprehet: “Jemi një vend me shumë gjuhë, kultura dhe mendime dhe jetojmë në paqe së bashku. Jemi krenar me këtë kolorit. Ai e bën vendin tonë të fuqishëm.”



MSc. Drin Aliu

# Kushtet infrastrukturore, sfidat dhe financat e Medresesë së Mesme “Alauddin” në Prishtinë mes viteve 1962-1999

Si çdo shkollë tjetër gjatë shekullit të kaluar edhe Medreseja “Alauddin” kishte sfida dhe vështirësi nga më të ndryshmet. Kjo shkollë që nga shndërrimi i saj në shkollë të mesme, mes vitet 1962-1985 veprimtarin e saj edukativo-arsimore e zhvilloj në godinat e Medresesë së Ulët, në kushte infrastrukturore relativisht të vështira. Këtë më së miri e dëshmon ish-nxënësi i kësaj shkolle Hajrullah Hoxha i cili kishte vijuar dhe përfunduar shkollimin në objektin e vjetër të Medresesë. Ndër të tjera lidhur me kushtet infrastrukturore ai pohon se: “Për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike dhe skamjes së madhe që mbretëronte në përgjithësi edhe në medrese kushtet e jetesës kanë qenë të dobëta. ... Ndërtesa e konviktit, ku flinim nuk kishte ngrohje fare. Krevatet ishin të metalit, navllakët e dyshekëve dhe të jastëkëve ishin të mbushur me kashtë, ndërsa për t’u mbuluar i kishin nga dy batanije si të ushtrisë të cilat nuk mbanin nxehtë. ... Përtej ndërtesës së konviktit, kanë qenë 2-3 banja të thjeshta për t’u pastruar në rast nevojë, ndërsa një here në javë, te premtëve në mëngjes, shkonim grup në hamam (në banjën publike) që gjendej afër Xhamisë së Madhe për t’u pastruar më mirë për xhuma”.<sup>1</sup> Objekti shkollor i përshkruar, për shkak të vjetërisë në njërin anë dhe hapësirës së pamjaftueshme në anën tjetër nuk i plotësonte nevojat për një shkollë normale. Për ti përmbushur kërkesat dhe nevojat e nxënësve që vijonin dhe që do ti vijonin mësimet në këtë institucion edukativo-



*Objekti i vjetër i Medresesë “Alauddin”*

arsimor domosdoshmërisht nevojitej ndërtimi i një objekti të ri shkollor. Siç shihet sfida kryesore gjatë kësaj periudhe ndër të tjera ishte edhe hapësira e kufizuar e objektit shkollor dhe kushtet jo të mira infrastrukturore. Si pasojë e mungesës së hapësirës së nevojshme, përkundër kërkesave të nxënësve të cilat ishin gjithnjë në rritje, Medreseja ishte e detyruar që ta kufizonte numrin e pranimit të nxënësve. Për shkak të mungesës së hapësirës, Medreseja “Alauddin” deri në vitet e 90-ta nuk kishte fare paralele për gjininë femërore.

Si rezultat i nevojës imediate, Kryesia e Bashkësisë Islame në vitin 1979 mori vendim për ndërtimin e një objekti të ri shkollor për Medresenë.<sup>2</sup> Objekti i ri shkollor u

finalizua dhe u hapë më 14 shtator 1985. Ky projekt u realizua me kontributet e besimtarëve.<sup>3</sup> Objekti i ri shkollor i Medresesë “Alauddin” ishte modernë dhe i plotësonte të gjitha kushtet për veprimtari edukativo-arsimore dhe jo vetëm, gjatë viteve 90-të ky objekt shkollor u bë vatër e të gjitha organizimeve politike, arsimore, kulturore, sportive etj., në shërbim të interesave kombëtare. Objekti i ri Medresesë “Alauddin” krahas klasave të mjaftueshme, posedonte: konvikt, mensën, banjo, amfiteatër, kabinete, librarinë, sallën e faljes së namazeve, sallat sportive etj. Hapja e objektit të ri lehtësonte punën si për mësimdhënësit ashtu edhe për nxënësit. Si rezultat i hapësirave të mjaftueshme dhe moderne u rrit





Opisje i rrëzimit të "Alauddin"

shumë edhe numri i nxënësve. Ajo që mund të themi në përgjithësi është se si në objektin e vjetër, ashtu edhe në vobektin e ri rezultatet nuk munguan, veçse në objektin e ri puna ishte më e lehtë si rezultat i kushteve më të mira infrastrukturore dhe numri i nxënësve ishte më i madh si rezultat i kapaciteteve të mjaftueshme infrastrukturore.

Medreseja "Alauddin" kishte sfidë në vete edhe financimin e saj, por falë vullnetit të mirë ajo financohej dhe përkrahej nga populli i Kosovës si me mjete financiare ashtu edhe me produkte ushqimore dhe gjëra të tjera.<sup>4</sup> Jo vetëm, Medreseja përkrahej

edhe nga mërgata shqiptare në mërgim. Këtë e dëshmojnë shumë dokumente që gjenden në Arkivin e Medresesë së Mesme "Alauddin". Në një Vërtetim të datës 30.05.1995 të lëshuar nga drejtorja e Medresesë së Mesme "Alauddin", dëshmohet se një shumë prej 12.000 DM i janë dhuruar Medresesë "Alauddin" si ndihmë humanitare nga xhemati i Brukselit përmes Arsim Ramadanit me prejardhja nga Ferizaj.<sup>5</sup> Po ashtu drejtorja e Medresesë përmes një letre falënderimi të datës 28.03.1996, falënderon mërgatën shqiptare në Gjermani për ndihmën e vazhdueshme ndaj

Medresenë, veçanërisht për ndihmën e fundit në shumë prej 1340 DM.<sup>6</sup> Përmes një vërtetimi tjetër të datës 27.10.1996, dëshmohet se një shumë prej 40.100 DM, kishte ardhur nga Gjermania përmes Daut Imerit si ndihmë humanitare e mërgatës shqiptare për Medresenë "Alauddin".<sup>7</sup> Se ka pasur ndihma të vazhdueshme nga populli dhe mërgata shqiptare e dëshmojnë edhe shumë dokumente arkivore që gjenden në Arkivin e kësaj shkolle. Që të mos zgjerohemi më shumë në këtë çështje, ajo që mund të themi në përgjithësi është se të gjitha këto dhe shumë ndihma të tjera tregojnë qartë se kjo shkolle funksiononte me ndihmën dhe kontributin e popullit, ashtu siç financohet dhe funksionon edhe sot. Krahas sfidave të shumëllojshme, Medreseja "Alauddin" e vazhdoi rrugëtimin e saj duke i kaluar të gjitha barrierat dhe duke shënuar rezultate shumë dimensionale si në aspektin edukativo-fetar ashtu edhe në aspektin kombëtar.

1. Hajrullah Hoxha, "Kujtime nga ditët në Medresenë "Alauddin" në Prishtinë", në: Medreseja "Alauddin" e Prishtinës: 65 vjet në shërbim të arsimit fetar dhe kombëtar: përmbledhje kumtesash nga Konferenca shkencore, (Prishtinë, 17-19 maj 2017), Përgatiti për botim Ramadan Shkodra, Sadik Mehmeti, (Prishtinë: Dituria Islame, 2018), 237.
2. Ramadan Shkodra, "Zhvillimi i institucioneve edukativo-arsimore islame në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore", në: Kalendar/Takvim 2021, kryeredaktor Ahmet Sadriu, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, 2021), 204.
3. Shpend Fidani, "Medreseja "Alauddin" në shtypin boshnjak", në: Medreseja "Alauddin" e Prishtinës: 65 vjet në shërbim të arsimit fetar dhe kombëtar: përmbledhje kumtesash nga Konferenca shkencore, (Prishtinë, 17-19 maj 2017), Përgatiti për botim Ramadan Shkodra, Sadik Mehmeti, (Prishtinë: Dituria Islame, 2018), 450.
4. Më gjerësisht rreth financimit të Medresesë "Alauddin" shih: Revisiën "Edukata Islame" numër: 1, 2, 3, 5, 7, 9-10, 11-12, 15-16, 17, 18, 20, 21, 24, 25, 26, 28-29, 35-36, 37-38, 39 dhe 41.
5. Arkivi i Medresesë së Mesme "Alauddin" Prishtinë, Fondi: Veprimtaria e Medresesë "Alauddin" mes viteve 1995-1997 (dokumente të parregulluara-paklasifikuara), viti 1995, Kutia nr.7, Vërtetim.
6. Arkivi i Medresesë së Mesme "Alauddin" Prishtinë, Fondi: Veprimtaria e Medresesë "Alauddin" mes viteve 1995-1997 (dokumente të parregulluara-paklasifikuara), viti 1996, Kutia nr.7, Falenderim nr.56/96.
7. Arkivi i Medresesë së Mesme "Alauddin" Prishtinë, Fondi: Veprimtaria e Medresesë "Alauddin" mes viteve 1995-1997 (dokumente të parregulluara-paklasifikuara), viti 1996, Kutia nr.7, Vërtetim nr.190/96.



Një nga ambientet e shkollës (biblioteka e pasur me libra të fushave të ndryshme)

## Myftiu Tërnavë qëndroi për vizitë zyrtare në Katar

Më 5 prill, me ftesë të emirit të Katarit, Temim al-Thani, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, qëndroi për një vizitë zyrtare në Katar.

Gjatë kësaj vizite, ai u prit në takim nga ministri për Vakëfe dhe Çështje Fetare, Ganim bin Shahin al-Ganimi. Fillimisht, Myftiu Tërnavë uroi nikoqirin për postin e ministrit të Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme në detyrën e re, e më pas e falënderoi paraardhësin e tij, ministrin Al-Kavari për bashkëpunimin e shkëlqyer, duke theksuar edhe rëndësinë e thellimit të këtij bashkëpunimi në të ardhmen. Myftiu edhe njëherë falënderoi Qeverinë dhe popullin e Katarit për përkrahjen dhe ndihmën që i kanë dhënë Kosovës dhe popullit të saj gjatë dekadave të fundit. Më pas, Myftiu Tërnavë e njohu ministrin me projektet dhe me sfidat që ka Bashkësia Islame e Kosovës. Një falënderim të veçantë,



Myftiu e adresoi për ministrin Al-Ganimi, për financimin e dy projekteve vakëfnore, atë në Gjilan dhe në Lipjan.

Ndërkaq, ministri Al-Ganimi, i dëshiroi mirëseardhje Myftiut Tërnavë dhe delegacionit shoqëruës, duke konfirmuar kështu vazhdimin e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Ministri Al-Ganimi

çmoi lart kontributin e Myftiut Tërnavë dhe të Bashkësisë Islame të Kosovës, që Kosova të jetë një vend i paqes, tolerancës dhe harmonisë ndërfaqetare. Në fund të takimit, të dyja palët shkëmbyen dhurata ndërmjet vete. Myftiu Tërnavë gjatë kësaj vizite u shoqërua nga shefi i kabinetit, mr. Besim Mehmeti dhe zv.kryeimami Fatmir ef. Iljazi.

## Myftiu Tërnavë mori pjesë në iftarin e shtruar nga emiri i Katarit

Më 5 prill, me ftesë të emirit të Katarit, Temim al-Thani, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në iftarin e shtruar nga emiri i Katarit. Emiri i Katarit, sheikh Temim bin Hamad


al-Thani, shtroi iftar në pallatin e tij, për nder të dijetarëve, gjykatësve dhe sheikëve. Në këtë iftar morën pjesë sheiku Xhasim bin Hamad al-Thani, përfaqësuesi personal i emirit, ministri i Vakëfeve të Katarit Al-Ganimi, si

dhe një numër i shkëlqesive të sheikëve. Mysafirë nderi në këtë iftar ishin kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, myftiu i Bosnjës, myftiu i Kroacisë dhe myftiu i Sllovenisë.



## Myftiu Tërnavë vizitoi Zyrën Qendrore të Qatar Charity në Doha

Më 7 prill, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka vizituar Zyrën Qendrore të Qatar Charity në Doha të Katarit. Myftiu Tërnavë u prit në takim nga asistenti i CEO-së për sektorin e operacioneve dhe programeve ndërkombëtare në Qatar Charity, z. Nawaf al-Hammadi. Myftiu e falënderoi nikoqirin për përkrahjen dhe kontributin e ofruar nga shteti i Katarit për Kosovën në përgjithësi, si dhe për ndihmën që ka ofruar Shoqata e Katarit, e cila vepron në Kosovë që nga pas lufta. Nga ana e tij, z. Al-Hammadi, e falënderoi Myftiun për vizitën, duke shprehur kështu gatishmërinë e bashkëpunimit me Bashkësinë Islame të Kosovës. Në



fund të takimit, të dyja palët u pajtuan që të vazhdojnë bashkëpunimin ndërmjet tyre në fusha të ndryshme, në interes të qytetarëve të Kosovës.

## Myftiu Tërnavë mori pjesë në ceremoninë përmbyllëse të garave të Kuranit në Katar



Më 9 prill, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në ceremoninë përmbyllëse të shpalljes së fituesve të garave të Kuranit, të mbajtura nën patronazhin e shejh Xhasim bin Muhamed al-Thani. Me këtë rast, ministri i Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Katarit, Ganim bin Shahn

el-Ganimi falënderoi Myftiun Tërnavë për pjesëmarrjen, si dhe çmoi kontributin e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai vlerësoi rolin e Myftiut Tërnavë për ndërtimin e paqes, harmonisë dhe tolerancës në Kosovë. Myftiu Tërnavë falënderoi ministrin e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të

Katarit, El-Ganimin për mikpritjen, duke thënë se është tejet i nderuar me këtë pjesëmarrje në këtë ceremoni. Ai tha se do të shikohet mundësia që të bashkëpunohet në të ardhmen në organizimin e garave të memorizimit të Kuranit. Në këtë garë morën pjesë më shumë se 1400 garues nga vende të ndryshme. (R.S.)

## Myftiu Tërnavë mori pjesë në iftarin e Këshillit të BI-së së Pejës

Më 11 prill, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij ka marrë pjesë në iftarin e shtruar nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Pejës. Në këtë iftar morën pjesë edhe kryetarët e komunave Pejë, Klinë, Deçan, zëvendëskryetari i Komunës së Junikut, zyrtarë nga policia e Kosovës, hoxhallarë, si dhe të ftuar të tjerë. Fillimisht, mysafirët i përshëndeti kryetari i Këshillit të BI-së së Pejës, Musli ef. Arifaj, i cili falënderoi ata për pjesëmarrjen dhe i uroi për muajin Ramazan, me lutjet të Zotit për agjërime të pranuar. Në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu Tërnavë vlerësoi dhe çmoi punën dhe angazhimin e imamëve për mbarëvajtjen e jetës fetare në vend. Ai



uroi edhe njëherë gjithë imamët për muajin e bekuar Ramazan, duke lutur Zotin që t'ua pranojë agjërimit dhe punët e mira që i bëjnë gjatë këtij muaji të bekuar. Myftiu Tërnavë

kërkoi edhe njëherë nga të gjithë imamët që të jenë edhe më të përkushtuar në misionin e tyre dhe që të jenë sa më pranë xhematit, sidomos gjatë muajit Ramazan.

## Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj shtroi iftar për udhëheqësit e BIK-ut

Më 13 prill, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë mori pjesë në iftarin që shtroi lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës z. Ramush Haradinaj. Me këtë rast, lideri i AAK-së Haradinaj theksoi se si vazhdimësi e pritjeve tradicionale në muajin e bekuar Ramazan, sonte, në selinë e Aleancës, kam shtruar iftar, për nder të Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Myftiut Naim ef. Tërnavë dhe bashkëpunëtorëve të tij. Ai shprehu mirënjohje për kontributin e çmuar të BIK-ut në të gjitha etapat drejt lirisë, pavarësisë dhe shtetndërtimit. Ai më pas tha se në frymën e bashkimit në një sofër, si një prej traditave qindrvjeçare, shpirtërore e humane të popullit shqiptar, sonte në selinë e AAK-së, kam shtruar iftar për BIK-ut, myftiun Naim Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij. Në çdo angazhim tonin, krahas materiale, ishin vlerat shpirtërore ato që na rrëfyen rrugën e drejtë të



bashkimit e solidaritetit, në realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

Rrugëtimi njëmuajor me agjërime, lutje dhe devotshmëri ndaj Krijuesit, të na shërbejë në thellimin dhe forcimin e përkrahjes dhe zemërgjerësisë. Agjërime të lehtë, begati dhe mirëqenie për çdo familje! Ndërkaq nga ana e tij Myftiu Tërnavë duke

falënderuar kryetarin e AAK-së z. Ramush Haradinaj për këtë iftar që tashmë është bërë tradicional, nënvizoi se BIK-u vazhdimisht punon që në Kosovë të ketë harmoni e bashkëjetesë dhe respekt të ndërsjellë mes të gjithë njerëzve pavarësisht dallimeve etnike dhe fetare që mund t'i kemi. (R.S.)

## Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, shtroi iftar për udhëheqësit e BLK-ut

Më 16 prill, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij është pritur në iftar nga kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, tha se në shenjë nderi e respekti prita në iftar Myftiun e Kosovës, Naim ef. Tërnavën me bashkëpunëtorët e tij.

"Muaji i shenjtë i Ramazanit, në traditën tonë në Kosovë, ka shërbyer edhe si përafrim e bashkim mes njerëzve, duke u manifestuar me virtye të larta shoqërore, si solidariteti, mirëkuptimi e humanizmi. Besimi dhe adhurimi ndaj Zotit, posaçërisht gjatë këtij muaji, qofshin frymëzim për të gjithë, që veprat e mira për familjen, shoqërinë e shtetin, të kultivohen e shtohen edhe më



shumë" - thuhet në njoftimin e kryetarit Krasniqi. Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin e PDK-së, Memli Krasniqin për këtë iftar, duke

shprehur edhe njëherë gatishmërinë e tij dhe të institucionit të BIK-ut që të punohet për të mirën e gjithë qytetarëve të vendit.

## Myftiu Tërnavë shtroi iftar për udhëheqësit dhe administratën e këshillave të BI-së

Më 17 prill, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë ka shtruar iftar për të gjithë udhëheqësit e këshillave të Bashkësisë Islame, administratat dhe nëpunësit fetarë.

Ky iftar është shndërruar tashmë tradicional, me ç'rast Myftiu Tërnavë përmes këtij organizimi në Medresenë "Alauddin", falënderoi të gjithë nëpunësit fetarë për punën, kontributin dhe angazhimin e dhënë. Myftiu Tërnavë përmes këtij iftari tradicional inkurajoi të gjithë nëpunësit dhe imamët për të vazhduar edhe më tutje me përkushtimin, angazhimin në rrugën që kanë zgjedhur.

"Vizitoni besimtarët, jini bashkë me ta, ata kanë nevojë për ne dhe për këtë fe, ata na respektojnë ne, ata na çmojnë jashtëzakonisht shumë ne, për çka edhe duhet t'u jemi falënderues. Besimtarët në Kosovë çdoherë i kanë dhënë vendin që duhet të kenë prijësit fetarë. Ne kemi xhematin, që askush në botë nuk e



ka" - tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë. Myftiu Tërnavë mes tjerash veçoi rolin e Medresesë "Alauddin" e cila ka shkolluar dhe edukuar të gjithë imamët e sotëm dhe që vazhdon ta bëjë një gjë të tillë edhe me gjeneratat e reja. "Kjo Medrese ku jemi këtu, është shtëpia jonë, është vendi ku ne kemi kaluar një kohë shumë të gjatë edhe si nxënës, dikush edhe si

mësimdhënës. Është një vend prej të cilit kanë dalë me mijëra nxënës të cilët po i shërbejnë Islamit në Kosovën tonë, mirëpo edhe në mërgatën e largët. Me një fjalë, Medreseja, ka qenë është dhe do të mbetet çdo herë një gur themeltar i vendit tonë", ka thënë Myftiu Tërnavë në këtë organizim.

## Myftiu Tërnavë mori pjesë në vënien e gurthemelit të xhamisë së re në Podujevë

Më 18 prill, qyteti i Podujevës nisi ndërtimin e një xhamie të re për banorët e kësaj ane. Kjo falë kontributit të vëllezërve Besim dhe Shaip Stublla, të cilët dhuruan tokën për ndërtimin e kësaj xhamie si sadaka për shpirtin e prindërve të tyre. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe kryetari i BIK-ut, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili në fjalën e tij përmendi rëndësinë e ndërtimit të xhamive, si një obligim për besimtarët myslimanë. “Jemi në muajin Ramazan, në muajin e Kuranit, solidaritetit e bamirësisë, në muajin kur besimtarët motivohen edhe më tepër që t’i kryejnë obligimet e tyre karshi Zotit Fuqplotë. Andaj sot, në këtë ditë fisnike, jemi mbledhur këtu për të filluar me ndërtimin e një xhamie të re, e cila do t’u shërbejë banorëve të kësaj ane për t’i kryer obligimet e tyre. Lusim Allahun e Madhëruar që këtë vepër tuajën ta pranojë dhe t’ua shpërblejë në këtë dhe në botën tjetër” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.



Kryetari i Këshillit të BI-së në Podujevë, Mensur ef. Hoti, në fjalën e tij, falënderoi familjen Stublla për dhurimin e kësaj toke, duke e cilësuar këtë si një akt fisnik e madhor. “Sot është një ditë e veçantë për llapjanët, ngase po fillon edhe ndërtimi i një shtëpie të Zotit, e cila do t’u shërbejë dhe do t’ua lehtësojë kryerjen e obligimeve fetare të gjithë qytetarëve në përgjithësi, por edhe banorëve të kësaj ane në veçanti. Lusim Zotin e Madhëruar që ta pranojë në peshojën e veprave të mira këtë bamirësi, e t’i

shpërblejë familjen Stublla me të mirat e kësaj dhe botës tjetër” – tha kryetari Hoti.


Në emër të familjes, një fjalë rasti mbajti Muhamed Stublla, i cili fillimisht falënderoi Myftiun për pjesëmarrjen e gjithashtu një falënderim të veçantë ua dedikojë vëllezërve Stublla. Ai tha se “kjo është një nismë e mirë pozitive për këta banorë dhe për të gjithë ata që do ta shfrytëzojnë këtë xhami. Lusim Allahun që t’iu shpërblejë me të mirat e Tij.”

## Myftiu Tërnavë priti në takim akademikët Feti Mehdiu dhe Muhamed Mufaku

Më 19 prill, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim akademikët Feti Mehdiu dhe Muhamed Mufaku. Në këtë takim, akademikët fillimisht uruan Myftiun Tërnavë për muajin e bekuar Ramazan, duke lutur Zotin për pranim të ibadeteve dhe veprave gjatë këtij muaji. Ata më pas e informuan Myftiun për botimin e Veprave të zgjedhura të akademik Hasan Kaleshit. Ata thanë se këto vepra janë botuar në gjuhën shqipe, arabe, turke dhe boshnjake dhe deri më tani janë përgatitur katër vëllime, ndërsa janë në përgatitje të botimit edhe katër vëllime të tjera. Myftiu

Tërnavë i uroi dhe i përgëzoi akademikët për punën dhe angazhimin e tyre për ndriçimin e

figurës së akademik Hasan Kaleshit, si dhe ofroi përkrahje dhe mbështetje për këtë projekt.



## Myftiu Tërnavë mori pjesë në tryezën shkencore për zekatin që u mbajt në Shkup

Më 20 prill, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka marrë pjesë në tryezën shkencore me temë “Zekati – vlerë islame në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e jetës fetare”, e cila u organizua nga Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë së Veriut. Kjo tryezë u mbajt në ambientet e shkollës së mesme “Medreseja Isa Beu” në Shkup.

Në fjalën përshëndetëse drejtuar të pranishmëve, Myftiu Tërnavë potencoi institucionin e zekatisë e institucionalizoi vetë Muhamedi a.s., duke na mësuar kështu edhe neve se ku duhet dhënë ai. “Kohëve të fundit kemi një vetëdijësim të madh të myslimanëve për ta dhënë zekatin dhe sadakatul fitrin në fondin e bashkësive fetare islame” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.



Reisul ulema i BFI-së, Shaqir ef. Fetai, në fjalën e tij nënvizoi: “Rijaseti ka vendosur që t’i kushtoj një rëndësi të veçantë zekatisë me organizimin e kësaj tryeze shkencore, andaj them me përgjegjësi se panelistët e nderuar janë kompetentë të flasin për të, duke u bazuar në bagazhin e tyre shkencor”.

Kumtesat e tyre në lidhje me zekatin i paraqitën dy panelistët, prof. Jusuf Zimeri dhe dr. Islam Hasani, të cilët dhanë një qasje burimore islame për zekatin, definicionin, distribuimin dhe metodat bashkëkohore të kuptimit të tij.

Pas tryezës, për mysafirët u shtrua iftar i përbashkët në ambientet e Medresësë. (R.S.)

## Myftiu Tërnavë priti në takim përfaqësuesit e Ministrisë së Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite

Më 20 prill, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim përfaqësuesit e Ministrisë së Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite, Abdullah al-Anzi dhe Abdulmuhsin al-Kadibi. Qëllimi i vizitës së tyre është realizimin i projektit “Iftaret e mbretit Selman bin Abdulaziz dhe shpërndarja e pakove”, i cili do të realizohet në Kosovë.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirëve e më pas i njohu edhe me punët dhe veprimtaritë e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë për fushën e humanizmin, duke i informuar kështu ata edhe me planet dhe projektet e shoqatës “Bereqeti”, e cila funksionon në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai falënderoi ata dhe nëpërmes tyre mbretin e Arabisë,



Selman bin Abdulaziz për ndihmat e dhuruara gjatë këtij muaji të bekuar Ramazan. Ai kujtoi se edhe në fillim të muajit Ramazan, nga Arabia Saudite kanë pranuar një donacion me mbi 2000 pako ushqimore të cilat janë shpërndarë te familjet nevojtare në tërë territorin e Kosovës. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e

Ministrisë së Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite falënderuan Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për gatishmërinë e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që të bashkëpunojnë mes vete. Ata shprehën bindjen se një bashkëpunim i tillë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

## Myftiu Tërnavë mori pjesë në promovimin e dy librave të botuara nga Fakulteti i Studimeve Islame

Më 21 prill, në sallën e konferencave të Fakultetit të Studimeve Islame u bë promovimi i dy librave universitarë, të profesoreshës dr. Ilmije Kuqi me titull “Margaritari në detin e fikhu ibadatit” si dhe profesorit prof. ass. dr. Shefqet Krasniqi me titull “E drejta penale në shëriatin islam studim krahasimor” të botuar nga ky institucion. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë, studiues, dashamirë të librit dhe të kulturës në përgjithësi.

Një fjalë përshëndetëse mbajti dekani i FSI-së, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, i cili foli për rëndësinë e fjalës së shkruar dhe më pas foli për përmbajtjen e librave të botuar nga FSI-ja, duke potencuar se këto tekste universitare do t'u shërbejnë studentëve për thellimin e njohurive të tyre në shkencat islame.



Ndërsa, në fjalën e tij, Myftiu Naim ef. Tërnavë, përgëzoi dekanin Rexhepi dhe autorët e librave për botimin e tyre, duke theksuar se tashmë këta libra janë në duart e studentëve dhe studiuesve dhe janë shembulli më i mirë për studentët tanë. Ai vlerësoi punën dhe kontributin e autorëve të dy librave dhe se këta libra do të lehtësojnë edhe me shumë çështjen e të nxënësve dije për studentët tanë në FSI.

Pas përfundimit të fjalëve përshëndetëse, fjala iu dha dy referuesve të dy librave të botuar dr. Ajni Sinani si dhe dr. Valon Myrta. Kurse krejt në fund edhe autorët e librave falënderuan Kryesinë e BIK-ut dhe dekanatin e FSI-së për këtë organizim, duke ju premtuar lexuesve se edhe në të ardhmen do të vazhdojnë me kontribute shkencore me libra të ndryshëm. (R.S.)

## Myftiu Tërnavë u prit në takim nga kryeministri Kurti



Më 22 prill, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, është pritur në takim nga kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti. Kryeministri Kurti e uroi Myftiun Tërnavë për muajin Ramazan, duke e cilësuar këtë muaj si muaj të bashkësisë dhe solidaritetit me ata që janë në pozitë ekonomike më të vështirë. Ai uroi për zemërsisht

Myftiun dhe gjithë besimtarët myslimanë për përmbushjen shpirtërore, si dhe për agjërime të lehtë gjatë ditëve të mbetura të këtij muaji. Ai gjithashtu e falënderoi Myftiun Tërnavë dhe gjithë BIK-un për kontributin e tyre dhënë për respektimin e masave mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së Covid-19, duke theksuar se ky

Ramazan tashmë na gjen në një gjendje më të mirë të shëndetit publik. Myftiu Tërnavë falënderoi kryeministrin Kurti për pritjen, duke theksuar se BIK- edhe më do të jetë e përkushtuar që në Kosovë të mbretërojë paqja dhe harmonia ndërfaqetare për të gjitha komunitetet që jetojnë këtu.



## Kryesia e BIK-ut shtroi iftar për nëpunësit e BIK-ut

Më 22 prill, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare nga Arabia Saudite shtroi iftar në kuadër të projektit “Shporta e Ramazanit iftar për agjëruesit” në ambientet e Medresesë “Alauddin” në Prishtinë.

Në këtë iftar mori pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë bashkëpunëtorë, përfaqësues të Ministrisë së Vakëfeve nga Arabia Saudite, imamë, profesorë të FSI-së profesorë të Medresesë “Alauddin”, mualime dhe nëpunës të tjerë të BIK-ut.

Të pranishmëve me një fjalë rasti iu drejtua Myftiu Tërnavë, i cili uroi të pranishmit për dhjetë ditshin e fundit të Ramazanit, duke lutur Zotin xh.sh., që duatë dhe lutjet tona t'i pranojë.

Ai më pas falënderoi përzemërsisht Mbretërinë e Arabisë Saudite, gjegjësisht mbretin Selman bin Abdulaziz për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Bashkësisë Islame dhe shtetit të Kosovës. “Dua të falënderoj popullin dhe qeverinë e



Arabisë Saudite për ndihmat e vazhdueshme që i ka dërguar Kosovës si ato para luftës, po ashtu edhe për ato pas luftës. Në një bashkëpunim dhe në një koordinim ndërmjet BIK-ut dhe Arabisë Saudite kemi ndihmuar mbi 400 familje nevojtare me pako ushqimore. BIK-u është mirënjohëse për ata se çfarë ka bërë, por edhe në atë se çfarë është duke bërë si në ndihma humanitare ashtu edhe në anëtarësimin e Kosovës në organizata të huaja.” – tha Myftiu Tërnavë, duke falënderuar nëpunësit e BIK-ut për mundin dhe aktivitetin

e ndryshme brenda muajit Ramazan, duke potencuar se vetëm duke qenë të bashkuar ecim drejt sukseseve të reja. Ai në veçanti përmendi rolin e mualimeve dhe të Departamentit të Gruas, që në krahasim me të kaluarën, kanë luajtur rol shumë të madh në edukimin e brezit të ri dhe kalitjen e ndjenjës së njerëzimit në zemrën dhe shpirtin e filizave të rinj e gjeneratave të reja. Ai po ashtu këshilloi që të shtojmë ibadetet edhe në këto pak ditë e net të Ramazanit që na kanë mbetur. (R.S.)

## Myftiu Tërnavë priti në takim Myftiun e Stambollit, prof. dr. Safi Arpaguş

Më 23 prill, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim Myftiun e Stambollit, prof. dr. Safi Arpaguş, i cili qëndroi për vizitë zyrtare në vendin tonë. Myftiu Tërnavë fillimisht falënderoi mysafirin nga Stambolli myftiun Arpaguş për vizitën dhe e njohu me zhvillimin dhe historikun e Bashkësisë Islame, me theks të veçantë me organizimin e jetës fetare dhe të institucioneve fetaro-arsimore në Kosovë. Nga ana e tij, Myftiu i Stambollit, prof. dr. Safi Arpaguş, falënderoi Myftiun Tërnavë për mikpritjen e ngrohtë dhe vlerësoi fuqizimin institucional të Bashkësisë Islame dhe kontributin e saj në ngritjen e vetëdijes dhe ndërgjegjes fetare të besimtarëve.



Myftiu i Stambollit prof. dr. Safi Arpaguş dje ka qëndruar në Prizren, ku ka shtruar edhe iftar për 500 persona, dhe më pas bashkë me kryeimamin Vedat Sahiti kanë prirë në namaz të jacisë dhe të teravive në

xhaminë “Koxha Sinan Pasha”, ndërsa më pas vizituan Mitrovicën dhe për namaz të jacisë dhe të teravive qëndruan në xhaminë “Bajram Pasha Isa Beg” bashkë me myezinët e xhamisë Aja Sofja.

## Myftiu Tërnavë priti në takim kryetarin e TIKA-s

Më 23 prill, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA), z. Serkan Kayalar. Myftiu Tërnavë e falënderoi z. Kayalar për vizitën dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer që ka TIKA me Bashkësinë Islame të Kosovës në realizimin e një sërë projektesh të rëndësishme për Bashkësinë Islame, sidomos në fushën e arsimit dhe të trashëgimisë kulturore. Nga ana e tij, kryetari i TIKA-s, z. Serkan Kayalar, falënderoi Myftiun Tërnavë



për pritjen dhe për bashkëpunimin, si dhe theksoi përkushtimin e tij dhe të institucionit që ai drejton për

thellimin e këtij bashkëpunimin edhe në të ardhmen në fushat e interesit të përbashkët.

## Myftiu Tërnavë mori pjesë në iftarin e shtruar nga KBI e Gjakovës

Më 23 prill, Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjakovë, shtroi iftar regional për strukturat e ndryshme të shoqërisë, ku të pranishëm ishin edhe kryetari Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, kryetari i Komunës së Rahovecit Smajl Latifi, kryetari i Këshillit të Rahovecit, Shani Sylka, kryetari i Këshillit të Malishevës Sead Paçarizi, deputetët Hisen Berisha dhe Agon Batusha, përfaqësues të shumtë të institucioneve, personalitete nga fusha të ndryshme, imamë nga Rahoveci dhe Malisheva, xhematlinjë nga të gjitha xhamitë e Gjakovës dhe qytetarë të tjerë.

Në fillim kryetari i KBI-së së Gjakovës, dr. Valon Myrta, i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrje në këtë iftar madhështor. “Ky muaj i sjell njerëzit pranë njëri-tjetrit me hare dhe shpresë. Ne ju falënderojmë që keni dhënë mundësinë që të jemi zëri juaj artikulues për çështjen e besimit dhe dora juaj e shtirë e solidaritetit për të gjithë ata që janë skamnor”, tha ai.



Më pas fjalën e mori kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, i cili tha se kjo mbledhje dëshmon se ka njerëz të cilët respektojnë vlerat njerëzore dhe fetare.

Të pranishmëve iu drejtua edhe Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili vuri theksin për rëndësinë e muajit të bekuar Ramazan.

“Muaji Ramazan është muaj i solidaritetit, është muaj i afrimit me njëri-tjetrin, është muaj që ngërthen në vete të gjitha vlerat që duhet t'i ketë individit, familja dhe shoqëria. Populli ynë, kombi ynë ka arritur qëllimin që e ka gjithnjë në veten e

vet, që të fisnikërohet dhe që t'ia dalë çdo punë të cilën është nisur për ta kryer, sigurisht se të bashkuar dhe duke qenë unik që të gjithë do t'ia dalim. Bashkësia Islame e Kosovës asnjëherë nuk ka qenë peshë e rëndë për të gjitha rrjedhat e përgjithshme në vendin tonë, por gjithherë ka qenë ndihmëse e proceseve si para luftës, gjatë luftës dhe pas luftës”, tha Myftiu Tërnavë.

Nga të pranishmit u tha se në këtë muaj më së miri shprehet besimi, sinqeriteti, humanizmi dhe solidariteti, virtyte këto që duhen të jenë pjesë jetës te secili besimtar. (R.S.)

## Myftiu Tërnavë mori pjesë në iftarin e shtruar nga KBI e Gjilanit

Më 24 prill, Këshilli i Bashkësisë Islame i Gjilanit shtroi iftarin tradicional “Iftari na bashkon”, ku të pranishëm ishin edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, përfaqësues të KBI-së së Gjilanit, kryetarët e komunave të regjioni të Anamoravës, Luginës së Preshevës, përfaqësues të Dijanetit të Republikës së Turqisë, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të spitalit regional, dekani i Fakultetit të Studimeve Islame me bashkëpunëtorë, rektori i Universitetit Kadri Zeka, përfaqësuesit nga FSK, KFOR-i, përfaqësuesit e partive politike, deputetë, veteranët e UÇK-së, përfaqësuesit e familjeve të dëshmorëve, drejtori i Medresesë “Alauddin” me bashkëpunëtorë,



kryetar të këshillave të BI-së së Vitisë, Kamenicës, Pejës, Mitrovicës, Preshevës etj.

Kryetari i KBI-së së Gjilanit, Naim ef. Aliu, u shprehu mirëseardhje të gjithë të pranishmëve që iu përgjigjen ftesës nga të gjitha viset. Me këtë rast, në emër të Kryesisë së BIK-ut këtë iftar e përshëndeti Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili veç të tjerash

tha se i shprehim falënderime Allahut për begatitë që na i ka dhënë dhe lusim Zotin që agjërimin dhe ibadetet tona të na i pranojë.

Një fjalë përshëndetëse mbajtën edhe kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, dhe ambasadori i Shqipërisë Qemajl Minxhozi. (R.S.)

## Myftiu Tërnavë mori pjesë në iftarin e shtruar nga KBI i Prishtinës

Më 26 prill, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, së bashku me imamët e Prishtinës, kryetarin e kryeqytetit, përfaqësues të KFOR-it, mjekë, zjarrfikës, policë, besimtarë dhe figura të ndryshme publike morën pjesë në iftarin e organizuar nga Këshilli i BI në Prishtinë. Ky organizim në të cilën u bë edhe më madhështorë me prezencën e shumë figurave dhe besimtarëve, vjen në fundin e Ramazanit – duke pasur parasysh rëndësinë dhe vlerën e veçantë që kanë ibadetet. Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në fjalën e tij foli pikërisht për rëndësinë e Natës së Kadrit, natë kjo që i shton edhe më shumë begatinë muajit Ramazan. “Kanë mbetur edhe pak ditë, kanë mbetur edhe pak net, ka mbetur nata më domethënëse më e lavdëruar që ekziston brenda vitit dhe që gjendet brenda muajit Ramazan– ajo është Nata e Kadrit, që sa net po luftojmë që të takohemi



me të, që sa net po e thërrasim nga thellësia e shpirti që ne t'i ledhatojmë begatitë e tua. Nuk ka besimtarë që nuk takohet me të dhe nuk merr nga të mirat e saj”, tha Myftiu në fjalën e tij. Kryetari i KBI në Prishtinë, Hetem ef. Sopjani, organizatori i këtij iftari, tha se muaji Ramazan na bashkon me Krijuesin, me ibadete dhe me nevojtarët që të jemi pranë tyre.

Kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, u shpreh i impresionuar me organizimin dhe

me bashkimin e shumë figurave publike në këtë iftar në kryeqytet. “Është me të vërtetë kënaqësi e madhe me qenë së bashku me të gjithë ju, një komunitet i mirëfilltë, një komunitet fantastik, pozitiv. Këtu sot agjërimi si një proces që tash edhe botërisht njihet që na bën mirë, jo vetëm në aspektin fetar por edhe në atë shëndetësor ku edhe pjesëtarë të feve të ndryshme që agjërojnë me besimtarët islam”, tha ai.

## Familja Pacolli shtroi iftar për udhëheqësit e Bashkësisë Islame të Kosovës

Më 28 prill, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë dhe me përfaqësuesit e këshillave lokale të BIK-ut, kanë marrë pjesë në iftarin e shtruar nga familja Pacolli. Këtë iftar e bëri edhe më të veçantë dhurimi i parcelës nga familja Pacolli, në sipërfaqe prej 2 hektarësh për Bashkësinë Islame të Kosovës në lagjen Kodra e Trimave në Prishtinë. Në këtë parcelë do të ndërtohet Qendra Islame, e cila do të funksionojë në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës. Këtë e bëri të ditur kryetari i AKR-së, Behgjet Pacolli, i cili ndër të tjerash theksoi se është kënaqësi për të dhe për



familjen Pacolli që të ndajë këtë parcelë për nevojat e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, falënderoi z. Behgjet Pacolli, si dhe

familjen Pacolli për këtë donacion, duke lutur Allahun që t'ua pranojë si sadaka rrjedhëse, dhe që Zoti t'i shpërblejë me të mirat e Tij në këtë dhe botën tjetër.

## Kryeministri Kurti shtroi iftar për udhëheqësit e BIK-ut



Më 1 maj, kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, së bashku me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, z. Glauk Konjufca, pritën në iftar kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiun Naim ef. Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij.

Kryeministri Kurti shprehu respektin për devotshmërinë dhe vetëpërmbytjen e besimtarëve myslimanë gjatë muajit Ramazan. Ai

uroi që sakrificat e tyre të shpërblehet dhe solidariteti e ndjeshmëria të forcojnë edhe më shumë besimin dhe mirëkuptimin ndërmjet njerëzve.

Në prag të festës së Bajramit, që shënon fundin e muajit të agjërimit, kryeministri Kurti i uroi Myftiut Tërnavë dhe të gjithë besimtarëve myslimanë Bajram të gëzuar.

“Humanizmin e tolerancën e besimtarit gjatë Ramazanit t'i kemi

udhërrëfyes të përhershëm të përditshmërisë sonë”, tha kryeministri Kurti.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë falënderoi z. Kurti dhe Konjufca për këtë iftar, si dhe shprehu bindjen dhe gatishmërinë e tij dhe të institucionit të BIK-ut, që në Kosovë të mbretërojë paqja dhe harmonia ndërmjet gjithë qytetarëve të vendit pa dallim.

## Besimtarët myslimanë festuan Fitër-Bajramin

Më 2 maj, besimtarët myslimanë në Kosovë festuan festën e Fitër-Bajramit.

Manifestimi qendror i kësaj feste u mbajt në Xhaminë e Madhe në Prishtinë, shoqëruar me këndim të Kuranit, selavate, tekbirove dhe ilahive.

Fillimisht namazit të sabahut i priu kryetari i Këshillit të BI-së në Prishtinë, Hetem ef. Sopjani, ndërsa ligjëratën tematike kushtuar festës së Fitër-Bajramit e mbajti Bahri ef. Hoxha, për të vazhduar më pas me namazin e Bajramit, të cilit i priu kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim Tërnavë mbajti hytben e Bajramit, ku përmendi rëndësinë dhe veçoritë e kësaj feste që në vete sjell dashurinë, respektin, tolerancën ndaj njërit-tjetrit si dhe begatitë të tjera.

Duke lutur Zotin që të na e ketë pranuar agjërimin, ai tha “Festa e Fitër Bajramit si asnjë festë tjetër na bashkon me familjen me më të dashurit tanë, me fqinjët, miqtë e



farefisin, ngase këtë e kemi obligim. Zoti na mëson se besimtarë të vërtetë janë ata që mbajnë lidhjet familjare, ngase për to ka urdhëruar Allahu. Festa e Fitër-Bajramit është një prej momenteve më të gëzueshme për të gjitha kategoritë e shoqërisë, ngase në vete përmban mesazhet hyjnore që ofrojnë familjen të afërmit miqtë dhe farefisin”, tha ai.

Myftiu Tërnavë mes tjerash bëri thirrje për paqe nëpër të gjitha vendet e botës duke specifikuar vendet ku Fitër-Bajrami i ka gjetur në konflikte të armatosura.

“Ne po shijojmë mirësitë e kësaj feste, në shumë vende të botës kemi

konflikte e gjakderdhje ku popullata e pafajshme po përballet me padrejtësi, dëbime, vrasje e shkatërrime. Nuk është ky misioni i njeriut në këtë jetë, kështu nuk na mësojnë librat e Zotit e nuk kanë ligjëruar në këtë mënyrë as të dërguarit e Zotit”, tha Myftiu në hytben e Bajramit.

Festa e Fitër Bajramit për besimtarët mysliman vjen pas përfundimit të muajit Ramazani, ku besimtarët kanë agjëruar për gjatë gjithë muajit si dhe shënojnë këtë muaj me ibadete të ndryshme.

## Myftiu Tërnavë organizoi pritje për urime me rastin e festës së Fitër-Bajramit



Me rastin e Fitër – Bajramit, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, si tradicionalisht, organizoi pritje për urime në selinë e Kryesisë së BI-së së Kosovës.

Për të uruar Myftiun Tërnavë dhe të gjithë besimtarët myslimanë, nga përfaqësuesit e institucioneve në vizitë qenë: kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ipeshkvi

i Kishës Katolike, z. Dodë Gjergji, kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës, z. Behar Ejupi, kryetari i BSPK-së, z. Atdhe Hykolli, kryetari i AAK-së, z. Ramush Haradinaj, kryetari i LDK-së, Lumir

Abdixhiku, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, kryetari i PD-së, Ferid Agani, përfaqësuesi i komunitetit ashkali, z. Qazim Rrahmani, Jusuf Osmani, Muhamet Boja, Resul Rexhepi, ish sekretar i Kryesisë së BIK-ut etj.

Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, në urimin e tij tha: “Falënderoj Bashkësinë Islame të Kosovës dhe Myftiun Tërnavë për kontributin dhe rolin e jashtëzakonshëm për shoqërinë, për shtetin për kombin, për çlirimin, edhe për pavarësinë edhe për shtetndërtimin e zhvillimin e Kosovës. Në veçanti e falënderoj që nëpërmjet rrjetit të saj, Bashkësia Islame e Kosovës po ndihmon shumë që të shpërndahen pakot për qytetarët e vendit tonë, të cilët janë pjesë e masave tona që ta kalojmë sa më kollaj dhe sa më shpejtë të gjithë bashkërisht këtë krizë të shumëfishhtë.”

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ndër të tjera tha: “Ua uroj të gjithë besimtarëve shqiptarë këtë festë të rëndësishme. Po ashtu e falënderova Myftiun për kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë Bashkësia Islame për organizimin e jetës fetare në komunitetin, shoqërinë tonë, në popullin tonë. Ky rol i rëndësishëm i Bashkësisë Islame ka qenë tradicionalisht kështu. Mua më kujtohet edhe fëmijë kur kam qenë gjatë viteve të 90-ta, roli i BIK-ut ka qenë me të vërtetë për t’u vlerësuar dhe është vlerësuar vazhdimisht prej popullit tonë. Unë e falënderova që po e vazhdojnë këtë kontribut”, tha ai.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, tha: “Kam nderin që në emër të AAK-së, t’ua uroj festën e Fitër-Bajramit Myftiut Tërnavë, Bashkësisë Islame, gjithë shqiptarëve besimtarë myslimanë që e festojnë Bajramin, me fat Bajrami! Lusim Zotin që t’ua pranojë agjërimin të gjithë atyre që kanë agjëruar”, ka thënë Haradinaj.

Dodë Gjergji nga Ipeshkvia e Kosovës: “Urime festa në radhë të parë Bashkësisë Islame dhe



shkëlqesisë së tij, z.Tërnavë. Në gjithë popullin tonë është ditë feste, për ne sipas Fishtës, Bajram e Pashkë i festojmë bashkë sepse jemi të gjithë vëllezër dhe festojmë me njëri-tjetrin duke uruar gjithë popullin tonë, gjithë njerëzit që festojmë, begati, paqe, rehati, mirëkuptim, pajtim dhe gëzim për secilin”, ka thënë ai.

Lumir Abdixhiku, kryetari i LDK-së, në urimin e tij ka thënë: “Në këtë festë ne mësojmë shumë, mësojmë për vlerat bazike njerëzore, atë të solidaritetit dhe atë të sakrificës si dy vlera jetike për çdo njeri, për sjelljet tona, për shoqërinë tonë, për politikën tonë pa përjashtim. Lutemi që këto të njëjtat të vazhdojnë edhe përtej festës së sotme, përtej muajit të kaluar, sepse kështu mbajmë shoqërinë tonë drejt begatisë së përgjithshme.”

Memli Krasniqi, kryetari i PDK-së, ka thënë: “Është një festë e cila shënon kulminacionin e një muaji të shenjtë, të përkushtimit, durimit njerëzor ndaj sprovave dhe lakmisë. Sot i ftoj të gjithë qytetarët e Kosovës të marrin shembull dhe inspirim nga kjo festë që të bëhen edhe më bujar, edhe më të hapur, edhe më tolerant edhe më mirëbesues me njëri-tjetrin dhe me rrethin e tyre.”



## Myftiu Tërnavë vizitoi familjen Jashari në Prekaz

Më 2 maj, për nder të festës së Fitër-Bajramit, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë, vizitoi familjen Jashari në Prekaz, në të cilën u mirëprit nga baci Rifat Jashari.

Me këtë rast Myftiu e falënderoi bacin Rifat dhe familjen Jashari për pritjen dhe respektin dhe njëherësh ua uroi festën e Fitër-Bajramit, duke lutur Zotin që familjen Jashari ta shpërblejë për sakrificën e pashembullt që kanë bërë për Kosovën dhe që t'i shpërblejë në dy botët me të mirat e Tij.



Në emër të familjes Jashari, baci Rifat, e falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe çmoi kontributin e BIK-ut dhe Myftiut Tërnavë që kanë dhënë dhe po japin në të mirë

të vendit si në aspektin fetar ashtu edhe në atë kombëtar.

Më pas delegacioni nga Kryesia vizitoi varrezat e familjes Jashari, ku edhe kënduan nga një El-Fatiha.

## Kryeimami Sahiti mori pjesë në aktivitetin fetar në Bujanoc

Më 1 prill, me këndim të Kuranit, ilahive dhe ligjëratës kushtuar muajit Ramazan, është shënuar organizimi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Bujanoc.

Në këtë organizim morën pjesë besimtarë të shumtë si dhe figura eminente nga jeta politike e kulturore të këtij rajoni, si deputeti shqiptar në Serbi, Shaip Kamberi, kryetari i Kuvendit Komunal të Bujanocit, Enver Ramadani, kryetari i Këshillit Nacional Shqiptar, Ragmi Mustafi si dhe personalitete të tjera. Pjesë e këtij aktiviteti ishte edhe kryeimami i BIK-ut, Vedat ef. Sahiti, i cili fillimisht uroi besimtarët për muajin Ramazan, si dhe në veçanti besimtarët e kësaj pjese. “Ne si Bashkësi Islame, ne si hoxhallarë, na rreh zemra për këtë vend, për popullin tonë që jeton në këto troje tona, mirëpo gjithnjë kjo është pjesë e pandarë e trupit tonë, kjo trevë është pjesë e pandarë kombit tonë dhe ne gjithmonë do të mundohemi të jemi



bashkë. Andaj shfrytëzoj këtë rast që t’ua uroj muajin e madh të bekuar Ramazan, duke e lutur Zotin që të japë shëndet, begati e mirësi”, ka thënë ai.

Nënkryetari i Komunës së Bujanocit, Shqiprim Musliu dhe kryetari i Këshillit Nacional Shqiptar, Ragmi Mustafi, çmuan lart punën dhe kontributin e BIK-ut përmes hoxhallarëve që feja dhe kombi të ruhen në këtë pjesë. “Ne kemi parë çdoherë

tendenca të ndryshme që mos të kultivohet feja jonë në këtë pjesë dhe të degradohet, por falë jush ia dalim dhe ruajmë këtë fe të dashur që na identifikon, por mbi të gjitha edhe kombin tonë shqiptar, prandaj këtë muaj të shenjtë Ramazan, që po fillojmë, ju përcjellim mesazhe më të mirë që të ofrojmë dashuri dhe urtësi mes njëri tjetrit”, tha Shqiprim Musliu.

## “Bereqeti” dhe Zyra e Dijanetit në Zvicër dhuruan 600 pako ushqimore

Më 8 prill, Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti” në kuadër të aksionit “Sofra e Ramazanit”, është ndihmuar nga Zyra e Dijanetit në Zvicër e cila ka shpërndarë 600 pako ushqimore për familjet nevojtare në Kosovë. Përfaqësuesi i mushavirit të Dijanetit të Turqisë në Prishtinë, Bilal Xhoshkun, falënderoi të gjithë kontribuuesit duke uruar që këto ndihma do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

“Siç dihet Ramazani është muaj i ndihmës dhe solidaritetit. Për këtë arsye jemi këtu, që të shpërndajmë këto ndihma për familjet në nevojë. Falënderojmë Dijanetin Turk në Zvicër si dhe të gjithë ata bamirës që kontribuuan, Allahu i shpërbleftë! Shpresojmë që këto ndihma do të vazhdojnë edhe në të ardhmen në sasi edhe më të mëdha”, tha ai.



Kryeimami i Kosovës, Vedat Sahiti, falënderoi donatorët në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe tha se bashkëpunimi me komunitetin mysliman turk në Zvicër po fuqizohet dita-ditës.

“Me këtë, vetëm se kemi forcuar akoma më shumë bashkëpunimin edhe me komunitetin mysliman turk në Zvicër dhe me Kosovën. Në

emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, më lejoni të falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar që të pasurojnë familjet e varfra në Kosovë, që të pasurojnë sofrat e atyre njerëzve që vërtetë kanë nevojë për ndihmën tonë dhe lus Zotin xh.sh. që t’i shpërblej me gjitha të mirat e tij në këtë ditë të madhe të xhumasë në muajin Ramazan.”



## Kreimami Sahiti vizitoi xhamitë e fshatrave të Medvegjës

Më 9 prill, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, së bashku me drejtorin e Financave, Islam Hasani, drejtorin për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodrën dhe zv/drejtorin e “Bereqetit”, Xheladin Fazliu, vizituan xhamitë e fshatrave të Komunës së Medvegjës të banuar me shqiptarë. Në këtë vizitë, ky delegacion i lartë i Bashkësisë Islame të Kosovës i udhëhequr nga kryeimami Sahiti panë për së afërmi mbarëvajtjen dhe organizmin e jetës fetare në këtë pjesë, si dhe shfrytëzuan rastin për t’ua uruar muajin Ramazan besimtarëve të kësaj pjesë.

Fillimisht delegacioni i Kryesisë së BIK-ut vizituan xhaminë e fshatit Kapit, ku u mirëpritën nga imami veteran mulla Ajeti, ku falën së bashku namazin e ikindisë. Kryeimami Sahiti dhe zv/ drejtori i “Bereqetit” Xheladin Fazliu, vizituan disa familje shqiptare me gjendje të rënduar ekonomike, ku u dhuruan



pako me produkte esenciale ushqimore, duke shfrytëzuar njëkohësisht rastin për t’ua uruar muajin Ramazan.

Vizita më pas vazhdoi në xhaminë e fshatit Siarinë, ku u shtrua iftar i përbashkët për besimtarët e fshatrave të Medvegjës dhe vendeve të tjera. Kryeimami Sahiti mbajti një ligjëratë kushtuar rëndësisë së muajit Ramazan, për t’i prirë më pas namazit të teravive. Vizita e tillë nga Kryesia e

BIK-ut, u çmua dhe u vlerësua edhe nga imami i xhamisë së fshatit Siarinë. “BIK-u gjithmonë ka qenë në mbështetje të xhamive në komunën tonë, jo vetëm këtu, por edhe në komunat e Preshevës dhe Bujanocit, shpresojmë që ky iftar të shndërrohet në iftar tradicional dhe të kemi Bashkësinë Islame edhe më shumë në këto troje”, tha ai.

## Një delegacion i lartë i shoqatës Swiss Barakah Charity vizitoi Kosovën

Më 13 prill, një delegacion i shoqatës Swiss Barakah Charity, i përbërë nga Muhamad Ahmad Ajami, Muatasim Bouhouch, Lahoussine Etaleb, vizituan Kosovën, të cilët u pritën nga udhëheqësit e Shoqatës Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, z. Behxhet Ajvazi dhe Xheladin Fazliu.

Fillimisht drejtori Ajvazi iu shprehu mirëseardhje mysafirëve, duke i njohur kështu me aktivitetet dhe me punët e shoqatës. Ai më pas i falënderoi ata për ndihmat e dhuruara ndër vite për shoqatën “Bereqeti”. Gjatë kësaj vizite, ata vizituan disa shoqata dhe organizata të ndryshme, si dhe disa familje nevojtare. Fillimisht ata vizituan Down Syndrome Kosova, në të cilën u pritën nga drejtoresha e kësaj shoqate Sebahate Hajdini-Beqiri, e cila i falënderoi ata për ndihmat e dhëna për këtë shoqatë. Shoqata



Swiss Barakah Charity, përmes shoqatës “Bereqeti” i kanë dhuruar Down Syndrome Kosovës mjete pune për degët Prishtinë dhe Prizren.

Në ditën e dytë të vizitës, delegacioni nga Swiss Barakah Charity vizitoi 70 fëmijë jetimë të Prishtinës dhe Fushë Kosovës, të cilët i ndihmoi me veshmbathje në vlerë të 40 eurove për çdo fëmijë. Këta fëmijë janë përzgjedhur nga shoqata e autizmit, shoqata Down

Syndrome, nga shkolla Mihail Grameno në Fushë Kosovë, nga Departamenti i Gruas së BIK-ut dhe nga komunitet e tjera. Gjatë ditës, ata vizituan edhe familjet e komunitetit RAE në Plemetin, ku shpërndanë për ta 150 pako ushqimore. Vlen të përmendet se shoqata “Bereqeti” ka një bashkëpunim të shkëlqyer me shoqatën Swiss Barakah Charity.

## Vizita e drejtorit të Diasporës së BIK-ut, Ekrem ef. Simnica në diasporë

Më 14 dhe 15 prill, me ftesë të një grupi mërgimtarësh, drejtori për Diasporë në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, qëndroi për vizitë në Finlandë.

Fillimisht ai qëndroi në Qendrën Islame Shqiptare "Dituria" në Helsinki në të cilën u mirëprit nga imami i xhamisë, Enis ef. Qerimi, i shoqëruar edhe nga kryetari i kësaj qendre, si dhe nga një grup i xhematit. Kjo qendër përpos xhamisë, ka edhe objektet përcjellëse, të cilat e bëjnë qendrën edhe më funksionale dhe më të shfrytëzueshme për bashkatdhetarët tanë.

Më 16 prill, drejtori Simnica, i shoqëruar nga imami i xhamisë Mati 1, Fadil ef. Musliu, morën pjesë në tribunën e organizuar nga Qendra Shqiptare Fetare dhe Kulturore në Oslo të Norvegjisë. Tribunës iu bashkëngjit edhe Musa ef. Vila, i cili ishte në shërbim për Ramazan në xhaminë e Dramenit. Drejtori i Diasporës, Ekrem ef. Simnica, në këtë qendër u prit në takim nga imami Sabri ef. Jonuzi dhe nga një grup i xhematit të kësaj qendre. Ai para tyre mbajti një ligjëratë kushtuar muajit të bekuar Ramazan.

Më 17 prill, drejtori Ekrem ef. Simnica, i shoqëruar nga imami Fadil ef. Musliu, kanë mbajtur një ligjëratë kushtuar muajit Ramazan në Qendrën Islame Kulturore Shqiptare në Norvegji. Drejtori Simnica në këtë ligjëratë foli për vlerën, rëndësinë dhe begatitë që i ka muaji Ramazan, por gjithashtu një



pjesë të ligjëratës ia kushtoi edhe aktiviteteve, punëve dhe angazhimeve të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Përveç drejtorit Simnica, pjesëmarrës ishin edhe hoxhallarët Sabri ef. Jonuzi, Berat ef. Hashani, Fatmir ef. Shabani dhe Bedri ef. Bashota.

Më 19 prill, Ekrem ef. Simnica dhe imami Fadil ef. Musliu, vizituan xhematin e xhamisë në Regensburg të Zvicrës, ku u pritën nga imami Ferid ef. Zeqiri, anëtarët e kryesisë dhe nga xhemati i kësaj xhamie. Drejtori i Diasporës, Ekrem ef. Simnica, në ligjëratën e tij, theks të veçantë i kushtoi punës dhe veprimtarisë së institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Më 21 prill, drejtori i Diasporës në Bashkësinë Islame të Kosovës, vizitoi xhematin e xhamisë "Dituria" në Gjenevë, ku u prit nga imami Rijad Aliu, kryetari, anëtarët e kryesisë dhe nga xhemati i kësaj xhamie. Përfaqësuesi i BIK-ut qëndroi në

këtë xhami për namaz dreke dhe më pas mbajti edhe një ligjëratë me këshilla dhe mësimë rreth dhjetëshit të fundit të muajit Ramazan.

Më 22 prill, Ekrem ef. Simnica, i shoqëruar nga imami Fadil ef. Musliu, kanë qëndruar për vizitë në Zvicër. Me këtë rast, drejtori Simnica vizitoi Qendrën Shqiptare për Integrim, Kulturë dhe Religjion në Lozanë, ku përcolli urimet dhe përgëzimet e Myftiut Tërnavë për muajin Ramazan, duke lutur Allahun që të na i pranojë adhurimet që i kryejmë gjatë këtij muaji.

Më 18 prill, Ekrem ef. Simnica, së bashku me imamin Fadil ef. Musliu, vizituan xhematin e Sarbsborgut – Halldenit, ku u pritën nga imami Ardian ef. Haliti dhe nga xhemati i kësaj xhamie. Delegacioni i BIK-ut qëndroi në këtë xhami për iftar dhe më pas mbajtën edhe një ligjëratë me këshilla dhe mësimë rreth muajit Ramazan.

## Dua hatmeje në xhaminë e fshatit Dubravë të Kaçanikut

Më 16 prill, u mbajt duaja e hatmes në xhaminë e fshatit Dubravë të Kaçanikut me rastin e përfundimit të leximit të Kuranit nga pesëmbëdhjetë vajza dhe gra nën përkuajdesjen dhe mësimin e Teologe Qamile Musliu - Malsiu. Programi filloi me Kuran nga teologe Blertona Kriva. Fjalën hyrëse mori nikoqirja e kësaj xhamie, znj. Musliu – Malsiu,

e cila falënderoi të pranishmet dhe uroi lexueset e Kuranit me shpresë se ky lexim do t'i përcjell gjatë gjithë jetës.

Fjalën përshëndetëse në emër të Departamentit të Gruas në Kryesinë së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës e mbajti prof. Hatixhe Sadriu. Këtë tubim përshëndeti edhe zyrtarja e Departamentit të Gruas

znj. Bardha Kqiku - Luma, e cila uroi muajin Ramazan dhe falënderoi teologjen në fjalë për punën e vazhdueshme që bënë me xhematin e kësaj xhamie, si dhe uroi ato që përfunduan leximin e Kuranit, duke lutur Zotin që Kurani t'u bëhet dritë në këtë dhe botën tjetër. Gjithashtu u mbajt edhe ligjëratë nga dr. Florëntina Tërmmolli, e cila tregoi

për mirësitë e leximit të Kuranit dhe vlerën e tij sidomos gjatë muajit Ramazan.

Duanë e hatmes e bëri prof. Hatixhe Sadriu. Programin e përcollën ilahi të ndryshme të kënduara nga nxënës të kësaj xhamie. Në fund të programit u lexua pjesë Kurani nga ato që përfunduan hatmen dhe u shpërndanë certifikata për të gjitha nxënëset nga KBI - Kaçanik.



## Shoqata "Bereqeti" ndihmoi familjet nevojtare në Pukë të Shqipërisë

Më 18 prill, Shoqata Humanitare Bamirëse "Bereqeti" ka vazhduar aktivitetin e saj humanitar edhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Kjo shoqatë ka ndihmuar me pako ushqimore e higjienike dhe me veshmbathje familjet nevojtare në qytetin e Pukës. Myftiu i Pukës, Gëzim ef. Kopani, falënderoi për zemërsisht Shoqatën Humanitare Bamirëse "Bereqeti" për këto ndihma, duke potencuar se kjo nuk është hera e parë që kjo shoqatë u del në ndihmë familjeve nevojtare të kësaj ane.



## Shoqata "Bereqeti" hapi dy bunarë në komunën e Lipjanit

Më 18 prill, Shoqata Humanitare Bamirëse "Bereqeti" në vazhden e aktiviteteve të saj humanitare ka realizuar projektin e radhës për hapjen e bunarëve, kësaj radhe në komunën e Lipjanit, njëri në qytetin e Lipjanit, ndërsa tjetri në fshatin Rubovc.

Përgjegjësi i shoqatës "Bereqeti", Xheladin ef. Fazliu, falënderoi dy donatorët që kanë kontribuar për hapjen e këtyre bunarëve, Bahtije Hakiqi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe familja Kurtishi nga Kumanova me qëndrim në Belgjikë.



## Kryeimami Sahiti vizitoi Luginën e Preshevës

Më 19 prill, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka vizituar Luginën e Preshevës, si dhe fshatrat e kësaj komune të banuar me shqiptarë për t'u informuar për mbarëvajtjen e jetës fetare, duke shfrytëzuar kështu rastin që t'ua uroi muajin Ramazan.

Në bashkëpunim me Shoqatën "Bereqeti", kryeimami Sahiti, vizitoi disa familje shqiptare me gjendje të rënduar ekonomike, ku edhe ndihmoi me ato me pako ushqimore. Në këtë vizitë, kryeimami Sahiti vizitoi Këshillin e BI-së së Preshevës, ku u prit nga kryetari Nexhmedin ef.

Ademi. Nën organizimin e Bashkësisë Islame të Kosovës u shtrua edhe iftar i përbashkët me imamët si dhe me besimtarët myslimanë të kësaj pjese. Kryeimami Sahiti tha se "vetëm përmes unitetit dhe solidaritetit mund të ecim përpara, andaj këto virtyte duhet të shtohen

edhe më shumë...” Kryetari i Këshillit në Preshevë, Nexhmedin Ademi, çmoi lart kontributin e BIK-ut për Islamin në këto pjesë të ndjeshme. “BIK-u për ne është sikur prindi për fëmijën. Ne duhet të mbështesim jetën institucionale të BIK-ut. Ky institucion gjatë historisë ka qenë mburoja, kulmi i davetit në Islam. Nuk ka institucion më kompetent për organizimin e jetës fetare, thirrjen në Islam, ruajtjen e traditës sonë islame shekullore sesa BIK-ut”, tha ai. Gjatë kësaj vizite në Preshevë, kryeimami Vedat ef. Sahiti, mbajti një ligjëratë kushtuar muajit Ramazan, për t’i prirë më pas namazit të teravive, me ç’rast u mirëprit nga besimtarët e kësaj



pjesë. Kryeimami i Kosovës, gjatë muajit të Ramazanit ka vizituar edhe komunën e Bujanocit dhe atë të Medvegjës së bashku me fshatrat

përreth të banuar me shqiptarë, me qëllim që të shoh nga afër mbarëvajtjen fetare në këto vende të ndjeshme.

## Kryeimami Sahiti priti në takim përfaqësuesin e Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë

Më 22 prill, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, priti në takim përfaqësuesin e Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë, Mustafa Uğur Özyaramış, i cili po qëndron në vizitë zyrtare në Bashkësinë Islame të Kosovës për të marrë pjesë në shpërndarjen e pesë mijë pakove ushqimore gjatë këtyre ditëve të Ramazanit për familjet me gjendje të rëndë socio ekonomike. Kryeimami Sahiti falënderoi z. Özyaramis për vizitën dhe për këtë ndihmë kaq të madhe që populli dhe shteti turk në këtë muaj të solidaritetit ka shtrirë dorën e ndihmës për familjet nevojtare në Kosovë.



Nga ana e tij, z. Mustafa Uğur Özyaramış, falënderoi kryeimamin për mikpritjen dhe për bashkëpunimin e Kryesisë së BIK-ut me

Drejtorinë e Përgjithshme të Vakëfeve, edhe në fushën humanitare, përveç asaj në fushën e trashëgimisë kulturore.

## “Bereqeti” shpërndau 400 pako ushqimore, donacion nga Arabia Saudite

Më 22 prill, Shoqata Humanitare “Bereqeti” ka filluar me shpërndarjen e 400 pakove të tjera ushqimore për familjet nevojtare, donacion ky nga Mbreti i Arabisë Saudite, Selman Bin Abdul Aziz Al-Saud. 100 pako të tilla u shpërndanë në Prishtinë, për nder të 10 netëve të fundit të Ramazanit. Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, së bashku me ambasadorin

e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, Faisal Ghazi Ismail Hifzi morën pjesë në shpërndarjen e këtyre pakove ushqimore. Ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë tha se ndjehet i lumtur që është pranë qytetarëve të Kosovës me këto dhurata simbolike. “Jam i nderuar që sot jam këtu para jush për të inauguruar projektin për shpërndarjen e pakove ushqimore,

projekt ky i cili realizohet në 94 vende të botës. Ky projekt vjen si iniciativë për të qenë afër popullit të Kosovës, si përkrahje nga Mbretëria e Arabisë Saudite, duke pasur parasysh ngritjet e çmimeve dhe nevojave që ka populli i Kosovës. Andaj kemi vendosur që t’u qëndrojmë pranë në këto ditë të vështira.”

Në anën tjetër, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, falënderoi për zemërsisht Mbretërinë e Arabisë Saudite për mbështetjen e vazhdueshme ndaj BIK-ut dhe shteti të Kosovës. “Dëshiroj të falënderoj Arabinë Saudite për ndihmat e vazhdueshme që i ka dërguar Kosovës, si ato para luftës, po ashtu edhe për ato pas luftës. Një bashkëpunim dhe një koordinim me Bashkësinë Islame në veçanti me shoqatën ‘Bereqeti’ me emër të Zotit do të vazhdojë edhe në të ardhme. Bashkësia Islame e Kosovës i është mirënjohëse për ata se çfarë ka bërë, por edhe në atë se çfarë është duke bërë si në ndihma humanitare ashtu



edhe në anëtarësimin e Kosovës në organizata të huaja.”

Gjatë muajit Ramazan, Mbretëria e Arabisë Saudite në bashkëpunim me Shoqatën “Bereqeti” e cila

funksionon në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, kanë shpërndarë edhe 2 mijë pako të tjera ushqimore për familjet në nevojë.

## Tribunë për gra në Kaçanik

Më 23 prill, në xhaminë "Koxha Sinan Pasha" në Kaçanik, para vaktit të iftarit, u mbajt tribuna me temë: "Myslimania ideale".

Tribuna u hap me këndim Kurani, nga Blertona Kriva, teologe, e më pas, zyrtarja e Departamentit të Gruas në Kaçanik, znj. Bardha Kqiku - Luma, përshëndeti të pranishmet, duke iu dëshiruar agjërim të lehtë dhe ibadete të pranuar.

Në këtë tribunë ligjëruan: znj. Vaxhide Bunjaku, udhëheqëse e DG në Kryesinë e BI të Kosovës dhe znj. Hatixhe Sadriu, profesoreshë në Medresenë e Mesme "Alaudin" në Prishtinë.



## Kryeimami Sahiti mori pjesë në iftarin tradicional të shtruar nga Këshilli i BI-së në Bujanoc

Më 24 prill, Këshilli i Bashkësisë Islame në Bujanoc shtroi iftarin tradicional me përfaqësuesit e të gjitha strukturave të komunës së Bujanocit, personalitete publike, imamë, xhematë etj. Nga Kryesia e BIK-ut ishin përfaqësuesit e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, të kryesuar nga kryeimami Vedat ef. Sahiti.

Pas iftarit, të pranishmëve iu drejtua kryetari i Këshillit të BI-së së Bujanocit, Ragmi ef. Destani, i cili i falënderoi të pranishmit për



pjesëmarrje në këtë iftar. Ai elaboroi aktivitetin e Këshillit gjatë muajit Ramazan, duke falënderuar imamët për punën e tyre, pastaj Departamentin e të Rinjve dhe Departamentin e Gruas e të tjerë.

Fjalën përshëndetëse e mori më pas kryetari i komunës z. Nagip Arifi.

Kurse më pas të pranishmëve u drejtua kryeimami i BIK-ut Vedat ef. Sahiti, i cili i përshëndeti të

pranishmit në emër të Kryesisë së BIK-ut dhe Myftiut Tërnavë, duke lutur Zotin për shëndet, prosperitet dhe falje në këto ditë të fundit të Ramazanit dhe se BIK-u vazhdimisht do t'i mbështes aktivitetet fetare e edukative dhe punën e tyre në të ardhmen.

Në këtë iftar, KBI në Bujanoc, kishte ftuar edhe tre nxënës nga shkolla e mesme Sezai Surroi në Bujanoc, të cilët javën e kaluar, në

garat regjionale në Serbi, në lëndën e fizikës, kishin zënë dy vendet e para dhe njëri vendin e dytë. Atyre dhe dy profesorëve të tyre, Vjollca Rexhepit dhe Baki Rexhepit, KBI në Bujanoc u ndau nga një dhuratë për këtë të arritur.

Namazin e jacisë dhe të teravive, kryeimami Vedat ef. Sahiti e fali në Xhaminë e Strukarëve në Tërnoc, si ligjërues dhe imam. (R.S.)

## Iftar madhështor në sheshin e Prishtinës

Më 24 prill, në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë u shtrua iftar madhështor për mbi 1000 persona për të gjitha kategoritë e shoqërisë. Ky iftar u organizua nga Bashkësia Islame e Kosovës në bashkëpunim me Organizatën "Qatar Charity". Në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, Besim Mehmeti nga kabineti i Myftiut Naim ef. Tërnavë, falënderoi organizatën e Katarit për ndihmën e vazhdueshme që bën për popullin e Kosovës. Edhe kryeimami i Prishtinës, Burhan ef. Hashani, falënderoi bashkëpunëtorët si dhe të gjithë pjesëmarrësit që e bënë madhështor këtë iftar në qendër të Prishtinës. Në këtë organizim morën pjesë përfaqësues nga komuna e



Prishtinës, pjesëtarë të FSK-së, personalitete të ndryshme e qytetarë të shumtë. Bashkësia Islame e Kosovës në bashkëpunim me

Shoqatën e Katarit në këto ditë të fundit të Ramazanit do të shtrojë iftare për gjithsej mbi 3000 persona në të gjithë Kosovën.

## BIK shtroi iftar për komunitetin rom dhe ashkali në komunën e Ferizajt

Më 25 prill, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka shtruar iftar për komunitetin rom dhe ashkali në komunën e Ferizajt. Në emër të komunitetit, një fjalë rasti e mbajti nënkryetari i Komunës së Ferizajt, z. Danush Ademi, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe e falënderoi Bashkësinë Islame të Kosovës për iftarin e sotëm, por edhe për gatishmërinë e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës për të qëndruar pranë komunitetit rom dhe ashkali me të gjitha format, përfshirë edhe ndihmat me ushqim dhe me veshmbathje. Në emër të Myftiut Tërnavë, të pranishmit i përshëndeti



sekretari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, i cili tha se BIK-u çdoherë do të jetë në

përkrahje dhe në mbështetje të këtij komuniteti në të gjitha format e mundshme.

## Myftiu i Stambollit, prof. dr. Safi Arpagus qëndroi në Kosovë

Më 26 prill, në kuadër të bashkëpunimit të Bashkësisë Islame të Kosovës me Dijanetin turk, Myftiu i Stambollit, prof. dr. Safi Arpagus, ka realizuar një vizitë dy ditore në Kosovë, me ç'rast në organizim të këshillave të Bashkësisë Islame në Prizren e Mitrovicë shtrroi iftar për besimtarët, ku përveç strukturave të këshillave të BI, udhëheqësve të komunave, morën pjesë edhe shumë qytetarë dhe personalitete nga jeta kulturore e publike. Në këtë vizitë, Myftiu i Stambollit shoqërohej edhe nga myezinët e xhamisë “Aja Sofia”, të cilit me zërat e tyre të mrekullueshëm me lexim nga Kurani e salavate sollën atmosferën e xhamisë së Aja Sofias në vendin tonë. Gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, Myftiu i Stambollit e shoqëroi kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti.



## U vu gurthemeli i xhamisë së re në Vrapçiq të Gjilanit

Më 27 prill, në fshatin Vrapçiq të komunës së Gjilanit, me lexim të Kurani dhe tekbire u vu gurthemeli i xhamisë së fshatit. Në vënien e gurthemelit të xhamisë morën pjesë banorët e fshatit Vrapçiq, kryetari i Këshillit të BI-së së Gjilanit, Naim ef. Aliu, bashkë me zyrtarët e administratës dhe disa imamë. Në këtë manifestim mori pjesë edhe kryeimami i BIK-ut, Vedat ef. Sahiti, i cili i në fjalën e tij i uroi besimtarët fillimisht për Natën e Kadrit, si dhe i uroi dhe përgëzoi banorët për nisjen e punimeve të ndërtimit të xhamisë në Vrapçiq. “Kjo vendosmëri dhe ky vullnet për të ndërtuar xhami është dëshmia më e mirë në vepër dhe treguesi më i mirë i forcës së besimit tuaj në Zotin Fuqplotë,



ngase Zoti në Kurani fisnik na mëson se xhami ndërtojnë vetëm besimtarët që besojnë në Zotin dhe ditën e fundit”, theksoi mes tjerash kryeimami Sahiti. Xhamia e fshatit

Vrapçiq do të ndërtohet nga donacionet e besimtarëve vullnetmirë të fshatit Vrapçiq në koordinim me Këshillin e Bashkësisë Islame në Gjilan.

